



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 48/25

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum 17. 03. 2025

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **27 mars 2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 janar 2025.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2025.
3. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024.
4. Propozim – vendim për Bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
5. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025.
6. Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.
7. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2024.
8. Propozim – vendim për ndryshim dhe plotësimin e vendimit për rritje të vlerës për shërbime të varrimit.
9. Propozim – vendim për përkrahje financiare
10. Propozim – vendim për shfuqizim të vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nr.656/06 i datës 09.11.2006.
11. Propozim – vendim për përkrahje financiare për z. Shkodran Imeraj.
12. Propozim – vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënien në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automermangë brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë.
13. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.
14. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRRI

01 Nr. / Br. 47/25

Nr. i fq. / Br. st. - 2 -

Data: / Datum 17.03.2025

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 17.03.2025

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **17 mars 2025** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
2. Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
3. Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
4. Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
5. Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
6. Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit për Dëshmorin, Avni Saraçi.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, pa u marrë pëlqimi i pronarit të parcelës, si dhe të rregullohen procedurat në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – destinimi për ndërtim të bustit.*
8. Propozim – vendim për ndryshim dhe plotësimin e vendimit për rritje të vlerës për shërbime të varrimit.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Por, deri në mbledhje të kërkohen sqarime shtesë dhe arsyeshmëri nga Bashkësia Islame dega në Vushtrri se çka përfshihet në këtë shërbim. Me këtë rritje të vlerës për shërbime të varrimit, a përfshihet edhe hapja e varrit?*
9. Kërkesë për mbështetje financiare
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
10. Propozim-vendim për shfuqizim të vendimit të kuvendit të komunës.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të jetë pjesë e vendimit se kjo parcelë do të jetë e destinuar për nevojat e QKMF-së dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
11. Propozim-vendim për përkrahje financiare për Shkodran Imeraj.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E II E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, PËR VITIN 2025, MBAJTUR MË: 27 SHKURT 2025

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:20**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Mek Selaci, Jeton Gjaka, Spasoje Stefanoviç, Shkelzen Xhaferi, Refik Maloku, Ramadan Parduzi, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Sylejman Mehollli dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Nurie Halili, Nasuf Aliu dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 32 anëtarë të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z. Ferit Idrzi, nënkryetarja znj. Hava Mlinaku-Rruka, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-pas i përshëndeti gjithë të pranishmit deklaroi: për tri vite të Kryetarit Idrizi dhe PDK-së në Vushtri kemi parë një qeverisje dhe një menaxhim shumë të dobët të komunës sonë, dhe kemi parë shumë KAOS. Për këto tri vite qyteti ynë dhe rrugët tona janë shndërruar në një KAOS të vërtetë, në cilën do anë të qytetit gjen bagera të parkuar me muaj të tërë në skaje të rrugëve, duke u munduar të krijojnë përshtypjen se këtu është duke u punuar. Barger të parkuar me muaj të tërë në rrugën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” afër shkollës fillore Mustaf Venhari, bager të parkuar me muaj të tërë tek parku i qytetit, barger i parkuar me muaj të tërë në rrugën “Pandeli Sotiri”, pra këtu nuk ka punë, këtu ka vetëm KAOS dhe këtë KAOS po e shohin edhe qytetarët e Vushtrrisë. Në prononcimet e fundit e kemi dëgjuar Kryetarin duke thënë se unë i pres qytetarët në zyrë, dhe edhe e kemi parë që po i pret, por për fat të keq ashtu si po i pret ashtu edhe po i përcjell dhe punët nuk po lëvizin. Kryetar dua t’ju kujtoj që përpos që ti presësh në takime qytetarët duhet edhe të punosh, e punët duhet të kryhen në teren dhe jo në zyrë. Për të disa herë ju kemi kujtuar se shumë biznese në shesh dhe në afërsi të sheshit janë duke u mbyllur për shkak se ju keni pamundësuar funksionimin atyre bizneseve, ku për këto biznese kishit premtuar

kompensim i cili kompensim nuk ndodhi asnjëherë. Ky shqetësim është ngritur shumë herë në këtë kuvend, por as që na dëgjonit, dhe vazhduat kështu deri sa i detyruat banorët e atij lokaliteti ta ngritin zërin dhe ta bëjnë këtë problem edhe mediatik. Dhe pas gjithë kësaj që ndodhi të dashur qytetar të Vushtrrisë, përgjigja e Kryetarit për rrugën Pandeli Sotiri ishte se këtë rruga e ka lënë keq pushteti i kaluar. I nderuar Kryetar, ju them që pushteti i kaluar ka pasur gabime, sepse ka bërë shumë punë, të cilat punë i kanë parë edhe qytetarët tanë. Dua t'ju numëroj vetëm tri projekte të cilat i ka realizuar LDK në Vushtrri: 1. Furnizimi me ujë të pijshëm në 70% të territorit të komunës sonë. 2. Themelimi i Ndërmarrjes Publike Përparimi me të cilën po krenoheni edhe ju sot. 3. Mbledhja e mbeturinave në tërë territorin e komunës sonë të cilat deri me ardhjen e LDK-se në pushtet ishin mbledhur vetëm në qytet, 4. Ndërtimi i QKMF-së 5. Ndërtimi i shtëpisë së pleqve dhe shumë projekte tjera si këto të cilat i dimë dhe i shohim, por kam një pyetje për ju Kryetar, a mund ti numëroni 3 punë për të cilat krenoheni që i keni bërë dhe për të cilat ju ka pa hajrin qyteti dhe qytetarët.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –pasi i përshëndeti të pranishmit, ngrit shqetësimin e punëtorëve teknik të tri shkollave të mesme në Komunën e Vushtrrisë, ku ceku se këta punëtor që janë pjesë e Kompanisë “Përparimi” po ju bëhet një diskriminim i madh për sa i përket pagave dhe beneficioneve tjera që dalin nga pagat e tyre. Ai sqaroi se në vitin 2011 ishte marr një vendim që këta punëtor që ishin në kuadër dhe punëtor të DKA-së të transferohen në një kompani private pa vullnetin e tyre dhe ky transferim ishte paraparë të zgjaste vetë, një vit si pilot projekt, por ky vendim nuk kishte pasur qëllim përmirësimin e shërbimeve por hapja e rrugës për një tender me të vetmin qëllim keqpërdorimin e parasë publike. Ky transferim i këtyre punëtorëve pa pëlqimin e tyre përbënte shkelje ligjore. Me qëllim të amortizimit të pakënaqësive të këtyre punëtorëve më vonë ishte marr një vendim nga komuna që sa herë që kemi ngritje të pagave të bëhet edhe ngritja e pagave të këtyre punëtorëve teknik në mënyrë lineare, por që kompania private nuk e zbatoj asnjëherë këtë vendim. Pas themelimit të Ndërmarrjes “Përparimi” është vendosur që këta punëtor të jenë pjesë e N.P.L. “Përparim” por kjo gjë nuk ka ndodhur, gjithashtu kur u bë marrëveshja për transferimin e 61 punëtorëve në Ndërmarrjen “Përparimi” nga kompanitë private në Ndërmarrjen “Përparim” këta punëtor u diskriminuan, pasi që nuk u bën pjesë e Kompanisë dhe nuk u përfshinë në rritjen e pagave dhe beneficioneve tjera. Përgjegjësit për këto çështje mbeten tek DKA-ja dhe Ndërmarrja “Përparimi” e që nuk iu janë përgjigjur këtyre punëtorëve dhe nuk i kanë ndërmarr masat për zgjidhjen e këtij problemi. Për më tepër disa nga këta punëtor janë kërcënuar, disa janë shantazhuar se nëse e ngrasin zërin mund të përjashtohen në mënyrë arbitrare dhe kundërligjore nga puna. Propozimi i tij është që Ndërmarrja “Përparimi” të përmbush obligimet ndaj punëtorëve në fjalë duke i zbatuar vendimet e DKA-së për këta punëtor, të iu njihet përvoja e punës dhe të iu paguhen detyrimet përkatëse, dhe po ashtu këta punëtor të përfshihen në listën e shujtave sikurse punëtorët tjerë, dhe po ashtu të ketë ngritje të pagave. Në fund kërkoj nga organet përgjegjëse që të reagojnë shpejt në zgjidhjen e këtij problemi, duke e ndaluar diskriminimin dhe trajtimin jo të drejtë të këtyre punëtorëve.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, adresoj një kërkesë të parashtruar nga Kryqi i Kuq për mbështetje financiare lidhur me nderimin e objektit të tyre, të cilën komuna e ka ndihmuar duke ja ndarë pronën, por që kostoja e ndërtimit është bukur e lartë dhe duhet të ti ndihmohet me një pjesë të mjeteve financiare.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, adresoj shqetësimin për gjendjen e 20 punëtorëve teknik në tri shkollat e mesme të Komunës së Vushtrrisë. Këta punëtor për kohë të gjatë kanë qenë si shërbyes profesional dhe për një kohë të gjatë kanë qenë në listat e pagave, së bashku me mësimitdhënësit dhe punëtorët tjerë arsimor. Në vitin 2011 qeveria e

atëherëshme komunale e udhëhequr nga PDK dhe kryetrari Bajram Mulaku patën marr vendim që këta punëtorë të largohen nga listat e pagave, dhe duke i dhënë në menaxhim kompanive private deri në vitin 2021 për të kaluar pastaj në Kompaninë “Përparimi”. Këta punëtor kompanitë i kanë ndërruar por punën e bëjnë të njëjtë, d.m.th. njëjtë sikurse punëtorët tjerë teknik në shkollat tjera, ndërsa ligji përcakton se punëtorët për punën e njëjtë marrin pagën e njëjtë. Këta punëtor të këtyre tri shkollave nuk janë përfshirë në rritjen e pagave prej 55 €, dhe nuk i gëzojnë të drejtat nga kontrata kolektive. Lidhur me këtë problematikë, kërkoj nga kryetari i komunës dhe qeveria komunale, që ta rishikojnë marrëveshjen e vitit 2021 që është diskriminuese për këta punëtor, ashtu që këtyre punëtorëve të iu mundësohet rritja e pagave sikurse kolegëve të tyre.

Ferit Idrzi, kryetar i komunës–në fillim të diskutimit të tij të gjithë besimtarëve të besimit islam iu uroj muajin e shenjtë të Ramazanit, duke ju uruar agjërim të lehtë, shëndet e begati në familjet e tyre! Tutje duke ju përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të kuvendit deklaroi se është e vërtet se në komunën e Vushtrrisë është duke u punuar në të gjitha anët, dhe vlerësoi se projektet të cilat janë duke u kryer në Vushtrri nuk do të ketë nevojë që mandatin e ardhshëm të punohet sërish në to, sikurse po ndodhë në rrugën “Pandeli Sotiri”, dhe kjo ka ndodh sepse është punuar keq dhe në atë rrugë është investuar në komplet infrastrukturën nëntokësore, kjo rrugë ky projekt do të përfundohet shumë shpejtë dhe arsyet se shkaqet e vonësive kanë qenë kushtet klimatike. Lidhur me kompensimin e bizneseve që shtrihet tek sheshi “Adem Jashari” do të bëhet një prerje në momentin kur përfundon ajo pjesë e sheshit dhe për ato biznese që janë dëmtuar do të kompensohen për kohën që kanë pasur humbje dhe propozim-vendim për ndihmë financiare do të vjen në kuvend për aprovim. Lidhu me numrin e projekteve të qeverisë së tij, vlerësoi se janë këto projekte që do të lënë gjurmë në Komunën e Vushtrrisë dhe disa prej tyre do të përfundohen këtë vit që korrespondon që është vit elektorale. Dhe në këto projekte si më të rëndësishme evidentohen se janë projekte dy vjeçare si: objekti i shkollës “Mustafë Venhari”, rr. “Bekim Berisha”, rr. “Lumni Surdulli”, rr. “Drenica” ndërtimi i sheshit me parking nëntokësor, nderimi i tregut për prodhuesit vendor me parking nëntokësor, rruga Pestovë-Druar, që është përfunduar që vërtet ka qenë në gjendje të mjerueshme por që e ka lehtësuar jetën e atyre banorëve lokal dhe banorëve të tjerë që kalojnë nga ajo rrugë si artere kryesore për kyçje në rrugën magjistrale. Pastaj është bërë një punë e jashtëzakonshme në pastrimin e lumenjve dhe kësaj ju kemi shpëtuar vërshimeve dhe dëmeve që i kemi pësuar viteve të kaluara. Është punuar shumë në fushën e arsimit, është rritur numri i bursave, dhe po ashtu e kemi mundësuar edhe bursa për studentët e fakulteteve private dhe për studentët që studiojnë jashtë vendit. Është mundësuar për herë të parë zhvillimi i arsimit dualë, është investuar në projektet për shkathtësi të buta, është investuar në profilet profesionale, në arsimin shkollat profesionale. Lidhur me çështjen e punëtorëve teknik në tri shkollat e mesme, ceku se është e vërtet që këta punëtor janë të diskriminuar sepse të njëjti nuk paguhen nga Kompania “Përparimi” por nga buxheti i komunës-mallra dhe shërbime, dhe komuna duhet të marr vendim për rritjen e pagave të tyre, por problemi është se nuk kemi mjete për këtë çështje, për shkak të obligimeve nga kontrata kolektive në vlerë prej 8 milion euro, dhe kjo është një goditje e rëndë për financat e Komunës së Vushtrrisë. Andaj shpreson se në një të ardhme të afërt të gjendet një zgjidhje edhe për pagat e atyre punëtorëve teknik.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –kërkoj që marrëveshja e vitit 2021 të anulohet dhe DKA bashkë me Ndërmarrjen “Përparimi” të marr vendim që ata punëtor të jenë pjesë e N.P.L “Përparimi” ashtu që ti gëzojnë të drejtat e tyre.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit – kërkoj pika që ka të bëjë me Informatën për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë, të hiqet nga rendi i ditës.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për”, aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 janar 2025.
2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.
3. Propozim – vendim për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për z.Latif Berisha (post-mortum).
4. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja për vitin 2022,2023 dhe 2024 e lokaleve, pronë komunale në sheshin “Adem Jashari”.
5. Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
6. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, në muajt korrik dhe gusht 2024.
7. Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024.
8. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.
9. Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.
10. Kërkesë për përkrahje financiare.
11. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 janar 2025.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 26 vota “për” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 janar 2025.

2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.

3. Propozim – vendim për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për z.Latif Berisha (post-mortum).

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se grupi kuvendar i LDK-së e mbështet plotësisht Propozim – vendimin për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për z.Latif Berisha.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit – tha se grupi kuvendar i LVV-së e mbështet plotësisht Propozim – vendimin për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për z.Latif Berisha.

Mentor Hasani, anëtar i kuvendit – tha se grupi kuvendar i PDK-së e mbështet plotësisht Propozim – vendimin për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për z.Latif Berisha.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, më datë 24 mars “ditës së rënies”, me titull “Nderi i qytetit” (post mortum), nderohet z. Latif Berisha, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, duke u bërë frymëzim për brezat e ardhshëm.

2. Dorëzimi i kësaj dekorate (titullit) do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 24 mars “ditës së rënies”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja për vitin 2022,2023 dhe 2024 e lokaleve, pronë komunale në sheshin “Adem Jashari”.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se në kudër të kësaj pike të rendit të ditës, kryetari ka pasur mundësi të propozoi që ti ndihmoj bizneset që janë në sheshin “Adem Jashari” që janë dëmtuar nga punimet në parkingun nëntokësor.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – tha se grupi kuvendar i LVV-së e mbështet plotësisht këtë propozim-vendim, dhe shtoj se në seancën e muajit dhjetor 2023 kishte propozuar që të bëhet kompensimi i bizneseve që shtrihen përgjatë sheshit “Adem Jashari”, atëherë kryetari i komunës ishte arsyetuar se duhet të bëhet një komision për vlerësim të atyre bizneseve dhe dëmeve dhe të kompensohen por akoma nuk kemi asgjë në këtë drejtim.

Ferit Idrzi, kryetar i komunës-tha se do të presim kur të bëhet shtimi i pllakave në shesh, më tej do të merret data e nisjes së punimeve dhe data e përfundimit dhe do të bëhet kompensimi i qirave për ato biznese.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për lirim nga qiraja për vitin 2022, 2023 dhe 2024 pronarët në shfrytëzim të lokaleve afariste, pronë komunale në sheshin “Adem Jashari” si në vijim:

- 1.1. Aziz Kolla qiramarrës i lokalit nr. 136
- 1.2. Fatmir Durguti qiramarrës i lokalit nr. 138
- 1.3. Ahmet Tërllabuqi qiramarrës i lokalit nr. 140
- 1.4. Zeqir Mulaku qiramarrës i lokalit nr.142
- 1.5. Naim Jetullahu qiramarrës i lokalit nr.144

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” aprovoj Raportin për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

6. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, në muajt korrik dhe gusht 2024.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –deklaroi se nuk bëhet fjalë vetëm për dy biznese, por bëhet fjalë për dhjetëra biznese, të cilat janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, e të cilat nuk janë kompensuar. Ndër të tjera shtoj për dëmin që i është shkaktuar familjes Vatovci, ka bërë kërkesë dhe për më tepër në seancën e korrikut 2024 kishte propozuar që të futet si pikë e rendit të ditës ndihma financiare por të njëjtin e kishte tërhequr me arsyen se ishte zotuar kryetrari se do të kaloj në komision për vlerësime e më pas duhet të procedohet në kuvend për aprovim, por një gjithë e tillë asnjëherë nuk është realizuar. Ai kërkoj që jo vetëm për këtë rast por për të gjitha rastet të evidentohen në teren dhe raporti të silltet në kuvend për aprovim dhe ofrim të ndihmës.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se ky raport vërtet është shumë i zbehtë dhe nuk është gjithëpërfshirës sepse në të janë evidentuar vetëm dy fermerë që iu janë shkaktuar dëme nga fatkeqësitë natyrore.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –tha se raportet të tilla kemi pasur edhe më herët të cilat janë aprovuar nga kuvendit dhe pyeti se këto vendime për këto raport a janë ekzekutuar nga ana e qeverisë komunale, për ti ofruar ndihmë fermerëve që kanë pësuar dëme nga fatkeqësitë natyrore.

Ferit Idrzi, kryetar i komunës-sqaroi se sa i përket dëmeve nga vërshimet, komision në mënyrë kompletet i ka bërë raportet dhe i ka dërguar në ministrinë e linjës për të ofruar ndonjë ndihmë. Më tej shtoj se vlerësimi nga ana e komisionit është bërë për të gjitha rastet përfshi këtu edhe dëmet që i janë shkaktuar familjes Vatovci, ai u zotua se të gjitha këto raste do të vinë në kuvend për aprovim dhe të njëjtat më pas do të procedohen në ministrinë e linjës për të ofruar ndihmë financiare për këta fermer.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 26 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, në Komunën e Vushtrrisë, për muajt: korrik dhe gusht 2024.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në terren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (erërat e forta, breshëri dhe zjarret,), që kanë mbretëruar në periudhën e sipër-cekur, në Komunën e Vushtrrisë.

3. Komisioni i cekur më lartë, ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve, dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkuluar shumat e mjeteve financiare në vlerë totale prej **13,005.30 €**, si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare dhe këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, në Komunën e Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

6. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –ceku se Plani Zhvillimor Komunal 2016-2024 tash më është i skaduar dhe komuna është akoma duke u bazuar në këtë plan, ai kërkoj informatë se a është duke u punuar në hartimin e planit të ri, dhe mbi bazën e cilit plan janë duke u lëshuar lejet ndërtimore. **Drilon Isufi, drejtor i DUMM-së-informoj** se komuna aktivitetin e saj është duke e bazuar në planin aktual, deri sa të hartohet plani i ri që është proces e sipër për tu përfunduar.

8. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.

9. Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 22 vota “për” aprovoj Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.

10. Kërkesë për përkrahje financiare.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit –vlerësoi se në shumë fshatra janë duke u ndërtuar shtëpi të komuniteteve, dhe me që kostoja financiare për ndërtimin e këtyre shtëpive është e lartë propozoi që komuna në mënyrë lineare të ndaj nga 2000 € për secilën shtëpi të komunitetit që është duke u ndërtuar.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –mendon se shuma prej 3000 € për mbulimin e kostos për ndërtimin e shtëpisë së komunitetit në fshatin Stanoc i Poshtëm është shumë e vogël, por megjithatë është e mirëseardhur.

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 24 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Rrahim Ajeti, kryetar i Këshillit të fshatit Stanoc i Poshtëm i ndahen mjete financiare në shumë prej tremijë euro (3,000.00 €), ndihmë financiare për rregullimin e kulmit të shtëpisë së komunitetit në fshatin Stanoc i Poshtëm.

2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 470.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Pyetje dhe përgjigje

Refik Maloku, anëtar i kuvendit –duke u nisur nga obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, dhe mjete që i janë marr Komunës së Vushtrrisë, pyeti se sa nga këto mjete iu kanë dalë në llogaritë bankare mësimdhënësve të Komunës së Vushtrrisë, duke u bërë dallim dhe duke u bërë e ditur se sa para kanë shkuar në kontot e mësimdhënësve, sa tek avokatet dhe sa tek përmbaruesit privat, kjo do të mund të zgjidhej me një raport nga ana e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Tutje ai vlerësoi se kryetari Idrizi, është duke kamufluar, kur deklaroi se sikur këto mjete do ti paguante Qeveria e Kosovës, nuk do të dëmtohej komuna, por me çfarë akti juridik do të mund ti paguante këto mjete Qeveria e Kosovës, kur dihet se këto kontrata janë nënshkruar nga qeveritë e kaluara të Kosovës.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës–duke ju referuar diskutimit të parafolësit, sqaroi se anëtari i kuvendit që është edhe mësimdhënës, duhet të dijë se ka lidhur marrëveshje me avokatin për përfaqësimin e tij dhe ai duhet ti dijë këtë çështje. Më tej shtoi se z. Maloku nuk ka nevojë ta mbroj Qeverinë e Republikës së Kosovës sepse ajo është e Kosovës nuk është vetëm e një individi, dhe sqaroi se përkund kësaj për përmbushjen e kontratës kolektive ka qenë e obliguar Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, pavarësisht se ministria aktual e i kësaj qeverie nuk është nënshkruar i kësaj kontrate.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –pyeti kryetarin e komunës se kur do të bëhet shtrirja e rrjetit të ujësjellësit për të gjitha fshatrat e komunës, e konkretisht në fshatin Stanoc i Epërm, ku kryetari ka deklaruar se do të vendosen disa pompa, por kjo gjë edhe pse ka filluar nuk po shihet se është duke përfunduar dhe po ashtu kur pritet që ky projekt për furnizim me ujë të pijes do të përfundoj.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës–sqaroi se procesi për vendosjen e pompave të ujit është duke vazhduar dhe pritet të përfundoj shumë shpejt, një vështirësi është vonesa për pajisje me pëlqime nga ana e KEDS-it.

Sylejman Mehollit, anëtar i kuvendit – në emër të LVV-së në Vushtrri, urojë të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë të besimit islam Muajin e Shenjët të Ramazanit duke ju uruar shëndet e begati në familjet e tyre.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVË



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 5 MARS 2025 PËR NDER TË EPOPESË SË UÇK-së

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:05.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Blerina Shala, Basri Menxhiq, Melihate Basholli-Latifi, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nurie Halili, Jeton Gjaka, Faton Hyseni, Ramadan Parduzi, Zojë Hajrizi, dhe Ymer Haradinaj.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që munguan në mbledhje: Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Bujar Pllana, Edona Gashi, Leonora Gërguri, Fakte Dushi, Fatmire Cecelia, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Mek Selaci, Spasoje Stefanoviç, Shkelzen Xhaferi, Refik Maloku, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, dhe Sylejman Meholli.

Kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, nënkryetarja e komunës znj.Hava Mlinaku-Rruka, drejtorët e drejtorive komunale, Komandanti i Policës në Vushtrri, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, anëtarë të familjeve të dëshmorëve, përfaqësues të subjekteve politike në Vushtrri, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtarë tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë ka kuorum të mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Në fillim të mbledhjes u intonua himni kombëtar dhe ai shtetëror i Kosovës, në nderim të jetës dhe veprës së Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe Epopesë së UÇK-së.

Më pas kuvendi me një minutë heshtje nderoi jetën dhe veprën e Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe gjithë të rënëve për liri.

Melihate Basholli-Latifi – kryesuese e kuvendit- I nderuari Kryetar i komunës, z. Ferit Idrizi;
I nderuari nënkryetar e komunës, znj.Hava Mlinaku-Rruka;

Të nderuar drejtorë të drejtorive;

Të nderuar anëtarë të kuvendit;

Të çmuar familjarë të dëshmorëve, të veteranëve, të invalidëve, të martirëve e të rënëve për liri;

Të nderuar përfaqësues të organizatave të dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

Të nderuar përfaqësues të partive politike;

Të nderuar përfaqësues të policisë së Kosovës;

Të nderuar përfaqësues të mediave, të shoqërisë civile dhe ju të pranishëm;
Zonja dhe zotërinj;

Shumë të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë.

Jam e nderuar dhe e privilegjuar të shpall të hapur këtë seancë të veçantë solemne kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rënies heroike të Komandantit legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari, Dëshmorëve, Martirëve dhe të Rënëve për lirinë e vendit tonë

Të nderuar të pranishëm

Në këtë përvjetor të 5, 6 dhe 7 marsit, ne përkujtojmë sakrificën sublime, botërisht unike, të familjes Jashari, e cila me guxim dhe vendosmëri e saj u bë simbol i qëndresës dhe i luftës për çlirim.

Kujtojmë me dhembje e krenari dëshmorët, martirët, të rënët e viktimat civile, Nderojmë me respekt të veçantë veteranët e invalidët e luftës, të burgosurit politikë dhe të gjithë ata që kontribuuan me përkushtim për çlirimin dhe shtetndërtimin e Kosovës. Në këto ditë përkujtimore, ne reflektojmë mbi rrugën e gjatë, të vështirë e të mundimshme drejt lirisë, por edhe mbi krenarinë që bartim si pasardhës të atyre që sakrifikuuan gjithçka për Kosovën, shtet të lirë dhe të pavarur. Historia e komandantit legjendar Adem Jashari dhe e familjes Jashari, historia e luftës heroike e UÇK-së, historia e sakrificës kombëtare na kujton se liria nuk na është falur, por atë e kemi fituar me gjak, andaj kjo liri është një amanet i shenjtë, të cilin duhet ta mbrojmë me përkushtim dhe unitet. Sot, në përvjetorin e 27 të Epopesë së UÇK-së, na mungojnë figurat kyqe, udhëheqësit e saj, burra të guximshëm, të cilët me vendosmëri dhe sakrificë udhëhoqën luftën për liri dhe drejtuan popullin tonë drejt çlirimit. Ata ende po mbahen padrejtësisht në Hagë, për një luftë që ishte e drejtë, e pastër dhe çlirimtare falë së cilës sot Kosova dhe populli i saj jetojnë të lirë. Historia nuk mund të zhbëhet, ajo nuk rishkruhet, andaj ne do të vazhdojmë ta mbrojmë të vërtetën dhe të kërkojmë drejtësi për çlirimtarët.

Të nderuar të pranishëm, Sa herë i kujtojmë heronjtë tanë, ne riafirmojmë vlerat dhe idealet për të cilat ata ranë, si dhe rikujtojmë se është përgjegjësia jonë që të punojmë me vendosmëri për ta realizuar ëndrrën shekullore të kombit tonë, duke e forcuar dhe zhvilluar shtetin që ata e ëndërruan. Qoftë i përjetshëm nderimi e kujtimi për kryekomandantin legjendar Adem Jashari dhe Familjen e tij! Qoftë i përjetshëm nderimi e kujtimi për Dëshmorët, Martirët e të rënët për këtë vend, brez pas brezi! Qofshim ne ata që e mbajmë gjallë idealin e tyre dhe ndërtojmë një të ardhme të denjë me themele në synimet tona kombëtare shekullore!

Ju faleminderit për vëmendje!

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë—në fillim të diskutimit të tij përshëndeti gjithë të pranishmit: Të nderuara familje të dëshmorëve; Të nderuara familje të martirëve; Të nderur ish të burgosur politik; I nderuar kryetar i Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; I nderua Komandant i Stacionit Policor në Vushtri; Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë; Të nderuar përfaqësues të subjekteve politike në Vushtri; E nderuar nënkryetare e komunës, kryesuese e kuvendit, drejtor të drejtorive komunale, gjithë ju të pranishëm; Të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrrisë:

Sot është një ditë e veçantë edhe për nga dimensionin historik, edhe për nga festa e madhe historike, por edhe për nga lavdia që nuk ka penë e as shkrim që mund t'i thurë lavditë dhe ta përshkruajë në detaje këtë ditë të madhe. Është epopeja e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është fillimi i një epoke të re, është fillimi i një dekade të re, është lufta çlirimtare e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, është qëndresa heroike e familje Jashari, është lufta unike për liri dhe pavarësi kombëtare, është lufta e cila kulmoi me involvimin e faktorit ndërkombëtar, është lufta që bëri botën demokratike dhe faktorin ndërkombëtar, të kthejnë kokën kah shqiptarët e Kosovës që luftuan gjatë për liri dhe pavarësi që kur u nda Shqipëria në vitin 1913 dhe u futën forcat serbe në këto territore. Lufta jonë ka vazhduar përgjatë gjithë historisë me sakrificën më sublime në vitin 1918-1924, për të vazhduar në vitin 1945, sakrificat në demonstratat e vitit 1968, 1981, greva e minatorëve e vitit 1989, rezistenca paqësore e viteve 90 —ta, që kulmoi me daljen në

skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me 28 nëntor 1997 dhe në fund sakrificë sublime e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij dhe deri në atë kohë faktori ndërkombëtar i shikonte karshi proceset që po zhvilloheshin në trojet shqiptare, veçanërisht në Kosovën e okupuar të gjakosur e të robëruar nga okupatori serb. Por Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij i aktivizoi mekanizmat ndërkombëtarë dhe ishte vetë ambasadori amerikan ai i cili kishte dhënë një deklaratë ndryshe për Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte i pari Robert Gelbard që i shprehu ngushëllime familjes Jashari dhe ishte diplomacia ndërkombëtare e cila iu kthye fuqishëm në mbështetje popullit shqiptar në mbështetje të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo shënon kthesën nga një luftë guerile në një luftë frontale të përmasave kombëtare ku u thirr edhe mobilizimi i përgjithshëm. Ishte kjo koha më e lavdishme, por pa armatim të mjaftueshëm për të gjithë ata vullnetarë dhe vullnetare të cilët prisnin në rresht për të ngjitur Bjeshkëve të Nemura për ta kaluar kufirin Kosovë-Shqipëri, për të arritur deri në Tropojë për t'u armatosur dhe për t'ju bashkëngjitur luftës çlirimtare. Prandaj sot në këtë ditë të shenjtë në epopenë e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, sot shënojmë epopenë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sot flamujt valojnë lirshëm në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjithçka që ndodhi gjatë historisë sonë kulmoi me lirinë dhe pavarësinë e Kosovës e cila për 100 vjet ishte e okupuar nga barbarët serbë. Andaj ne të gjallët jemi të privilegjuar, ne të gjallët jemi me fat që e pritëm këtë ditë dhe e festojmë këtë ditë në mënyrën më të mirë në vendin tonë në institucionet tona, të bashkuar i gjithë spektri politik i Kosovës, bashkë me shoqatat e dala nga lufta dhe me familjet e dëshmorëve, bashkë me veteranët dhe invalidët e UÇK-së, ata që i lanë gjymtyrët e tyre në betejat e luftës vetëm e vetëm për t'ia sjellë lirinë Kosovës.

Në fund ai apeloj për të gjithë që në ditë festive të këtyre datave të gjithë të jemi të bashkuar, sepse të gjithë jemi hisedar të këtyre festave, të bashkohemi rreth sakrificës së Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse emblema e UÇK-së është vula e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Lavdi e nderim jetës dhe veprës të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij dhe gjithë dëshmorëve të kombit respekt!

Gëzim Zuçaku, kryetar i Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve - në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit pasi përshëndeti gjithë të pranishmit, tha se sot, me krenari kujtojmë ditët e Epopesë së UÇK-së: 5, 6 dhe 7 marsin e 1998 – ë. Me krenari kujtojmë luftën e Komandantit Legjendar Adem Jasharit. Me krenari kujtojmë sakrificën e madhe të Jasharëve legjendarë. Nuk ka përkufizim gjuhësor, historik dhe filozofik që kap përmasat e kësaj sakrifice. Kjo Epope mori përmasat e ngjarjeve të krijimit të botës së re në hapësirat gjeografike shqiptare, të ndërrimit të epokës së robërisë nga epoka e lirisë. Në ditët e Epopesë së UÇK-së u sprovuan vlerat më të larta të kombit: trimëria, besnikëria dhe shpirti heroik. Përmasa e flijimit historik mori dimensione legjendare. Ato ditë heroike nuk u bënë gërmadha kullat e Jasharëve, në të vërtetë, gërmadhë u bë sundimi serb në Kosovë. Gurët e kullave të Jasharëve u bënë gurë të piramidave kufitare të shtetit të Kosovës. Prandaj kjo sakrificë legjendare për liri u bë model unikat në historinë kombëtare dhe botërore. Njerëzit shpirtmëdhenj jo vetëm prekën historinë, por i dhanë trajtë asaj. Dhe çmimi ishte i lartë, por, faqja e historisë u bë shumë e ndritshme. Me luftën dhe rënien e tyre UÇK-ja u rrit në përmasa gjithëkombëtare, diplomacia botërore u vu në anën e luftës së drejtë të shqiptarëve. Me të drejtë, në analet e historisë moderne botërore. Ushtria Çlirimtare e Kosovës vlerësohet si projekti më i suksesshëm politiko-ushtarak. Vizioni politik i UÇK-së krijoi parakushtet për intervenimin e Aleancës më të fuqishme ushtarake në interes të vendit tonë. Në këto ditë të shënuara ndjejmë dhimbje të madhe sepse krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantët e saj gjenden

padrejtësisht në Tribunin e Hagës, sepse në këtë rast nuk akuzohet individi, por akuzohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto përmasa që po zhvillohet rendi i ri ndërkombëtar, besojmë dhe shpresojmë se do ta kuptojnë se Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e drejtë dhe e saktë dhe se ne nuk ishim agresorë, por ishim viktimë, ne shpresojmë që krerët e UÇK-së shumë shpejt të lirohen dhe të kthehen fitimtar në Kosovë. Lavdi Komandantit Legjendar Adem Jashari, lavdi gjithë Dëshmorëve të kombit, nder dhe respekt për gjithë invalidët dhe veteranët e UÇK-së, urime Epoja e UÇK-së, Zoti e Bekoftë Republikën e Kosovës dhe popullin e saj.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para kuvendit si përfaqësues i LDK-së pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi:

Sot jemi mbledhur këtu për të kujtuar një nga momentet më të lavdishme të historisë sonë kombëtare – Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këto ditë marsi nuk janë thjesht data në kalendar, por janë dëshmi e sakrificës, guximit dhe dashurisë së pashoq për atdheun. Në marsin e vitit 1998, në Prekaz, Adem Jashari dhe familja e tij u bënë simboli i qëndresës dhe i luftës për liri. Për tri ditë me radhë, ata qëndruan të pathyeshëm përballë një armiku të egër, duke mos u dorëzuar kurrë. Kjo sakrificë e jashtëzakonshme nuk ishte vetëm një akt heroizmi, por ishte thirrja që zgjoj gjithë kombin dhe e bëri të pamundur kthimin pas. Ushtria Çlirimtare e Kosovës u bë shpresa dhe mburoja e popullit tonë. Bijtë dhe bijat më të mirë u rreshtuan në radhët e saj, të gatshëm të japin gjithçka për lirinë e Kosovës. Ishte një luftë e drejtë, një luftë për ekzistencë, për dinjitet dhe për të ardhmen e brezave tanë. Sot, ndërsa përulemi me respekt përpara dëshmorëve dhe të rënëve për liri, kemi një amanet për të çuar përpara: ta ruajmë dhe ta forcojmë shtetin tonë, ta mbrojmë pavarësinë dhe sovranitetin e tij dhe të punojmë çdo ditë për një Kosovë më të zhvilluar, më të drejtë dhe më të bashkuar. Lavdi dëshmorëve të kombit!

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para kuvendit si përfaqësues i LVV-së në Vushtrri pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit deklaroi:

Sot me përulësi dhe respekt të thellë përkujtojmë ditët e lavdisë 5,6 dhe 7 marsin e vitit 1998 kur Adem Jashari dhe familja e tij bënë sakrificën më sublime për lirinë e vendit. Me 5,6 dhe 7 mars të vitit 1998 pra 27 vite më parë anëtarë e familjes Jashari, rezistuan në vendlindjen e tyre, aty ku ndër breza kishin mësuar si ta duan atdheun e tyre dhe ku ishin edukuar për të luftuar për lirinë e tij edhe duke sakrifikuar jetën e tyre. Në familjen e Shaban Jasharit në Prekaz u luftua për tri ditë rresht me një rrethim të blinduar disa mijëra trupa policore e ushtarake të Serbisë, që me makinerinë ushtarake në përmasa frontale goditen me predha dhe bombarduan me ritëm shumë intensive mbi shtëpinë e Shaban Jasharit duke vrarë gjithsejtë 59 njerëz. Lufta dhe sakrifica e familjes Jashari, nuk ishte thjesht një akt mbrojtje por një mesazh i fuqishëm për të gjithë kombin se liria nuk dhurohet por fitohet me gjak dhe sakrificë. Guximi i tyre ndezi shpirtin e popullit tonë dhe forcoj rrugën drejt çlirimit të Kosovës. Sot ne si përfaqësues të popullit në nivel lokal dhe kombëtar kemi detyrë që këtë sakrificë ta nderojmë jo vetëm me fjalë por edhe me vepra. Përgjegjësia jonë është Kosova të jetë një shtet i fort i drejt i zhvilluar ashtu siç ëndërruan ata që dhanë jetë për këtë tokë Lavdi Komandanti legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij Lavdi gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës!

Mbledhja përfundoi në ora: 10:35

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



R A P O R T
PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE PËR VITIN 2024

Mars 2025

Hyrje

Raporti për situatën ekonomike financiare dhe zbatimin e planeve investuese është i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe Planin e Punës për vitin 2024. Në këtë raport është paraqitë puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës përkatësisht Ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave si dhe përgjegjësi të tyre gjatë këtij viti raportues.

Nga të dhënat që janë marrë nga zyrtarë përgjegjës komunal, është parë se Kryetari dhe Qeveria komunale që nga fillimi i punës së tyre kanë mbajtur takime javore me drejtor të drejtorive ku është diskutuar për prioritetet e punëve që duhet kryer brenda javës si dhe obligimet për të raportuar për punët e kryera.

Gjithashtu është pasqyruar puna dhe aktivitetet e shumta me qytetarë ku përveç një takimi i cili është mbajtur në muajin qershor 2024 janë mbajtur edhe takime tjera me rastin e shqyrtimit të draft buxhetit dhe projekteve prioritare për vitin vijues në të cilat qytetarët i kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat për prioritetet e projekteve në meset e tyre. Takimin e dytë me qytetarë e kemi mbajtur në mbarim të muajit dhjetorë 2024 ku i kemi njoftuar qytetarët me punë dhe projektet të cilat janë kryer gjatë vitit 2024 si i kemi shpallur prioritetet tona për projektet e planifikuara për vitin 2025, të miratuara në kuvendin e komunës.

Gjatë vitit 2024 sfida kryesore ka qenë përballja me pagesat e projekteve kapitale për shkak të mungesës së mjeteve financiare (rreth 4 milion euro) të cilat i kanë marrë avokatët dhe përmbaruesit për punëtorët e arsimit bazuar në kontratën kolektive të nënshkruar më herët në mes të sindikatës së arsimit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky trend i marrjes së mjeteve financiare ka vazhduar edhe në fillim të këtij viti për shkak të pamundësisë së realizimit të pagesave në fund të vitit të kaluar. Mirëpo edhe përkundër këtyre vështirësive me të cilat jemi ballafaquar kemi arritur që ta realizojmë buxheti në shkallë deri diku të kënaqshme.

Duhet përmendur edhe faktin që disa projekte kanë qenë dy vjeçare dhe si të tilla do të realizohen brenda vitit 2025.

Ndër punët dhe aktivitetet që duhet përmendur:

- Raportimi i rregullt në kuvendin e komunës – çdo tre muaj, për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore,
- Mbikëqyrja e realizimit të buxhetit të komunës për vitin fiskal dhe realizimit i të hyrave vetanake edhe pse në vitin 2024 siç dihet qytetarët i kemi liruar nga pagesa e tatimit në pronë.
- Mbikëqyrja e realizimit të projekteve kapitale të komunës,
- Propozim-aktet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje të kuvendit të komunës,
- Mbikëqyrja në zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës,
- Bashkëpunimi me komunitetin për realizim të projekteve të ndryshme,
- Bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe organizata të ndryshme humanitare për realizim të projekteve me bashkëfinancim me interes për komunën dhe qytetarët,
- Mbikëqyrje në ngritjen e performancës në administratën e komunës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarë etj.

Në vijim të këtij raporti do të paraqitet realizimi i punëve dhe aktiviteteve brenda vitit 2024, përkatësisht planet investuese të komunës sipas drejtorive.

Buxhet dhe Financa

Planifikimi i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 14,270,146.65€
- Mallra dhe shërbime..... 5,122,737.49€
- Shpenzime Komunale..... 580,268.14€
- Subvencione dhe transfero..... 1,238,679.78€
- Investime kapitale..... 8,176,845.45€

Totali i buxhetit për vitin 2024 është..... 29,388,677.51€

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2024

- Paga dhe mëditje14,268,928.57€
- Mallra dhe shërbime..... 4,932,681.87€
- Shpenzime Komunale..... 486,810.28€
- Subvencione dhe transfero.....
1,227,390.03€
- Investime kapitale..... 6,569,464.22€

Totali i shpenzimeve..... 27,485,274.97€

Realizimi i shpenzimeve është 94 %

Planifikimi i të Hyrave Vetanake për vitin 2024 janë 3,418,154.0

Realizimi i të hyrave për këtë periudhën është 3,307,582.93€

Shprehur në përqindje 96.77 %

PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2023
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2024	Buxheti i mbetur për 2024	Plan i revduar 2024	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të revduar	
		4	5	6 = 5/4*100 %	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11
		€	€		€	€	€	€	€
Financimi nga huamarjet	04			0%		0.00	0.00	0.00	
Granti Qeveritar	10	24,380,000.61	23,348,947.44	96%	24,380,000.61	1,031,053.17	0.00	24,380,000.61	21,241,894.59
Të hyrat vetanake	21	3,418,164.08	2,764,622.38	81%	3,418,154.08	663,531.72	0.00	3,418,154.08	2,428,384.86
Mjetet e bartura	22	1,560,105.42	1,387,309.48	88%	1,560,105.42	192,795.96	0.00	1,560,105.42	2,569,782.34
Donacionet e brendshme	31	6,623.23	2,000.00	36%	5,623.23	3,623.23	0.00	5,623.23	1,848.00
Donacionet e jashtme	32	24,794.17	12,396.71	50%	24,794.17	12,398.46	0.00	24,794.17	
TOTALI		29,388,677.51	27,485,274.97	94%	29,388,677.51	1,903,402.54	0.00	29,388,677.51	26,241,909.79

Sqarim:

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit sipas kategorive ekonomike është si vijon:

Granti Qeveritar për periudhen Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është 24,380,000.61euro,Realizimi është 23,348,947.44eur,përqindja e realizimit 96%

Kategoria Të Hyrat vetanake Fondi 21 për periudhen Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është 3,418,154.08 euro,Realizimi I shpenzimit shuma 2,754,622.36euro.

Shprehur në përqindje realizimi është 81%

Kategoria Të Hyrat vetanake Fondi 22 për periudhen Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është 1,560,105.42 euro,Realizimi I shpenzimit shuma 1,367,309.46euro.

Shprehur në përqindje realizimi është 88%

Donacionet e brendshme dhe Donacionet e jashtme planifikimi 5,623.23euro,realizimi 2,000.00euro,shprehur realizimi 36%

Donacionet e jashtme planifikimi 24,794.17euro,realizimi 12,395.71euro,shprehur realizimi 50%

Planifikimi total sipas burimeve të financimit është shuma 29,388,677.51euro.Realizimi është 27,485,274.97euro .Përqindja e realizimit 94%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE

PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti I kaluar Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë të 2023
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti I planifikuar për 2024	Buxheti I mbetur për 2024	Plan I reviduar 2024	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	
		€	€	%	€	€	€	€	€
Paga dhe mëditje	111	14,270,148.66	14,268,928.67	100%	14,270,146.65	1,218.08	0.00	14,270,146.65	12,141,466.83
Mallra dhe shërbime	130	5,122,737.49	4,932,881.87	96%	5,122,737.49	190,055.62	0.00	5,122,737.49	4,419,302.10
Shpenzimet komunale	132	580,268.14	486,810.28	84%	580,268.14	93,457.86	0.00	580,268.14	447,458.24
Subvencionet dhe transfere	200	1,238,679.78	1,227,390.03	99%	1,238,679.78	11,289.75	0.00	1,238,679.78	1,129,213.10
Investimet kapitale	300	8,176,846.45	6,669,464.22	80%	8,176,845.45	1,607,381.23	0.00	8,176,845.45	6,103,301.64
TOTALI		29,388,677.51	27,485,274.97	94%	29,388,677.51	1,903,402.54	0.00	29,388,677.51	26,240,730.81

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive të larta të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike është si vijon:

Kategoria e Pagave dhe mëditje për periudhën Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është 14,270,146.65euro,Realizimi është 14,268,928.57eur,përqindja e realizimit 100%

Kategoria Mallra dhe shërbime për periudhën Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është5,122,737.49euro,Realizimi I shpenzimit shuma 4,932,681.87euro,shprehur në përqindje realizimi është 96%

Kategoria Shpenzimet komunale për periudhën Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është580,268.14euro,Realizimi I shpenzimit shuma 486,810.28euro,shprehur në përqindje realizimi është84%

Kategoria Subvencionet dhe transferetpër periudhën Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është 1,238,679.78euro,Realizimi I shpenzimit shuma 1,227,390.03euro,shprehur në përqindje realizimi është 99%

Kategoria Investimet kapitale periudhën Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është 8,176,845.45euro,Realizimi I shpenzimit shuma6,569,464.22euro,shprehur në përqindje realizimi është 80%

Planifikimi sipas kategorive ekonomike për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është 29,388,677.51euro.Realizimi është 27,485,274.97euro,shprehur në përqindje 94%

Emri i Komunës :		VUSHTRRI							
Kodi i Komunës:		644							
		Janar - Dhjetor 2024							
Periudha raportuese									
PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VIETORE				Viti i kaluar
		BUXHETI PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2024	Buxheti i mbetur për 2024	Plani i reviduar 2024	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2023
		€	€	%	€	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	525,895.38	515,304.59	98%	525,895.38	10,590.79	0.00	525,895.38	572,082.49
Administrata dhe personeli	163	538,664.06	520,354.88	97%	538,664.06	18,309.18	0.00	538,664.06	512,490.33
Inspektimet	166	140,011.32	139,752.82	100%	140,011.32	258.50	0.00	140,011.32	130,035.59
Prokurimi	167	56,129.91	55,816.47	99%	56,129.91	313.44	0.00	56,129.91	48,998.76
Zyra e Kuvendit Komunal	169	282,298.63	277,165.31	98%	282,298.63	5,133.32	0.00	282,298.63	285,331.43
Buxheti dhe financat shtesore pa arritur, Mbrojtja civile dhe emergjenca	175	208,137.66	206,827.64	99%	208,137.66	1,310.02	0.00	208,137.66	185,119.68
Zyra lokale e komuniteteve	180	5,438,974.53	4,943,912.10	91%	5,438,974.53	495,062.43	0.00	5,438,974.53	5,085,423.41
Zyra lokale e komuniteteve	195	87,791.74	82,756.59	94%	87,791.74	5,035.15	0.00	87,791.74	72,251.72
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	1,001,407.95	973,243.33	97%	1,001,407.95	28,164.62	0.00	1,001,407.95	1,237,814.36
Gjeodezi dhe Kadastër	650	102,813.99	101,757.49	99%	102,813.99	1,056.50	0.00	102,813.99	77,586.15
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	3,581,699.68	3,019,770.98	84%	3,581,699.68	561,928.70	0.00	3,581,699.68	2,765,277.03
Shëndetësia primare	730	3,269,207.82	3,107,576.65	95%	3,269,207.82	161,631.17	0.00	3,269,207.82	3,301,479.00
Shërbimet sociale rezidenciale		339,476.91	311,410.82	92%	339,476.91	28,066.09	0.00		281,983.93
Kulturë, rini, sport	850	646,519.77	477,081.50	74%	646,519.77	169,438.27	0.00	646,519.77	574,394.70
Arsimi	920	13,169,648.16	12,752,543.80	97%	13,169,648.16	417,104.36	0.00	13,169,648.16	11,130,462.23
TOTALI		29,388,677.51	27,485,274.97	94%	29,388,677.51	1,903,402.54	0.00	29,388,677.51	26,240,730.81
Planifikimi sipas programeve ekonomike për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është 29,388,677.51euro.									
Realizimi është 27,485,274.97euro, shprehur në përqindje 94%									

Ekonomi

Sektori për biznes

Qendra Komunale e Biznesit vepron në kuadër të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës - Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. QKB –ja funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare, kërkesa për ndryshim si dhe shërbime të tjera. Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Europian

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01. – 31.12.2024

CODE	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-31.12.2024	%
I	2	3	4
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	34	10.86
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	34	10.86
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë		
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të trjatumit të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria	35	11.18
G	Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	87	27.80
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	5	1.60
I	Transporti dhe magazinimi	18	5.75
J	Informimi dhe komunikimi		
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	18	5.75
	Aktivitetet e patundshmërisë	26	8.31
	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse		
M	Arsimi	24	7.67
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	21	6.71
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese	3	0.96
P	Aktivitetet e ekonomive familjare	8	2.55
	Gjithsej	313	100

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, si veprimtari dominuese ekonomike është tregtia me 27.80% apo me 87 biznese prej numrit të përgjithshëm, pastaj, ndërtimtaria me 11.18 % apo me 35 industria përpunuese me 34 biznese apo me 10.86 %, bujqësia me 10.86% apo me 34 biznese,etj.

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të shuar, sipas veprimtarive ekonomike.

Kodi	VEPRIMTARIT EKONOMIK	Bizneset prej 01.01-31.12.2024	%
I	2	3	4
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	5	6.58
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	11	14.47
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë		
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të trjtitimit të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria	5	6.58
G	Treg,me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	21	27.63
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	4	5.26
I	Transporti dhe magazinimi Informimi dhe komunikimi	9	11.84
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	3	3.95
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	12	15.80
M	Arsimi		
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	6	7.89
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese		
P	Aktivitetet e ekonomive familjare		
	Totali	76	100

Siç shifet nga të dhënat e tabelës edhe tek shuarjet dominon po ashtu tregtia me 21 biznese apo me 27.63 % etj.

Përveç shërbimeve të lartshënuara, Sektori i Bizneseve ka kryer edhe lëndë të tjera si:

- Leje Pune per Auto Taxi - /
- vazhdimin e lejeve për transportin autotaxi 40
- dhënja e çertifikatave per kontribute - vitet e '90 15

Drejtoria për Ekonomi dhe Investime Kapitale bën përpjekje që të përmirësojë maksimalisht kushtet e të bërit biznes dhe që konform ligjeve, të mbështesë bizneset drejt zhvillimit të tyre të mëtejme, të krijojë kushte për zbutjen e papunësisë, të krijojë një klimë edhe më të favorshme për të gjitha bizneset që operojnë në territorin e komunës sonë.

Gjatë viteve të fundit shihet një zhvillim i hovshëm i bizneseve, të cilat kanë filluar të prodhojnë jo vetëm për tregun e Kosovës, por edhe me mundësi të eksportit jashtë vendit. Kjo vlen sidomos për kompanitë e mëdha si ato prodhuese, përpunuese etj.

Objektivat e sektorit për zhvillim ekonomik – biznes janë:

- ofrimi i shërbimeve të avancuara për biznese;
- zvogëlimi i numrit të bizneseve pasive;
- bashkëpunimi më i ngushtë me biznese e sidomos me ato prodhuese, të cilat mund të gjenerojnë vende të reja të punës;
- vizitat më të shpeshta nëpër biznese me qëllim që të njihen me mundësitë e zgjerimit të bizneseve të tyre;
- Drejtoria për Ekonomi dhe Investime Kapitale është e hapur çdoherë për bashkëpunim me shoqatat e ndryshme afariste, por edhe për çfarëdo kërkesë që vjen nga ato;
- themelimi dhe bashkëpunimi dhe më i ngushtë me mes të shoqatës afariste dhe Drejtorisë për Ekonomi dhe Investime Kapitale, etj.

Administratë

Përmes këtij raporti, janë paraqitë objektivat e arritura, aktivitetet kryesore, dhe gjithashtu, janë adresohen disa nga sfidat që janë hasur gjatë vitit, duke siguruar një pamje të qartë të përparimit të bërë dhe hapave të ardhshëm për zhvillimin e administratës në nivel lokal.

Gjatë vitit të kaluar, Drejtoria ka realizuar një sërë aktiviteteve që kanë pasur si qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e mjedisit të punës. Përveç angazhimit për modernizimin e proceseve administrative dhe rritjen e efikasitetit në shërbimet publike, ne kemi organizuar trajnime për menaxhimin e stresit, për zbatimin e Kodit Etik dhe për parandalimin e ngacmimit seksual në vendin e punës. Këto trajnime kanë qenë pjesë e një iniciative të gjerë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe krijimin e një ambienti pune të sigurt dhe respektues për të gjithë punonjësit.

Drejtoria e Administratës është angazhuar të jetë një mundësues i zhvillimit dhe përparimit të Komunës së Vushtrrisë, duke kontribuar në forcimin e shërbimeve publike dhe garantimin e një administrate transparente dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. Zyra e Gjendjes civile;
2. Sektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informativë;
3. Qendra për Shërbim me Qytetar;
4. Zyra për të Drejtat e Njeriut

Objektiv i përgjithshëm strategjik i Drejtorisë ka qenë:

1. Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e-qeverisjes të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.
2. Arkivimi elektronik dhe digjitalizimi i arkivit komunal,

Me qëllim të realizimit të këtyre objektivave dhe të funksionalizimit dhe digjitalizimit të administratës drejtoria për administratë të përgjithshme ka marr iniciativën e hartimit të tri(3) akte administrative që kanë të bëjnë me rregullimin e kësaj fushe:

1. **Listën e Shenjave të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre për Komunën e Vushtrrisë,**

2. **Rregullat për Administrimin dhe Menaxhimin Zyrtar të Dokumenteve dhe Arkivimin e tyre dhe**

3. **Udhëzuesin për informacione lidhur me shërbimet komunale,**

Po ashtu gjatë këtij viti kemi zhvilluar dy takime pune me delegacionin e komunës së Vaxjës në projektin e përbashkët, “**Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal**”, projekt ky që do të zgjasë tri(3) vite me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes të dy delegacioneve të komunës së Vushtrrisë dhe të komunës së Vaxjës për avancimin dhe standartizimin e procedurave për funksionalizimin dhe digjitalizimin e arkivit komunal.

Ne pas tri(3) takimeve pune që i kemi mbajtur një në komunën e Vushtrrisë dhe dy(2) në komunën e Vaxjës në Suedi, kemi marr shumë përvoja të mira dhe kemi arritur që disa nga këto përvoja edhe ti bartim në këto akte administrative që i kemi hartuar.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë proceduar dhe realizuar këto projekte:

- Rimodelimi dhe inventarizimi i sallës së takimeve;
- Ridizajnimi i qendrës për shërbim të qytetarëve dhe krijimi i 8 sporteleve në pjesën hyrëse(katin përddes) të komunës për ofrimin e shërbimeve komunale që kanë të bëjnë me qytetarët.
- Renovimi dhe funksionalizimi i toaleteve
- Ngjyrosja e mureve në sektorin e gjendjes civile
- Libërlidhja e akteve dhe dokumenteve të ndryshme;
- Libërlidhja e protokollit të komunës për vitin 2023

Si dhe procedurat e rregullta për furnizime:

- Furnizim me pajisje të TI;
- Furnizim me inventar
- Furnizimi me karrig

Zyra e Gjendjes Civile

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit dhe planin e punës janë paraparë 8 objektiva për vitin 2024. **Objektivat kryesorë të sektorit kanë qenë:**

1. Ngritja e efikasitetit dhe efektitetit gjatë përditësimit të shënimeve dhe të dhënave personale të qytetarëve në Regjistrin Qendror Elektronik të gjendjes Civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik.
2. Shqyrtimi i kërkesave në mënyrë të drejtë dhe nxjerrja e vendimeve për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes.
3. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të fakteve të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar dhe në regjistrin qendror të gjendjes civile, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore duke krijuar dosje për së cilën rast dhe arkivimi i tyre.
4. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të martesave brenda orarit të punës dhe regjistrimi i martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës, duke i shtypur dhe mbajtur aktet në mënyrë korrekte, cilësore dhe duke krijuar dosje për së cilën rast.
5. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të tjera të Gjendjes Civile, si dhe dhënia e shërbimeve të tjera në mënyrë efektive dhe pa gabime.
6. Azhurnimi i të gjitha kërkesave në intranet duke ju dhënë përgjigje dhe zgjidhje në mënyrë efektive dhe pa gabime.
7. Ndërlidhja dhe harmonizimi i të dhënave personale të gjendjes civile për të gjithë qytetarët ndërmjet regjistratit qendror elektronik të gjendjes civile me platformën(elektronike) online E-Kosova me qëllim që të krijohet mundësia e pajisjes(nxjerrjes) së certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë pa pasur nevojë që të kontaktohet zyra e gjendjes civile.

8. Ngritja e përgjegjësisë në ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parasheh ligji.

Për realizimin e këtyre objektivave në mënyrë efektive dhe efikase janë caktuar dhe ndërmarre 68 aktivitete dhe detyra.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të tjera:

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	01
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	29
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	01
3.	Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ	22
4.	Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik	51
5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	09
6.	Dëshmi të vdekjes	242
7.	Lajmërime dhe ç'lajmërime të adresës së vendbanimit	836
8.	Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes,	00
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes	05
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës	01
10.	Aplikime për natyralizim (fitim të shtetësisë)	207
11.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	13
12.	Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës	00
13.	Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë	00
Gjithsej regjistrime të bëra		1417

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	29571
2.	Certifikata të lindjes	4349
3.	Certifikata të martesës	4340
4.	Certifikata të vdekjes	3170
5.	Certifikata të Statusit martesor	185
6.	Certifikata të shtetësisë	221
7.	Certifikata familjare	3733
8.	Certifikata të vendbanimit	2407
9.	Vërtetim nga arkivi	390
Gjithsej		48366

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	118
2.	Martesa	553

3.	Regjistrime të vdekjes	345
4.	Regjistrime të Shtetësisë	216
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	557
6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	81
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	51
9.	Shkurorëzime	91
Gjithsejtë regjistrime të bëra		2012

Shërbimet online nga eKosova:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	10881
2.	Certifikata të lindjes	13053
3.	Certifikata të martesës	2905
4.	Certifikata të vdekjes	434
Totali		27273

Shërbimet online nga e Kiosku:

Nr.		Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	369
2.	Certifikata të lindjes	242
3.	Certifikata të martesës	52
4.	Certifikata të vendbanimit	58
5.	Certifikat e shtetësisë	16
Totali		737

Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Qendra për shërbim të qytetarëve në komunë gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të qytetarëve të Vushtrrisë, duke iu dhënë informacionet e duhura mbi kërkesat e tyre, duke iu ndihmuar në përpilimin e kërkesave dhe duke përcjellë përgjigjet në kërkesa nga të gjitha drejtoritë.

Përveç aktiviteteve dhe detyrave të përditshme zyrtarët e qendrës së shërbimeve të qytetarëve kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorëve të tyre siç janë, menaxherë të kontratave, komisione për vlerësim, komisione për pranim dhe në komisione të tjera sipas nevojave zyrtare.

Qendra për Shërbim të Qytetarëve në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për:

- Ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe
- Ofrimin e shërbimeve administrative, për qytetarët në kuadër të kompetencave vetanake apo të

Objektiv i përgjithshëm strategjik i Qendrës për Shërbim të Qytetarëve ka qenë:

1. Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e-qeverisjes të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.
2. Arkivimi elektronik dhe digjitalizimi i arkivit komunal,

Me qëllim të realizimit të këtyre objektivave dhe të funksionalizimit të digjitalizimit të administratës me kërkesën e Qendrës për Shërbim të Qytetarëve drejtoria për administratë të përgjithshme ka marr iniciativën dhe i ka hartuar tri(3) akte administrative që kanë të bëjnë me rregullimin e kësaj fushe:

1. **Listën e Shenjave të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre për Komunën e Vushtrrisë,**
2. **Rregullat për Administrimin dhe Menaxhimin Zyrtar të Dokumenteve dhe Arkivimin e tyre dhe**
3. **Udhëzuesin për informacione lidhur me shërbimet komunale,**

Po ashtu gjatë këtij viti kemi zhvilluar dy takime pune me delegacionin e komunës së Vaxjës në projektin e përbashkët, “**Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal**”, projekt ky që do të zgjasë tri(3) vite me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes të dy delegacioneve të komunës së Vushtrrisë dhe të komunës së Vaxjës për avancimin dhe standartizimin e procedurave për funksionalizimin dhe digjitalizimin e arkivit komunal që është kompetence e Qendrës për Shërbim të Qytetarëve.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë proceduar dhe realizuar këto projekte:

- Ridizajnimi i qendrës për shërbim të qytetarëve dhe krijimi i 8 sporteleve në pjesën hyrëse(katin përdhës) të komunës për ofrimin e shërbimeve komunale që kanë të bëjnë me qytetarët.
- Libërlidhja e protokollit të komunës për vitin 2023
- Përgatitja dhe trajnimi i zyrtarëve për përdorimin e mbështjellësve të lëndëve
- Përgatitja dhe trajnimi i zyrtarëve për përdorimin e sistemit SMAED
- Trajnimi i zyrtarëve në temat, zbatimin e kodit të etikës, mos ngacmimi seksual, menaxhimi i stresit në punë, etj.

Vazhdon perpjekja për implementim koncept dokumentit të punuar nga grupi punues për administratë të Komunës së Vushtrrisë në bashkëpunim me grupin punues nga Komuna e Vaxjës-Suedisë për një administratë digjitale dhe një arkiv digjital.

Sfidë për QSHQ-në mbetet plotësimi i numrit të zyrtarëve të cilët do të punojnë në këtë sektor dhe poashtu edhe organizimi i trajnimeve për të gjithë zyrtarët në këto fusha:

- a. Trajnimi për zbatimin e drejtë të akteve ligjore dhe nënligjore,
- b. Trajnimi për respektimin e kodit të etikës dhe menaxhimin e palëve të revoltuara,
- c. Trajnimi për fuqizimin e aktivizimin social, përmirësimin e shkathësive sociale të cilat do të ndikojnë në ruajtjen e mardhënieve për të punuar me të tjerët dhe krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për punë.
- d. Trajnimi për zbatimin e sistemeve elektronike(SMAED, arkivit elektronik dhe digjitalizimit)

Përveç aktiviteteve dhe detyrave të përditshme zyrtarët e qendrës së shërbimeve të qytetarëve kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorëve të tyre siç janë, menaxherë të kontratave, komisione për vlerësim, komisione për praninë dhe në komisione të tjera sipas nevojave zyrtare.

Tabela e mëposhtme përshkruan numrin e kërkesave të parashtruara në drejtorinë komunale të cilat janë pranuar nga zyrtarët e QSHQ-se.

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 62148 kërkesa, prej të cilave janë:

Nr.	Pershkrimi	Nr. Kerkesave
1	Drejtoria për Administratë	40097
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	8042
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2279
4	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1074
5	Drejtoria për Shërbime Publike	1060
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2146
7	Drejtoria për Arsim	816
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	664
9	Drejtoria për Inspeksion	619
10	Personeli	1561
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	506
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	326
13	Zyra Ligjore	1637
14	Kryetari i Komunës	176
15	Drejtoria e Prokurimit	35
16	Kuvendi i Komunës	66
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	11
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	6
19	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	613
20	Drejtoria për diasporë dhe Integritime Evropiane	0
21	Shërbime përmes thirrjeve telefonike(shërbim falas)	414
		62148

Qendra e Thirrjeve

Që nga 15 mars 2018, Komuna e Vushtrrisë inauguroi Qendrën e Thirrjeve për qytetarë. Ky zhvillim i rëndësishëm është realizim i drejtëpërdrejtë i shërbimeve më të mira për qytetarë dhe në shërbim të informimit dhe transparencës në funksionimin e Komunës.

- **Gjatë këtyre muajve, Qendra e Thirrjeve ka pranuar 414 telefonata të qytetarëve**

Numri i telefonatave gjatë kësaj periudhe ka qenë 414. Në 262 ditë pune sa ka pasur gjatë kësaj periudhe, mesatarja e thirrjeve ka qenë nga 1.58 telefonata në ditë. Një numër i tillë është ende i vogël në krahasim me potencialin që ka Qendra.

- **145 qytetarë kanë marrë informacion drejtëpërdrejt nga telefonata**

Është në vullnetin e punonjësve të Qendrës së Thirrjeve dhe në misionin e Qendrës që informatat të barten tek qytetari sa më parë. Në 145 telefonata, qytetarët nuk kanë pasur nevojë të parashtrajnë kërkesa të mëtutjeshme pasi kanë kryer shërbimin drejtëpërdrejtë me telefon dhe u është dhënë informacioni i kërkuar.

- **200 telefonata janë transferuar tek zyrtarë përgjegjës komunal**

Në 200 raste, telefonatat janë bartur tek zyrtarët përgjegjës komunal për procesim të mëtejshëm. Kjo ndodhë zakonisht kur informacionet ose kërkesat që bëhen janë të natyrave më specifike dhe për të

cilat departamente të veçanta komunale duhet të konsultohen. Qytetarët janë njoftuar menjëherë me pikën e kontaktit në komunë për atë informatë/kërkesë specifike dhe telefonatat janë transferuar aty.

- **48 kërkesa janë procesuar tek drejtoritë përkatëse**

Në 48 raste, Qendra e Thirrjeve ka procesuar, në emër të qytetarëve kërkesat e tyre tek Drejtoritë përkatëse të Komunës. Kjo eviton domosdoshmërinë e prezencës fizike të qytetarëve për të bërë kërkesa dhe u mundëson atyre që pa prezencë dhe pa pagesë të parashtrajnë kërkesa tek Drejtoritë komunale.

- **21 qytetarë kanë mbetur të informohen më vonë**

Një pjesë e kërkesave kanë mbetur të marrin informacione më vonë. Në të ardhmen, ndoshta Qendra mund të zhvilloj një mekanizëm përcjellës të statusit të kërkesave që do të pasuronte edhe më tej statistikatat dhe do të prodhonte mësimet për të ardhmen,

Përmbledhja e thirrjeve të pranuar sipas drejtorive:

Zyra e Kryetarit	37
Drejtoria për Administratë	63
Drejtoria për Urbanizëm	12
Drejtoria për Shërbime Publike	124
Drejtoria për Inspeksion	19
Drejtoria për Kadastër	5
Drejtoria për Arsimit	29
Drejtoria për shëndetësi	15
Drejtoria për kulturë, rini dhe sport	14
Drejtoria për bujqësi	19
Drejtoria për prokurim	8
Drejtoria për buxhet dhe financa	6
Zyra për kthim dhe komunitet	3
Komuna nuk është kompetente	29
Zyra Ligjore	2
Zyra për informim	10
Zjarrefiksati	3
Sekretaria e Kuvendit Komunal	3
Personeli	1
Emergjencat	12
Totali	414

Sektorit për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Aktiviteti i Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ishte i përkushtuar në këto qëllimet kryesore:

1. Funkcionalitetit i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës
2. Monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale;
3. Integriteti dhe ruajtja e të dhënave;
4. Mbështetja lidhur me përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të TI;
5. Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta

Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative sipas planit vjetor ka pasur 5 objektiva të përcaktuar të përshkruara më lart, ku për arritjen e këtyre objektivave ka zhvilluar 15 aktivitete të tjera të paparapara sipas planit vjetor të veprimit. Të gjitha këto kanë dalë si rezultat i nevojave të Administratës në përmbushjen e obligimeve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Përshkrimi i punëve, detyrave dhe intervenime të bëra	
Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e probleme softuerike.	292
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	512
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	260
Postime në ueb faqe dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare	
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës si dhe konsultime për lekturim.	53
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulantë sipas nevojës të organeve komunale	127
Riparime dhe punë të ndryshme për mirëmbajtje të objektit komunal.	457

Njësitit Komunal për të Drejta të Njeriut

Raporti pasqyron përmbledhjen e punës për periudhën janar – dhjetor 2024; të koordinatores së NJKDNJ; Zyrtares për Barazi Gjinore, kundër diskriminim; Zyrtares për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtje të fëmijës, e cila që nga muaji maj i këtij viti, u emërua drejtoreshë e administratës.

Në këtë raport do t'i paraqesim aktivitetet, të dhënat dhe shënimet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin tonë gjatë kësaj periudhe në kontekst të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, të drejtave fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara në komunën e Vushtrrisë.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE DHE ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË NJËSITIT KOMUNAL PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut, zyrtarja për barazi gjinore, dhe kundër diskriminim, zyrtarja për të drejta të njeriut dhe mbrojtje të fëmijëve, gjatë vitit 2024, kanë realizuar plan programin e punës duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin Kundër Diskriminim, Ligjin për Mbrojtje të Fëmijëve, e gjithashtu duke iu përmbajtur listës së ditëve ndërkombëtare që i kemi në kalendarin e Njësitit.

Njësitit komunal për të drejtat e njeriut, zyrtarja për barazi gjinore; zyrtarja për drejta të njeriut dhe mbrojtjen e fëmijës, me aktivitetet dhe angazhimin e tyre gjatë këtij viti kanë pasur qëllim kryesor promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, promovimin e të drejtave të fëmijëve, promovimin e të drejtave dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara, grave vetushqyese. Për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të poshtë shënuara shprehi mirënjohjen time për kryetarin e komunës zotin Ferit Idrizi, dhe drejtoreshën së administratës Hyrie Uka Hoxha, zyrtaren për drejta të njeriut dhe

mbrojtën e fëmijës, për mbështetjen e tyre të pa kursyer në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve tona gjatë vitit 2024.

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2024, NJKDNJ;ZBGJ; ZDNJ dhe ZMF, për realizimin e qëllimeve të lartëshënuara kanë mbajtur, aktivitete të ndryshme si shënimi i datave të rëndësishme për të drejtat e njeriut, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara; kemi organizuar tryeza të diskutimit, kemi qenë pjesëmarrës në disa tryeza të organizuar nga institucionet dhe organizatat tjera qoftë në cilësinë si penalistë qoftë si pjesëmarrëse të tyre, kemi pasur takime të ndryshme me OJQ vendore dhe ndërkombëtare; kemi pasur vizita në shkollat e komunës dhe institucione të ndryshme, kemi qenë pjesëmarrës në trajnime dhe punëtori të ndryshme të organizuara nga institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kemi qenë pjesëmarrëse në konferencën Java e Gruas 2024 dhe në Samitin e organizuar nga USAID, programi Kontrata Sociale. Zyrtarja për barazi gjinore, sipas detyrës zyrtare ka marr pjesë në mbledhjet e kuvendit komunal, të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje, komisionit komunal për riatdhesim, zyrtarja për të drejta të fëmijëve është pjesë e Ekipit Komunal për mbrojtjen e Fëmijës, komisionit për parandalimin e braktisjes së shkollës, janë pjesë e disa komisioneve të caktuara nga kryetari i komunës, drejtoresha e administratës, drejtorja e prokurimit etj. Gjithashtu në kuadër të komisionit për shqyrtimin e ankesave nga dëmet prej vërshimeve ose zjarrit kemi shqyrtuar 25 ankesa. Zyrtarja për Barazi gjinore edhe këtë vit ka raportuar për performanën e komunës nga fusha e çështjeve gjinore.

Gjatë këtij viti kemi marrë pjesë në këto trajnime:

Trajnim organizuar nga Germin buxheti gjinor;

Trajnim organizuar nga Agjencia për Bara Gjinore, tema Trajnimin “Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të ngacimit seksual në vendin e punës”;

Trajnim Hyrje në antigjipsizëm, organizuar nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë;

Trajnimin e organizuar nga MAPL tema Rregullorja për punësimin e komuniteteve të marginalizuara;

Trajnimin organizuar nga USAID lidhur me Kodin e etike;

Trajnim me temën Metodologjia Pride organizuar nga SOS fshatrat e Kosovës;

Trajnim organizuar nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, tema Hartimi i raportit për zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit;

Trajnim organizuar nga Këshilli i Evropës, lidhur me mbrojtjen nga diskriminimin dhe standardet e barazisë;

Trajnim organizuar nga OJQ Mitrovica Women Association for Human Rights, tema, pjesëmarrja dhe roli i grave në dialog;

Trajnim organizuar nga ZKQM tema, komuniteti jo shumicë vlerë e demokracisë;

Trajnimin tre ditore 18-20/09/2024 Promovimi i Barazisë Gjinore përmes teknologjisë informative organizuar nga UN Women;

Gjatë këtij viti kemi marrë pjesë në këto punëtori:

Punëtori organizuar nga Anotacioni i Komunave, tema Formimi i Kolegjiumit Zyrtarëve për Barazi Gjinore;

Punëtorinë organizuar nga tema: “ Parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivel lokal dhe rëndësia e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve.”

Dy punëtori organizuar nga USAID tema lidhur Kontrata Sociale, ku komuna është zotuar në realizimin e dy çështjeve që kanë dalë nga takimet me qytetarët e komunës sonë;

Punëtorin organizuar nga Ministria e Kthimit dhe Riatdhesimit, tema e drejta në të dhënat personale dhe përpunim i tyre;

Punëtori organizuar nga Caritasi zviceran tema Hartimi i Planit veprues për Personat e Riatdhesuar dhe të huaj;

Punëtori nga USAID e drejta pronësore ku ZBGJ është anëtare e komisionit për hartimin e planit rreth lehtësimit të realizimit të drejtës pronësore te gratë;

Punëtori dy ditore nga Kolegjiumi i Zyrtarëve për Barazi Gjinore, tema Roli i rrjeteve sociale në pasqyrimin e punës së zyrtarëve për barazi gjinore;

Punëtori me temë “Sinjalizimi, hetimi administrativ, roli i zyrtarëve përgjegjës dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit”; organizuar nga AKK

Punëtorja ditore në e organizuar nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë me temë Korniza e Indikatorëve treguesve për të drejtat e njeriut;

Punëtori nga Asociacioni i Komunave Të Kosovës, tema hartimi i Planit të kolegjiut të Zyrtarëve për Barazi Gjinore

Punëtori organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës, tema fuqizimi i të mbijetuarave nga dhuna seksuale gjatë luftës ;

Punëtorinë katër ditore në cilësinë e anëtares së komisionit për hartimin e Rregullores për tarifa ngarkesa dhe borxhe nga data 14.05-17.05. 2024

Gjithashtu kemi plotësuar raporte lidhur me performancën komunale, kemi plotësuar të dhënat nga Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020-2024 si dhe pyetësorin për integritet evropian për vitin 2024;

Në vazhdim do ti paraqesim aktivitetet e mbajtura brenda këtij viti kalendarik.

Më 16/01/2024 Dërgimi i Planeve të punës në Agjencisë për Barazi Gjinore, Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal, Zyrës e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë

14/02/2024 Takim me Institutin Hasan Tahsim, lidhur me bashkëpunimin e përbashkët mes komunës;

16/02/2024 Shënimi i 17 shkurtit Pavarësia e Kosovës në SHMU “ Naim Frashëri”

25/02/2024 Takim me përfaqësuesin e OJQ Terra homes u bisedua për tryezën Multidisciplinare që kontribuon në parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna

24/01/2024 Plotësimi i pyetësorit për të drejta të njeriut kërkuar nga Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal, lidhur me funksionalizimin e Njësitit Komunal për të Drejta të Njeriut;

03/02/2024 Takim me grupin joformal të grave të IADK, u bisedua për bashkëpunim mes Zyrtares për Barazi Gjinore dhe këtij grupi;

23/02/2024 Pjesëmarrja në takim të organizuar nga Oda ekonomike e Grave, u bisedua për sfidat e grave fermerë;

03/03/2024 Pjesëmarrja në takim të komisionin komunal për procedurën dhe vizionin e objektivit në Gjykatën e Vushtrrisë;

6.03.2024 Mbajtja e tryezës së diskutimit tema” Sfidat e arsimit ndër vite” u diskutua me panelistët e fushës rreht këtyre sfidave që përjetoi arsimit shqip ndër vite;

07/03/2024 Mbajtja e tryezës së diskutimit tema ” E drejta pronësore”, u diskutua me panelistët për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të grave ;

08/03/2024

Zyrtarja për barazi gjinore ka organizuar tryezë e rumbullakët dhe drekë pune për nder të 8 marsit ditës ndërkombëtare të gruas është diskutuar për fuqizimin e grave të viseve rurale, pjesëmarrës 35 gra;

15.03.2024 Marrja e të dhënave për raportimin për Programin Kombëtar për barazi gjinore për vitin 2023;

21/03/2024 Shënimi i 21 marsit Dita e autizmit, ku në bashkëpunim me Organizatën Jonuz Emre kemi organizuar aktivitetet me fëmijë me aftësi të kufizuara pikturimi me artin emru;

05/04/2024 Njësitit Komunal për të Drejtat e Njeriut vizitoi SHMU “Mustaf Venhari”u bisedua për sigurinë e nxënësve në shkolla;

7/04/2024 Njësitit Komunal për të Drejtat e Njeriut mori pjesë në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të romëve; **16/04/2023**

Takim me shoqatën “ Martirët e Lirisë” lidhur me organizimin e takimit regjional për të pa gjeturit;

17/04/2023 Takim me përfaqësuesin e Rrjetit të Grave të Kosovës u bisedua lidhur me pozitën e gruas në viset rurale në komunën tonë;

04/05/2024 Pjesëmarrja në takim të rregullt me Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë; me temë Hartimi i raportit vjetor për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

10/05/2024 Njësitit Komunal për të Drejtat e Njeriut ka pasur takim me Shoqatën Martirët e Lirisë biseduam për pjesëmarrjen e grave në dëgjimet buxhetore;

16/05/2024 Sigurimi i të dhënave nga drejtoritë lidhur me Raportimin për Planin e Veprimit për Barazi Gjinore për vitin 2023;

21.05.2024 Takim me KFORIN Slloven, u bisedua për sigurinë në komunitet;

01/06/2024 Njësitit Komunal për të Drejtat e Njeriut me rastin 1 Qershori, Dita ndërkombëtare e fëmijëve organizoi vizitë në Handikos me fëmijët me aftësi të kufizuara;

04/06/2024 Takim pune në DKRS me komisionin për plotësim ndryshim i Rregullores për gjoba, ngarkesa e tarifa;

06/06/2024 Dërgimi i kërkesave të disa drejtorive për material për zyre, në cilësinë e menaxheres së kontratës për furnizim me material për zyre;

10/06/2024 Mbajtja e mbledhjes së Mekanizmit Komunal Koordinues kundër Dhunës në Familje;

12/06/2024 Së bashku me drejtoreshën e Administratës Hyra Uka Hoxha siguroam dhurata për Bajram, në repartin e pediatrikë, Handakos, shoqatës Si drom Daun në shpërndarjen e tyre ishte prezent edhe nënkryetarja e komunës Hava Mlinaku

13/06/2024 Pjesëmarrja në mbledhjen e Kolegjiut të Zyrtareve për Barazi Gjinore ;

19/06/2024 Njësi Komunal për të Drejtat e Njeriut, plotësoi pyetësorin dërguar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore lidhur me trajtimin e dhunës me bazë gjinore në institucionet publike;

22/06/2024 Njësi Komunal për të Drejtat e Njeriut vizitoi DKA, u bisedua rreth situatës së shkollave pas vërshimeve;

26/06/2024 Takim me Grupin e grave GIVA ku u bisedua për pjesëmarrjen e grave në takimin e kryeartit të komunës me qytetarë;

03/07/2024 Pjesëmarrja në Takim me IADK në cilësinë e panelistes, u bisedua për fuqizimin ekonomik të gruas;

16/07/2024 Takim me OJQ Hareja, lidhur me projektin për barazinë gjinore në nivelin lokal;

22/07/2024 Zyrtarja për Barazi Gjinore ishte pjesë e panelit gjatë dëgjimeve buxhetore ku patëm takim me grupet e grave, pjesëmarrëse 35 gra !

08/08/2023 Pjesëmarrja në takim me USAIDIN, ku u bisedua për Zyrtarin Sinjalizues

29/08/2024 Komuna e Vushtrrisë, përkatësisht Njësi për të Drejta të Njeriut në kuadër të Drejtorisë së Administratës, në bashkëpunim me shoqatën Martirët e Lirisë, shënoi sot disa aktivitete në kuadër 30 Gushtit, Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur:

Homazhe të varrezat e martirëve të lirisë në qytetin e Vushtrrisë;

8/09/2023 Takimi me grat e grupit IADK. Tema e këtij takimi ishte fuqizimi i grave në viset rurale;

15/09/2024 Njësi Komunal për të Drejta të Njeriut, sot për nder të 15 shtatorit, Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë, vizituam gjimnazin “Eqrem Çabej”, u diskutua për Rolin e këshillit të nxënësve në zhvillimin e demokracisë;

21/09/2024 Pjesëmarrja në takimin me ZBGJ lidhur raportimin nga PKBGJ, mbajtur në Prishtinë.

24/09/2024 Pjesëmarrja në takimin për Tryezën Multi disipline;

01/10/2024 Hapja e fushatës Tetori rozë me dy aktivitete; Vizitë Selvete Shollës e mbijetuar nga kanceri i gjirit dhe vendosja e fjongove rozë në komunë;

02/10/2024 Organizimi i marshit “ Ta mundim kancerin së bashku” në organizim kanë marrë pjesë edhe DSHMS, QKMF,DKA;

03/10/2024 Pjesëmarrja në Nënshkrimin me marrëveshjen me Germinin të cilin e ka nënshkruar drejtoresha Hyrie Uka Hoxha;

04/10/2024 Pjesëmarrja në takimin me grupin në projektin e Germinit, u bisedua për organizimin e tryezës së diskutimit për shëndetin mendor;

11/10/2024 Shënimi i 11 tetorit Dita Ndërkombëtare e Çikave, së bashku me drejtoreshën Hyrie Uka Hoxha vizituam Akademin Inovashion;

14/10/2024 Mikpritja dhe aktivitetet gjatë javës së punës me konsulentin për barazi gjinore nga programi i Germinit;

15/10/2024 Pjesëmarrja marshimin për shënimin e 15 tetorit Dita e shkopit të bardhë organizuar nga shoqata me shikim të dobësuar “Drita jonë “;

Vizitë institutin Jonuz Emre, ku edhe pikturoam me artin embru, këtë vizitë e ka organizuar drejtoresha e Administratës Hyrie Uka Hoxha ;

16/10/2024 Pjesëmarrja në cilësinë e panelistet në tryezën e diskutimit “Sfidat dhe mbështetja për shëndetin mendor”;

Organizmi i 16 tetorit Dita e Mundësive të barabarta, në bashkëpunim me shoqatat e PAK kemi përzgjedhur 10perona ta shënojnë këtë ditë;

18/10/2024 Hapja e fushatës Kundër Trafikimit me Qenja njerëzore, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës mbajtëm ligjëratë si ta mbrojmë veten dhe të tjerët;

Takim me përfaqësueset e grave të fshatit Ashlan, u bisedua për thellimin e bashkëpunimit mes ZBGJ dhe grupit të grave të Ashlanit;

18/11/2024 Pjesëmarrja në samitin Kontrata Sociale organizuar nga USAID;

24/11/2024 Njësiti për të Drejta të Njeriut në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare kundër Abuzimit, mori pjesë në dy aktivitete të organizuara nga DKA dhe KEC. Prezantimi i temës përgatitur nga nxënësit të gjithë kundër abuzimit të fëmijës dhe në hapjen e ekspozitës me punime të artit figurativ të nxënësve me temë kundër abuzimit. Urojmë që të kemi sa më pak raste të abuzimit të fëmijëve, ky aktivitet u mbajt në vazhden e 16t e ditëve te aktivizmit.

25/11/2024 Hapja e fushatës 16 Ditët e Aktivizmit mbajtëm mbledhjen e mekanizmit kundër dhunës në familje;

26/11/2024 Pjesëmarrja në takimin e Kolegjiumit të Zyrtareve për Barazi Gjinore;

29/11/2024 Pjesëmarrja në diskutimin publikë lidhur me Planin Zhvillimor të Komunës të cilin e ka hartuar grupi punues;

02/12/2024 Njësiti Komunal për të Drejta të Njeriut në bashkëpunim me QKMF, shënoi 1dhjetorin Ditën Ndërkombëtare kundër Sidës në gjimnazin Eqrem Çabej diskutuan përfaqësuesit nga QKMF dhe të KKK dega në Vushtrri;

03/12/2024 Njësiti Komunal për të Drejta të Njeriut në bashkëpunim me DKA dhe shoqatat e PAK ka shënuar 3 dhjetorin Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara ku u siguruan dhurata dhe u shfaq një program argëtues me maskota;

05/12/2024 Njësiti Komunal për të Drejta të Njeriut shënoi 5 dhjetorin Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarëve. Për ta shënuar këtë ditë, vizituam Kryqin e Kuq të Kosovës, dega në Vushtrri, u pritëm nga kryesia e Kryqit të Kuq. Biseduam për vazhdimin e bashkëpunimit në aktivitetet tona të përbashkëta;

06/12/2024 Zyrtarja për barazi gjinore së bashku me drejtoreshën e administratës në vazhden e aktiviteteve 16 ditët e aktivimit, ndal dhunën në baza gjinore mbajtën tryezë diskutim i me gratë e viseve rurale;

09/12/2024 Pjesëmarrja në trajnim rritja e kapaciteteve prodhuese të produkteve vendore për gratë fermerë në Vushtrri

10/12/2024 Njësiti Komunal për të Drejta të Njeriut, shënoi 10 Dhjetorin - Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut vizitoi SHFMU “ Rilindja” në Maxhunaj, u bisedua për historikun e shpallës së Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut;

11/12/2023 Pjesëmarrja në vizitën Studimore në Shqipëri, shkëmbimi i përvojave për ushqimet tradicionale;

13/12/2024 Pjesëmarrja në tryezën e organizuar nga OJQ Hareja, të drejtat e komuniteteve jo shumicë në komunën tonë;

Arsimi

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor 2023/24. Viti shkollor 2023/24 ka filluar më 1 shtator 2023, ndërsa gjysmë vjetori i parë ka përfunduar më 12 janar 2024. Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 24 janar 2024 ndërsa ka përfunduar për klasën 12 –të (maturantë) me datë: 16.05.2024, për klasat 9, 10, 11, më datë: 6.06.2024, për klasat parafillore dhe 1-8 –të më: 24.06.2024, viti shkollor ka përfunduar me 31 gusht 2024.

Informata të përgjithshme:

- Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore;;
- 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizikë e cila është në procedurë të pavarësimi;
- 3 shkolla fillore;
- 2 Shkolla të mesme të ulëta;
- 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta;
- 3 shkolla të mesme të larta;
- Numri i punonjësve: 1141;
- Numri i paraleleve: 651;

Numri i nxënësve:

- Niveli 0: (grup moshat 1-6 dhe çerdhet) 1148 fëmijë/nxënës;
- Niveli 1(klasa 1-5): 4882 nxënës;
- Niveli 2 (klasa 6-9): 4002 nxënës;
- Niveli 3 (klasa 10-12): 2265 nxënës;
- Gjithsej nxënës 12297 nxënës;

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/24, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë më qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

I. Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit;
- Takime të rregullta me MASHTI;
- Takime të rregullta me KFORIN slloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsim;
- Në protokollin daljes janë regjistruar 626 shkresa;
- Në intranet janë regjistruara 337 dhe janë shqyrtuar 307;
- Në e-depo u regjistruan 56 hyrje dhe 56 dalje;
- Në të gjitha shkollat u shënuar dita e internetit të sigurt;
- Pjesëmarrje në konferencën përmbyllëse të projektit ARISE, zyrtarët e DKA-së kanë qenë pjesë e panelit për të folur në për nivelin komunal për pabarazitë në arsim;
- U mbajtë aktiviteti "Drejt Malit - HIKING" me nxënësit kampion të garave komunale;
- Projekti KosEd 'Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë (2021-2025)', i financuar nga BE, në partneritet me MASHTI-n dhe Inspektoratin e Arsimit e ka mbështetur vlerësimin e brendshëm të 5 shkollave në dy vitet e fundit bazuar në Modelin kolegjial kosovar për sigurim të cilësisë. **Komuna e Vushtrrisë ishte komuna e parë** që filloi analizimin e të dhënave të prodhuara nga modeli kolegjial për ndërtim të kapaciteteve dhe që t'i përdor ato për të organizuar trajnime në të ardhmen. Raporti nga eksperti anglez Robert Blease;
5 Te tjere					0	0	0	0	0	0	0	0	0
Numri total i perfituesve	0	0	0	0	15	16	21	18	13	10	16	8	117
7 Numri i vajzave/grave					1	2	4	2	3	2	3	1	18
8 Numri i çifteve					0	3	2	2	4	2	2	2	17
9 Numri i grave shtatzena					10	6	4	10	10	2	6	2	50
10 Numri i lehonave					4	2	10	4	5	2	4	2	33
11 Dy vitetë gjatë shtatzënisë në klasë					0	1	2	3	2	1	3	1	13
12 Moshë (<18)					0	0	0	1	0	0	0	0	1
13 Moshë prej 18 deri 30					13	10	15	12	13	6	6	8	83
14 Moshë prej 31 deri 40					2	4	3	5	3	2	6	0	25
15 Moshë mbi 41					0	2	3	0	2	0	4	0	11
16 Fshat					9	10	13	8	11	6	10	7	74
17 Qytet					6	6	8	10	7	4	6	1	48
18 Lindje natyrore					6	4	6	2	5	1	3	0	27
19 Lindje me operacion (S.C.)					5	3	4	2	4	1	2	2	23
20 Numri i prenatalave të shperndare					0	10	15	6	7	8	10	8	64
21 Numri i broshurave të shperndara					0	2	5	7	3	1	3	2	23
22 Referime					0	0	0	0	0	0	0	0	0
23 Parfshirja e baballarëve					0	3	2	1	2	1	3	1	13
24 Grupi i gjakur D negativ					1	3	1	2	1	1	2	0	11
25 Periudha e Raportimit					Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Novor	Dhjetor	0
26 Reportuesit					Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	Anjeza	0

Pra në kuadër të shërbimit klasa për nëna numri i përfituesve është gjithsej 117, dhe janë dhuruar 64 pako me prenatala (me vitamina për shtatzënë) të cilat pako janë siguruar në bashkëpunim me AMC-në.

SHËRBIMI “KUJDESI NË GRUP PËR PRINDËRIM”

Në vitin 2024 janë trajnuar gjithsej 16 infermiere prej QKMF-Vushtrri nga AMC, UNICEF në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Deri më tani janë krijuar 2 grupe dhe fasilituese të këtyre grupeve janë 3 infermiere, pra janë krijuar 2 grupe në kombinim me 3 infermiere.

Në këtë shërbim organizohen sesione për prindërit bashkë me fëmijët e tyre prej muajit të parë të lindjes deri në muajin e 17, pra gjithsej organizohen 7 sesione.

Sesioni i parë përfshinë periudhën prej 1-2 muaj, sesioni i dytë 3-4 muaj, sesioni i tretë 5-6 muaj, sesioni i katërt 7-8 muaj, sesioni i pestë 9-11 muaj, sesioni i gjashtë 12-14 muaj dhe sesioni i shtatë përfshinë periudhën 15-17 muaj të fëmijës.

Në kuadër të këtyre shërbimeve që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës, në komunën e Vushtrrisë është organizuar java e gjdhënies, nëpërmjet vizitave në shtëpi, sesioneve me gratë shtatzëna dhe takimet e organizuara në klasën për nëna me nëna dhe baballarë.

Java e gjdhënies në Vushtrri

01-08-2024-07.08.2024

Hyrje & Objektivat

Java Botërore e ushqyerjes me gji mbahet çdo vit në javën e parë të gushtit në mbarë botën, në Kosovë kjo fushatë është mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë, Unicef dhe Action for Mother and Health dhe partnerë të shoqërisë civile. Moto për këtë vit është: Të mbështesim gjdhënien Përmes programit “vizitat në shtëpi për nënat dhe fëmijët 0-3 vjeç” “Kujdesi në Grup” dhe “Klasa për Nëna” qendra kryesore e mjekësisë familjare në Vushtrri “Dr. Safet Idrizi” ka organizuar disa aktivitete për këshillim dhe edukim të veçantë për nënat lidhur me gjdhënien.

Objektivat e aktiviteteve të organizuara:

- Këshillimi i nënave/shtatzënave për gjdhënien
- Edukimi i nënave/shtatzënave për gjdhënien
- Mbështetja e nënave për gjdhënenin

Tabela nr.31 aktivitetet e organizuara

Nr.	Programet	Aktivitetet	Vendodhja	Rezultatet
1	Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	Vizitë në shtëpi	Në shtëpi tek familjet	Këshillimi i nënës për gjdhënenin Praktimi i gjdhënies nga lehona Këshillimi i nënës për kujdesin ndaj foshnjës Këshillimi i nënës për vaksinimin e fëmijës Këshillimi i nënës për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës.
2	Kujdesi në grup	Organizimi i sesionit shtesë informues për gjdhënenin për grupin e 4	Në objektin e QKMF, kati 3, nr. 16	Praktimi i gjdhënies nga secila shtatzënë Diskutimi për mënyrat e gjdhënies Ndërgjegjësimi i grave për të mirat e gjdhënies për nënën dhe fëmijën Ndërgjegjësimi i grave për rëndësin e ushqerjes ekskluzive me gji në 6 muajt e parë dhe ushqyerja deri në 2 vite e gjysmë me gji dhe ushqime shtesë.
3	Klasa për nëna	Takimi me lehonat pas vaksinimit të fëmijëve me BCG	Në objektin e QKMF, kati 3, nr. 16	Praktimi i gjdhënies nga nënat Mbështetja e baballarëve për gjdhënenin Diskutimi për mënyrat e gjdhënies Diskutimi për rëndësin e gjdhëniës si për nënë ashtu edhe për fëmijën.
Promovimi i gjdhënies në qytet		Shpërndarja e fletushkave	Sheshi "Adem Jashari"	Shpërndarja e fletushkave për vetëdijësimin e shtatzënave/lehonave dhe nënave për rëndësin e gjdhënies Diskutimi për benefitet e gjdhënies si për nënë ashtu edhe për fëmijën

• **VIZITAT SHTËPIAKE PALIATIVE**

Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.

- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRË Kosova, unë jam angazhuar si organ mbikëqyrës, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Eorldëide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit paraqes raportin janar dhjetor 2024:

Raport janar – dhjetor 2024 mujor i punës për projektin ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesi shtëpiak IRW-Komuna Vushtrri

- Projekti është realizuar sipas Objektivave të shtojcës B të marrëveshjes për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve mjekësore si :
 - Gratë shtatzëna dhe lehonat;
 - Moshë e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
 - Personat me aftësi të ndryshme;

- Personat me sëmundje kronike;
- Personat me sëmundje malinje;

- **Për ofrimin e shërbimeve mjekësore janë furnizuar sipas kërkesës:**

1. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues mjekësore;
2. Furnizimi me karburant për vetura, servisimi dhe mirëmbajtja e veturave;
3. Furnizimi me mbushje të telefonisë mobile;

- **Organizimi i punës:**

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë në nevojë për dhënie dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore përveç vizitave mjekësore, janë dhënë shërbime të ndryshme si dhe janë aplikuar terapitë e nevojshme nga projekti sipas listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga muaji janar 2023 projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes ku kemi 6 ekipe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermier. Puna për ofrimin e shërbimeve mjekësore ditore është kryer sipas këtij plani dy ekipe mjekësore (2 mjek dhe 4 infermier), njëri ekip i cili e organizon punën për dhënie e shërbimeve mjekësore në vise urbane, kurse tjetri në vise rurale, me dy automjete, terapinë dhe materialin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si këshillimin (pacientët me sëmundje kronike, pacientët me sëmundje malinje, shtatzënat dhe lehonat etj.), vizitat mjekësore, marrjen e anamnezës, matjen e tensionit, matjen e glukozës, matjen e saturimit, matjen e pulsit, matjen e temperaturës, përshkrimin e terapisë sipas nevojës, EKG, dhënie e terapisë paranterale (intravenoze dhe intramuskulare), kateterizimin, pastrim dhe fashim të plagës deri në shërim, referime tek nivelet tjera të kujdesit shëndetësor sipas nevojës.

Orari i punës është 7/13 orë, që do të thotë se punohet 7 ditë të javës me orar 13 orë duke përfshirë edhe vikendet, festat etj.

- Për realizimin e projektit momentalisht janë të angazhuar këto resurse humane:

Pozita profesionale	Numri i nëpunësve
Doktor të Mjekësisë	7
Infermier të Përgjithshëm	14
Teknik laborant	2
Asistent stomatologu	1

Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiak sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.

- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRË Kosova, unë jam angazhuar si organ mbikëqyrës, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Eorldëide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit paraqes raportin janar dhjetor 2024:

Tabela nr.32 paraqet Raportin janar – dhjetor 2024, i punës për projektin ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesi shtëpiak IRW-Komuna Vushtrri

N r.	Rapo rti 12 mujo r 2024	Num ri total i vizitave	Vizita shtëpi ake	Mesh kuj	Fem ra	Numri i vizitave të pacient ëve mbi 65 vjeç	Numri i vizitave lehonave	Numri i vizitave të femij ëve deri 3 vjeç	Shërbime në vizita shtëpi ake	Totali i Shërbimeve

1	Janar	2628	1304	565	739	1365	30	44	2110	11145
2	Shkur t	1495	1098	651	844	751	66	155	2637	3840
3	Mars	1562	1433	553	880	776	75	130	2249	3019
	Total i, TM1	5685	3835	1769	2463	2892	171	329	6996	18004
4	Prill	1376	1270	559	817	747	50	100	2082	2771
5	Maj	1691	1413	708	983	850	19	109	2168	3745
6	Qers hor	1533	1309	644	889	814	32	92	2014	3195
	Total i, TM2	4600	3992	1911	2689	2411	101	301	6264	9711
7	Korri k	1662	1503	691	812	869	140	30	2184	3197
8	Gush t	1584	1382	595	787	846	31	121	2320	3664
9	Shtat or	1600	1398	582	816	748	41	94	2225	3619
	Total i, TM3	4846	4283	1868	2415	2463	212	245	6729	10480
10	Tetor	1532	1422	675	747	790	45	125	2443	3344
11	Nent or	1452	1318	640	678	746	47	119	2223	3095
12	Dhjet or	1886	1278	644	634	938	20	52	2367	4173
	Total i, TM4	4870	4018	1959	2059	2474	112	296	7033	10612
	Total i vjetor	20001	16128	7507	9626	10240	596	1171	27022	48807

SATISFAKSIONI I PACIENTËVE

Statifaksioni i pacientëve është një formë e rëndësishme e vlerësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Anketat e satisfaksionit të pacientëve mund të ndihmojnë të identifikojmë mënyrat për të përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetësor. Është mjaft e rëndësishme për të parë saktësisht se çfarë opinioni kanë lidhur me shërbimet shëndetësore. Në fund të fundit kjo nënkupton se kujdesi është më i mirë dhe pacientët janë më të kënaqur. Pacientët e kënaqur me shërbime kanë më tepër gjasa t'u përmbahen trajtimit të rekomanduar, të vijnë-kërkojnë vizita përcjellëse dhe të mbesin vetëm me një mjek dhe jo ti ndërrojnë mjekët. Për më tepër, matja e kënaqëshmërisë së pacientit, i tregon stafit tonë dhe komunitetit që ne jemi të interesuar për cilësi. Kjo tregon se ne jemi në kërkim

të mënyrave për të përmirësuar dhe duke bërë gjërat më mirë. Nga këto anketa mund ti shohim saktësisht se çfarë thonë pacientët për kujdesin shëndetësor që ofrohen nga ekipet tona. Kjo na bënë me dije se nëse kujdesi është më i mirë pacientët janë më të lumtur.

QËLLIMI

Qëllimi i hulumtimit është identifikimi i nevojave për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor për vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes duke matur opinionet e pacientëve në aspekte të ndryshme lidhur me cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga ekipet e terrenit për pacientët e komunës së Vushtrisë.

OBJEKTIVA

Objektivë e hulumtimit është marrja e opinionëve të pacientëve lidhur me aspektet e ndryshme të cilësisë së shërbimeve shëndetësore që ofrohen në vizitat shtëpiake për:

- Moshë e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
- Personat me aftësi të ndryshme;
- Personat me sëmundje kronike;
- Personat me sëmundje malinje;

METODOTOLOGJIA E HULMTIMIT

Pas marrjes së pëlqimit dhe përkrahjes, si dhe subjekteve pjesëmarrëse në këtë hulumtim, janë shpërndarë pyetësorët e strukturuar si dhe janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme për mënyrën e plotësimit të tyre.

Pyetësori përmban 21 pyetje. Në anketim janë përfshirë 36 pacient, 18 nga qyteti dhe 18 nga fshatrat. Pyetësori ka qenë anonim dhe me të shkruar për arsye që të ketë kosto efektivitet dhe besueshmëri.

KONKLuzionET

Gjatë realizimit të këtij punimi kemi konstatuar se për shërbime të ndryshme që ofrohen në vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes në komunën e Vushtrisë, pacientët e anketuar kanë dhënë vlerësime të ndryshme. Nga analizimi i të dhënave të grumbulluara konstatohet se përqindja më e madhe e pacientëve/klientëve janë shumë të kënaqur me shërbimet që ofrohen.

Pas analizimit të pyetësorëve si përmbledhje do të themi se pjesa më e madhe e pacientëve/klientëve janë të kënaqur me shërbimet që i'u ofrohen.

Janë anketuar mbi opinionet 36 anketues, ku vlen të theksohet se kënaqshmëria për shërbimet është e nivelit shumë të kënaqur 99%, kurse të kënaqur 1%. Sa i përket opinionëve shumë të pa kënaqur, i pa kënaqur dhe nuk dua të përgjigjem kemi pasur 0 % nga anketuesit.

Vlerësimi i përgjithshëm, mjekësor, furnizues në qytet dhe fshat vlej në të theksohet se kënaqshmëria arrin maksimumin përveç tek pyetja se sa jeni të kënaqur me furnizimit me terapi e cila ka një përqindje më të ulët andaj nga 36 të anketuar 3 prej tyre janë të pa kënaqur.

Tabela nr.33 paraqet në formë tabelare të hyrat vetanake 2024:

Nr.	Viti fiskal I të hyrave vetanake janar dhjetor 2024	Vlera totale e të hyrave
1	Të hyrat vetanake	61,263.00 Euro
Vlera		61,263.00 Euro

Tabela nr.34 paraqet në formë tabelare të hyrat vetanake 2023/2024, diferencën në rritje:

Nr.	Vlera totale e të hyrave 2023	Vlera totale e të hyrave 2024	Krahasimi
1	56,065.00 Euro	61,263.00 Euro	5198.00 Euro

Tabela nr.35 paraqet rekapitulim i Projekteve të realizuara për vitin 2024 Shendetesia

PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE	
1	Furnizimi me automjet terrenit
2	Blerja dhe furnizimi me automjet per bartjen e pacienteve në hemodialize
3	Furnizimi me kamera për objekte shendetesore
4	Furnizimi me inventar
5	Furnizimi i Inventor (Bateria)
6	Furnizimi me teknologji
7	Ndertimi i receptionit ne QMF Pantinë dhe QKMF

Tabela nr.36. paraqet raportin vjetor i kontratave gjatë vitit 2024 nga mallrat dhe shërbimet:

Titulli i aktivitetit të prokurimi
Shërbimet e Deratizimi, Dezinfektimit dhe Dezinsektimi
Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve
Furnizim me aparate kundër zjarrit
Shërbimet të GPS të automjeteve të QKMF Vushtrri
Furnizim me lëndë djegëse - Pelet.
Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në laborator, mjekësi familjare, urgjencë dhe sektori i shëndetit oral për nevojat e QKMF-së Dr. Safet Idrizi.
Shtypja e materialeve për nevojat e Komunës së Vushtrrisë Lot I
Loti I Furnizim me reagensa dhe materjal shpenzues
Loti II Furnizimi me reagensa SFRI
Asgjësimi i mbeturinave mjekësore të krijuara në QKMF Dr. Safet Idrizi Vushtrri.
Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për nevojat e QKMF-së
Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemit të oksigjenit
Rregullimi i hapësirave të QMF Vushtrri
Furnizime me materjale për rregullimin e hapësirave të QMF -së Vushtrri
Servisimi dhe Mirëmbajtja e Ngrohjeve Qendrore sipas lot 1
Servisimi ,mirëmbajtja dhe mbushja e klimave

Bazuar në kontratat kornizë të Komunës së Vushtrrisë dhe Agjencionit Qëndrorë të Prokurimit kemi bërë furnizimin e nevojshme nga kodi mallra dhe shërbime si dhe ekzekutimin e të gjitha pagesave konform dispozitave të kontratave duke ekzekutuar dhe penalltit sipas afateve kohore për vonesat.

Shërbimi teknik dhe mbështetës
Autoparku

Autoparku ka gjithësejt 9 vozitësa. Vozitësat e autoparkut janë të angazhuar në sektorin e urgjencës, të cilët mbajnë kujdestari 12 orëshe dhe janë të koordinuar me stafin profesional të urgjencës.

QKMF në Vushtrri po ashtu kryen edhe shërbimin e transportit të pacientëve me sëmundje të veshkëve të cilët i transporton në Spitalin e Dializës në Mitrovicë për marrjen e shërbimeve të dializës, po ashtu i transporton prapë në shtëpi, punon në dy ndërrime dhe bënë transportin e 24 pacientëve të komunës së Vushtrrisë, në vise rurale dhe urbane për Dializë në Mitrovicë. Po ashtu kemi 3 pacient me gjendje të rëndë të cilët transportohen me autoambulancë.

Me autorizim të kryetarit të komunës, gjithnjë bazuar në nevojat e qytetarëve të komunës së Vushtrrisë, ne kemi transportuar edhe pacientët me sëmundje të rënda jasht shtetit të Kosovës e që gjatë kësaj periudhe kemi transportuar 8 pacient, Shqipëri, Maqedoni dhe anasjelltas.

Autoparku vozitës në bazë të fletëudhëzimit nga Mjeku kujdestar në Sektorin e Kujdesit Urgjent në QKMF Vushtrri gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, ka transferuar pacientët në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri dhe në disa raste ka transferuar pacientët në Emergjencën e SSHKUK-së Prishtinë, dhe në bazë të nevojave bëjmë transportin nga SSIKUK në Vushtrri.

Tabela nr.37 paraqet Shpenzimet e derivative Janar – dhjetor 2024

Shpenzimet e derivateve të naftës dhe benzinës sipas muajve për automjete, periudha Janar/dhjetor 2024															
Nr.ren	Automjeti	Targat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
1	Hyundai IX35	02Z-09-27	10	92	49	113	50	47	98	52	107	0	55	0	764
2	Citroen Autom	02Z-32-27	63	4	6	257	146	70	0	0	0	66	0	0	1072
3	Kombi EV T5	02Z-38-27	22	15	21			19		25		163.0		25	2381.01
4	Citroen Kombi Ford	02Z-40-27	31	23	0	80	83	0	.1	74	75	0	0	0	1091.1
5	Autoambu	02Z-41-27	60	76	93	0	65	0	0	60	0	0	0	0	354
6	Citroen Autom	02Z-42-27	65	62	0	73	68.6	7	.1	3	7	212	.1	0	2031.32
7	VË Caddy Fiat Ducato	02Z-43-27	0	0	0	0	59	0	59	0	59	61	59.	50	347.37
8	Aut	02Z-51-27	26	3	0	66	142	60	196	77	150	216	147	0	1467
9	Kam.Gazelle	02Z-52-27	50	0	50	52	0	52	0	0	45	0	0	0	249
10	VË T5 Autoam	02Z-54-27	0	0	0	62.5	0	0	0	0	0	0	0	0	62.5
11	Citroen Berlingo	02Z-55-27	91	88	22	0	44	8	47	2	46	91	0	0	739
12	Opel	02Z-57-27	11	4	12	63	117	3	131	0	150	63	.1	0	1393.1
13	Ford Fusion	02-254-FJ	11	10	76	41	0	0	0	0	0	0	0	0	337
14	Pezho	02Z-60-27	44	34	46	44	0	44	44	84	45	39	45	45	514
15	Opel Autoambulancë	02Z-61-27	0	0	22	286	266	12	4	31	224	293.1	1	27	2272.11

16	Citroen Berlingo	022-68-27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	45	39.2	40	0
17	Citroen Dializë	022-72-27	0	0	0	0	0	68	0	0	66	0	68	70	272
18	XXX			0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
19	Naft	Gjener ator	0	60	0	0	0	0	60	0	0	0	0	0	34
20	Benzin pajisje	Kositës e	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
			1498	1110	1163	1386.5	1208.6	1171	1528	1361	1257.57	1249.12	1336	1322	15590.7

Tabela nr.38 paraqet Shpenzimet e derivateve të naftës dhe benzinës në Euro sipas muajve për automjete, periudha Janar/dhjetor 2024

Shpenzimet e derivateve të naftës dhe benzinës në Euro sipas muajve për automjete, periudha Janar/dhjetor 2023														
Nr.ren	Automjete	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
1	Automjete	1880.01	1459.4	1461.3	1737.74	1442.06	1414.21	1848.69	155.5	1376.41	1394.4	139.9	140.0	18368.13
	Totali	1880.01	1459.4	1461.3	1737.74	1442.06	1414.21	1848.69	155.5	1376.41	1394.4	139.9	140.0	18368.13

Shërbimi teknik mbështetës:

Duke u bazuar në evidentimet që janë bërë nga shefi i shërbimit teknik është angazhuar në punët e parapara në QKMF, QMF dhe AMF :

Rregullimi, i pajisjeve elektrike;

Mirëmbajtja e dyerve dhe dritareve;

Ndërrimi i pjesëve të nevojshme për mirëmbajtjen e objekteve shëndetësore;

Ndërrimi i pjesëve higjieniko sanitare;

Kositja e barit ;

Mirëmbajtja e kalldave dhe bartja e peletit sipas nevojave;

Mirëmbajtja e higjienës etj.

Shtojcë punët e kryera:

Raporti i punës
Ndërrimi i 3 Ek ventilave dhe gypave fleksibil në QMF-1
Ndërrimi i 2 cilindrave të dyerve në QMF-2
Ndërrimi i cilindrit në derën e hyrjes dhe ndërrimi i fontanes në banjo
Ndërrimi i pompës së ujit, bocës dhe siguresës në QMF-Maxhunaj.
Ndërrimi i cilindrit në QMF-3
Ndërrimi i 4 cilindrave në një qeshme me një ujë dhe një kapak të ëc sholes në AMF-Strofc.
Ndërrimi i dy cilindrave në QMF-1
Ndërrimi i 30 nenonkave dhe 9 poqe elektrike në QMF-1

Ndërrimi I cilindrit të derës së hyrjes në QMF-Maxhunaj
Ndërrimi i qeshmes dhe sifonit në QMF-Lumadh
Ndërrimi i dy qeshmeve në QMF-Smrekonicë dhe nderimi i dy prizave të rrymës.
Ndërrimi I cilindrit zyra e drejtorisë.
Nderimi I një fontane dhe një qeshme të ujit në QMF-Druar.
Bartja e peletit nga depoja në Amf- Strofc, rregullimi i derës në derës në reception në QMF-1.
Ndërrimi i popes së ujit dhe sigureses në AMF-Ceceli.
Ndërrimi i një ek ventili dhe gypi fleksibil dhe fontane të ujit në AMF-Dumnicë
Ndërrimi i cilindrit të derës së hymjes në QMF-2
Ndërrimi i cilindrit të derës në tretman dhe ndërrimi i një qeshme dhe sifoni.
Ndërrimi i tre cilindrave në laborator në QMF-3
Rregullimi i kulmit në AMF-Ceceli
Bartja e inventarit të vjetër nga QKMF në objektin e ri deri me date 27.04.2023
Ndërrimi i 10 poçeve elektrike në QMF-1
Ndërrimi i cilindrit në derën kryesore në QMF-Pantinë
Rregullimi I fontanës së ujit dhe ndërrimi i 3 cilindrave në QMF-2
Ndërrimi I cilindrave në QMF-Samadrexhë në deren Kryesore.
Rregullimi I ujit në stomatologji QKMF, ndërrimi i 2 sifoneve dhe dy qeshmeve.
Bartja e Depos nga depoja e QKMF në QMF-Pantinë.
Pastrimi i kockave nga bari në QMF-1, QMF-2, QMF-3, QMF-Lumadh, Druar, Novolan, Maxhunaj Samadrexhë.
Rregullimi i 12 banjave në QKMF (Objektin e ri)
Ndërrimi i cilindrit në QMF-2
Rregullimi i derës në stomatologji QMF-2
Ndërrimi i 6 cilindrave në objektin e ri QKMF
Ndërrimi i cilindrit në barnatore
Bartja e karriges stomatologjike nga QKMF në QMF-Pantinë.
Bartja e peletit nga QMF-1 në qendrat tjera .

Ndërrimi i dy ek ventilave në AMF-Strofc.
Heqja e 6 pasqyrave nëpër banjo dhe vendosja e tyre në banjo në QKMF e re.
Pastrimi i podrumit nga vërshimet e ujit në QMF-1
Ndërrimi i bravës dhe i cilindrit në ordinancën nr 22 në QMF-1
Ndërrimi i një cilindri në QMF-1
Ndërrimi i 2 bravave në ordinancën 20 dhe 21.
Ndërrimi i 1 qeshme me një ujë në QMF- Druar.
Rregullimi i dyerve të ëc në QKMF dhe 2 cilindrave.
Ndërrimi i 2 cilindrave në RTG në QMF-1.
Rregullimi i dyerve të Oborrit dhe saldimi i tyre në QMF- Smrekonicë
Rregullimi i dyerve të oborrit dhe saldimi i tyre në AMF- Dumnicë.
Rregullimi i dyerve në lidhore dhe tretman në QKMF, ndërrimi i një cilindri tek zyra e drejtoreshës.
Ndërrimi i një cilindri dhe rregullimi i një ormani në stomatologji pranë QMF-1
Rregullimi dhe nderimi i një qeshme dhe një ekventili në QMF-3
Shpërndarja e aparateve të ujit në QMF-1, QMF-2, QMF-3, QMF- Lumadh, QMF-Smrekonicë, QMF- Maxhunaj , AMF- Dumnicë.
Rregullimi i llavorit në Urgjencë.
Ndërrimi i një qeshme dhe 2 gypave fleksibil.
Rregullimit i 2 sifonave dhe ndërrimi i 2 qeshmeve.
Ndërrimi i dy gypave fleksibil në QMF-3
Ndërrimi i 2 qeshmeve me një ujë në AMF- Novolan.
Ndërrimi i një fontane dhe rregullimi i sholës në AMF- Oshlan.
Rregullimi i hidroforit dhe ndërrimi i një skllupke dhe rregullimi i gjeneratorit dhe mbushja me naft në QMF-1
Rregullimi i tavolinës në tretman ndërrimi i bravës në ordinancën nr.16 në QMF-1
Rregullimi i hidroforit dhe rregullimi i 4 karrigeve në AMF-Ceceli dhe QMF-Samadrexh.
Rregullimi i një qeshme të ujit.
Ndërrimi i një qeshme dhe rregullimi në QMF-Druar, pastrimi i klimës dhe ndërrimi i 2 dritave në AMF-Novolan.

Ndërrimi i një qeshme me një ujë dhe në QMF- Maxhunaj dhe ndërrimi i dy cilindrave në QMF-1.
Rregullimi dhe instalimit të ujit në objekt në AMF-Dubofc.
Rregullimi i një fontane të ujit në QMF-Maxhunaj.
Ndërrimi i 1 brave në barnatore dhe rregullimi i derës në QKMF.
Shpërndarja e bidonave me ujë në QMF-2, AMF-Ceceli, QMF-Maxhunaj, QMF-Lumadh, dhe QMF-1.
Ndërrimi i sifoneve në QMF-2 dhe rregullimi i fontanes.
Rregullimi i kabllor së rrymës për friz të vaksinave, dhe rregullimi i nxemjes me pelet në AMF-Beqiq.
Rregullimi i qeshmës në oborr , në QMF-Pantinë vendosja e dy prizave, si dhe ndërrimi i dy sifoneve.
Kontrollimi i nxemjes me pelet, ndërrimi i qeshmes dhe kabllor së klimës.
Ndërrimi i fontanës në QMF-1, ndërrimi i 4 ek ventilave, 4 gypave fleksibil dhe ndërrimi i 9 poçeve elektrike.
Ndërrimi i dritave në QMF-2 rregullimi i fontanës në QMF-1 Urgjencë.
Ndërrimi i cilindrit në Depo tek Vozitësit në QMF-1.
Rregullimi i nxemjes dhe dritave në QMF- Druar.
Rregullimi i fontanës në banjo në QMF-Maxhunaj.
Ndërrimi i dritave të jashtit dhe vendosja e një senzori në QKMF.
Furnizimi me 10 bidonë ujë në QMF-2
Rregullimi i dy dritave në korridor në QMF-1
Ndërrimi i 2 qeshmeve dhe rregullimi i fontanave në AMF-Dubove
Ndërrimi i një qeshme dhe 2 ekvenditalave në AMF-Beqiq si dhe rregullimi i dy fontanave të ujit dhe gypave fleksibil.
Furnizimi me 10 bidonë me ujë në QMF-2
Rregullimi i llovabos dhe montimi i saj në QMF-1
Furnizimi me 10 bidonë me ujë në QMF-3 dhe 10 në QMF-1
Rregullimi i nxemjës dhe ndërrimi i një ekventili, rregullimi i derës së hyrjes në AMF-Dumnicë.
Ndërrimi i dy dritave dhe rregullimi i klimës në AMF-Novolan.
Ndërrimi i një qeshme de ndërrimi i një koke të kabllor në QMF-1

Rregullimi i banjos në QMF-1 dhe ndërrimi i një fontane uji, një qeshme dhe një gypi fleksibil.
Furnizimi me 5 bidonë uji në AMF-Novolan, dhe 5 bidonë uji në AMF-Dumnicë
Rregullimi i një qeshme me një ujë në QMF-Druar.
Furnizimi me 5 bidonë me ujë në QMF-1 dhe rregullimi i nxemjes në AMF-Novolan.
Furnizimi me 11 bidonë të ujit në QMF-1
Ndërrimi i një brave dhe rregullimi i një qeshme në QKMF, rregullimi i një prize në QMF-Lumadh.
Ndërrimi i 8 dritave nëpër banjo në QMF-1
Rregullimi i kalldas dhe ndërrimi i një qeshme me një ujë në QMF- Pantinë.
Ndërrimi i një qeshme dhe një gypi fleksibil në QMF-1 si dhe rregullimi i kalldas në AMF-Druar.
Ndërrimi i një ekventili dhe rregullimi i kalldas (burgia për furnizim me pelet).
Furnizimi me 10 bidonë me ujë në QMF-1, furnizimi me 9 bidonë të ujit në AMF-Strofc, 5 bidonë në QMF-Maxhunaj.
Rregullimi i qeshmes në tretman dhe ndërrimi i një gypi fleksibil në QMF-3.
Rregullimi i derës së ËC dhe ndërrimi i dorëzave të derës së saj.
Furnizimi me ujë në këto qendra: QMF-1 (10 bidonë), QMF-2 (5 bidonë), QMF-3 (5 bidonë).

Shtëpia Rezidenciale Lumadh

Ne kuadër të Shtëpisë Rezidenciale do të pasqyrojmë të gjitha aktivitetet shëndetësore dhe vizitat familjare brenda dhe jashtë shtëpisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024 të pacientëve:

Emri dhe Mbiemri	Vizite ne Familje	Vizite ne SH.R
1. I.G	11	4
2. R.B	20	2
3. D.S	5	0
4. G.O	1	5
5. E.K	0	24
6. A.S	4	10
7. A.M	0	6
8. L.K	0	0
9. A.K	0	0
10. A.M	0	0

11. D.G	0	0
12. M.G	0	0
Gjithsej	41 vizita në Familje	51 vizita ne Shtëpinë e Komunitetit
Vizitat Mjekësore Brenda dhe Jashtë	Vizita ne QKMF janë : 5	Vizita mjekësore ne SH.K janë: 1

Raste të vizitës spitalore me te gjitha kontrollet : A.K është trajtuar për shkak te një ndërhyrjeje kirurgjike ne Klinikën e Stomatologjisë ne QKUK.
Raste te vdekjes : 1 E.K
A.M ka qene ne vizite ne Komisionin konsullor për vlerësimin e diagnozës
Vaksinimi kundër gripit sezonal te gjithë
Konsultime me telefon me doktorin e Shtepise z.Azem Haliti, Psikiater 20 here.
Vizitë për ne Institutin e psikiatrisë për shkak te gjendjes se renduar te një rezidentes e kemi vetëm një rast.
Ne Spitalin e Vushtrrisë për shkak te operimit te rezidentes A.K i janë bere te gjitha analizat ne baze te udhëzimit te doktorit.
Rezidenti A.M me kërkesë te komisionit nga Ministria e Drejtësisë i kemi bere analizat dhe është kontrolluar nga infektologu, ku ka rezultuar pa ndonjë sëmundje ngjitëse

Rasti i rezidenti A.M momentalisht është ne shqyrtim nga komisioni vlerësues ne Ministrinë e Drejtësisë, ku do te shqyrtohet mundësia e transferimit ne Institutin Special ne Shtime. Gjate gjithë vitit stafi vazhdimisht ka raportuar ne lidhje me rastin e rezidentit ne fjale, ku i cili vazhdimisht ka ikur nga objekti, ka dëmtuar inventarin, ka sulmuar fizikisht N.Infermieren K.B. Te gjitha këto janë raportuar ne QPS-ne përkatëse dhe ne bashkëpunim me menaxherin e rastit z.Selim Peci e kemi kompletua lenden për ministri. Institucioni ku ofrohen shërbime rezidenciale nuk ka kushte për ta izoluar A.M dhe po ashtu kam raportuar tek avokati i popullit rreth lendes, e cila ende nuk është trajtuar. Z.Lulkuqe Gashi nga departamenti i avokatit te popullit ka kërkuar detaje rreth rastit te cilat i kam përcjell përmes emalit zyrtar. Zyrtarja nga Ministria e Drejtësisë ka kërkuar analiza shtese dhe certifikatë nga infektologu qe nuk ka ndonjë sëmundje ngjitëse. Ne bashkëpunim me QKMF-ne e kemi dërgu ne Qendrën Klinike Universitare dhe te gjitha analizat i ka përfunduar, dhe certifikata nga infektologu është lëshuar. Gjendja shëndetësore është stabile përjashtimit disa gripa sezonal tek disa prej pacienteve si dhe me disa probleme dentare te cilat janë evidentuar ne QKMF-ne e Fshatit Lumadh.

Rezidentja D.G është operuar ne spitalin e Vushtrisë dhe ne bashkëpunim te vazhdueshëm me drejtoreshën Shefkije Shatri te gjitha procedurat mjekësore kane përfunduar me sukses. Vlen te theksohet se rezidentet duhet te trajtohen pa dallim ne institucione shëndetësore dhe mos te hezitohet ofrimi i ndihmës shëndetësore nga stafi shëndetësor. Rezidentet i gëzojnë te drejtat e barabarta si gjdo qytetar i republikës se Kosovës për tu trajtuar ne institucione shëndetësore.

Momentalisht i kemi 11 rezident, prej tyre janë 9 femra dhe 2 meshkuj.

Rezidentet i kemi nga komunat e ndryshme si ne vijim :

Komuna e Vushtrisë 4 , Komuna e Mitrovicës 2 , Komuna e Skenderajt 2 ,

Komuna e Prishtinës 1, Komuna e Obiliqit 1, Komuna e Shtimes 1.

Janë kryer kontrollet shëndetësore si ne vijim :

Shërbimet shëndetësorë te cilat janë kryer nga infermierët e ndërrimit janë :

-Pasqyre e gjakut ; Matje e tensionit ; Matja e sheqerit ; Përcjellja e vazhdueshme e terapisë; Pasqyrën e gjakut ne vazhdimësi e kryen QKMF-ja e komunës me staf te cilët marrin dozën e gjakut qe nevojitet për analiza dhe e sjellin rezultatin tek ne kurse, matjet tjera i bene infermieri kujdestar ne baze te raportit javor dhe sipas nevojës.

Ne bashkëpunim me QKMF-ne ne komunën e Vushtrisë dhe Islamik Relief sipas nevojës kemi bashkëpunuar për gjendjen shëndetësore te rezidenteve. Kemi pranuar ndihme nga Islamik Relief për rezidenten E.M te cilës i është dhënë shërbimi shëndetësor ne shtëpinë rezidenciale se bashku me infermieret e institucionit. Terapia dhe kontrollet shëndetësore përveç ne spitalin e Vushtrisë deri sa ka ndërruar jete i janë ofruar nga Islamik Relief . Rasti i E.M ka qene vazhdimisht ne vizita familjare dhe pas vdekjes janë njoftuar organet e rendit ku unë personalisht i kam përfunduar te gjitha procedurat ligjore.

Kemi bashkëpunim te vazhdueshëm me QPS-te e komunave te lartcekura dhe vizita te ndryshme nga personat përgjegjës për rastet qe ndodhen ne strehim.

-Nga Qendra për Përkujdesje Sociale këtë periudhe kohore nuk kemi pasur asnjë kërkesë për vendosjen e rezidenteve te ri ne institucion. Vizita tek rezidenten nga QPS-te kane qene vetëm nga komuna e Skenderajt dhe e Mitrovicës. Përmes emalit zyrtar i kam kërkuar secilës QPS përgjegjëse për rezidentin te cilin është ne përkujdesje qe te kompletohet dokumentacioni i cili mungon.

QPS te cilat i kam informuar përmes emalit janë nga këto komuna :

Vushtrri , Mitrovice , Skenderaj , Prishtine , Shtime , Obiliq.

Deri ne fund te vitit kam kërkuar qe te kompletohet dosja e secilit rezident për shkak se shumica kane qene te bartur nga instituti i Shtimes dhe dokumentacioni ne dosje ka qene i mangët.

Lënda e rezidentit I.G prej vitit te kaluar nuk kemi marr një vendim adekuat për shkak se dosja është e komplikuar dhe ne vitin e ardhshëm besoj qe do te sqarohet ne detaje ne bashkëpunim me Qendrën për Pune Sociale ne Mitrovice.

-Puna Individuale me Rezidente

Ka si pike synimi qe rezidentet te marrin asistencë individuale nga punëtorët dhe te ndjejnë siguri ne veprimet e veta dhe kjo arrihet me vete përmbajtje dhe durim te madh tek punonjësit social pasi qe veprimet e rezidenteve janë te ngadalshme dhe te pa koordinuara varësisht shkallës se zhvillimit psikik , andaj kujdesi duhet te jete maksimal.

-Puna ne grup

Kjo metode e punës sociale kërkon një durim dhe përkushtim te jashtëzakonshëm pasi qe te gjitha veprimet e rezidenteve janë te pa koordinuara. Puna ne grup ka për qellim rritjen e shkalles se shkathësive sociale personale te rezidenteve qe me pune dhe veprime te ndryshme te kërkohe qe te arrihet qëllimi i caktuar i integritetit dhe bashkëpunimit me te mire ne rrethin social.

-Intervenimi ne Kriza (situata emergjente)

Duke u bazuar ne gjendjen e tyre shpirtërore dhe shkallen e tyre te zhvillimit psikik rezidentet kanë shpesh edhe nevoja emergjente apo kriza te ndryshme qe krijon trajtim dhe menaxhim te shpejte , pasi që munde te ballafaqohemi edhe me situata te dhunës mes rezidenteve , andaj puna me rezident duhet te jete sistematike dhe profesionalisht ne nivelin e duhur. Punëtori se pari duhet te vërej ndryshimet tek rezidenti duke filluar nga shikimi , te ushqyerit , reagimi i tij gjate marrjes se ushqimit , qëndrimi ndaj rezidenteve te tjerë te cilat nuk janë karakteristikë e tij/saj.

-Ushqimi i rezidenteve është bere ne harmoni te plote me rregullat për një ushqim te begate dhe kalori te mjaftueshme për organizmin. Kjo është bere fale edhe furnizimit te mire nga ana e furnitorit ne baze te kërkesave me te cilat ju drejtohem. Po ashtu, personalisht unë e kam vendos menyne ne baza ditore për shkak qe te servohet ushqimi sa me klorik dhe te jete i ndryshëm gjate javës.

-Higjiena e rezidenteve dhe e ambientit te shtëpisë dhe kopshtit është mbajte ne një nivel te kënaqshëm nga stafi por te mbështetur edhe nga rezidentet e caktuar te cilët janë ne gjendje qe te jene aktivë ne punët e shtëpisë. Objekti pastrohet dy here ne dite nga mirëmbajtësit e kompanisë “Perparimi”. Rezidentet pastrohen ne gjdo mëngjes po sa te zgjohen si dhe gjate ditës sipas nevojës.

-Terapia për rezidentet te cilët duhet te mbahen vazhdimisht ne kontrole, duhet ti jepet me kohe dhe ne përcjellje te vazhdueshme te infermierit. Gjdo ndryshim te gjendjes emocionale dhe psikike përcjellët nga stafi dhe lajmërohet doktori ne këtë rast z.Azem Haliti – Psikiatër.

Stafi përbehet prej 4 infermierëve dhe 6 ndihmës infermiere.

Kemi qene ne kontakt te vazhdueshëm me Ministrinë E Drejtësisë rreth numrit te rezidentëve i cili duhet te raportohet ne baza mujore te përgjegjësja zonja z.Ganimete Musliu dhe rreth Planit te Punës për vitin 2025 dhe objektivat te cilat duhet te përmbushen ne këtë vit.

Gjithashtu kemi bashkëpunim te vazhdueshëm me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ne Komunën e Vushtrrisë dhe drejtorinë e kësaj drejtorie z.Lorik Maxhuni.

Vlen te theksohet qe buxheti i vitit 2024 nuk ka qene i mjaftueshëm për paga dhe mëditje për shkak se ne fund te vitit vlera totale nuk është përputhë me pagat e stafit dhe ndryshimet qe janë bere nga hyrja ne fuqi e ligjit te pagave LIGJI NR. 08/L-196. Bashkëpunimi i ndarjes se grandit buxhetor nga Ministria e Drejtësisë me Udhëheqësit e Shtëpive te Komunitetit nuk është ne nivelin e duhur rreth ndarjes se qarkoreve buxhetore. Ne bashkëpunim edhe me Udhëheqësit e Shtëpive te komunitetit nga komunat tjera kemi kërkuar qe ndarja buxhetore te behet ne bashkëpunim me Udhëheqësit dhe te shqyrtohen kërkesat e secilit sipas nevojave te institucionit. Po ashtu ne bashkëpunim me udhëheqësit e tjerë te komunave kemi kërkuar sqarim ne Ministrinë e Financave rreth kujdestarive te stafit dhe vendimit për kufizimin e orëve ku ne shumicën e institucioneve nuk po zbatohet si metode. Stafi i Shtëpise Rezidenciale për vitin 2025 ka buxhet 90,000 euro për paga dhe mëditje, dhe është i pamjaftueshëm për te mbuluar pjesën e kujdestarive duke marre parasysht edhe rritjen e pagave qe e parasheh qeveria nga muaji janar i vitit 2025.

Investime Kapitale

Është rinovuar pjesa e sallonit nga kontrata për mirëmbajtjen e objekteve dhe një investim i tille ka qene me se i nevojshëm për institucionin. Vlera e shpenzimeve kapitale 15,000 euro është shfrytëzuar për renovim te brendshëm si: ndërrimi i dyerve dhe dritareve, ndërrimi i dyshemesë, ndarja e pjese se stafit e cila ka qene pa asnjë standard, pastrimi dhe ngjyrosja e mureve si dhe vendosja e dritave te reja.

Gjate muajit Janar-Dhjetor 2024 është bere furnizimi me:

- Ushqim,
- Barna,

- Furnizim me higjiene,
- Furnizim me tekstil,
- Furnizim me divane,
- Furnizim me naftë për ngrohje qendrore,
- Pagesat e rrymës dhe mbeturinave dhe ujit,
- Pagesat e TV-se dhe internetit,

Aktivitetet të cilat janë inicuar në Drejtorinë për Prokurimin Publik janë:

- Dezinfektimi DD e objektit (është dezinfektuar objekti);
- Furnizim me pajisje kundër zjarrit(Mirembajtja e pajisjeve);
- Furnizim me tekstil (kemi bërë pranimin e mallit);
- Furnizim me lavatriqe, frigorifer, tharës rrobash, thithës elektrike (kemi pranuar furnizimin).

Aktivitetet të cilat nuk janë realizuar :

- Furnizim me klimë (tenderi nuk është realizuar);
- Furnizim me inventar nga AQP, operatori nuk ka furnizuar sipas kontratës.

Para të gatshme (Pati cash) për nevojat e institucionit janë shfrytëzuar 500 euro gjatë tërë vitit kalendarik.

Nga Agjencioni i Pavarur i Prokurimit janë lidhë kontrata :

- Furnizim me Buke dhe Brumera ;
- Furnizim me Qumesht;
- Furnizim me ujë;
- Furnizim me mish viçi
- Furnizim me mish pul
- Furnizim me produkte ushqimore
- Furnizim me derivate.

-Në institucion janë duke punuar nga ndermarrja NLP “Perparimi” :

- Dy (2) Sigurim objekti ;
- Dy (2) Mirembajtës të objektit.

Vlen të theksohet që instituciona ka nevojë për një veturë zyrtare për shkak se me lokacion jemi bukur larg komunes me të cilën kemi vazhdimisht bashkëpunim institucional.

Bashkëpunimi me Komunën e Vushtrrisë është në nivel dhe për çdo aktivitet kemi përkrahje në aspektin financiar.

Buxheti i vitit 2024 është shfrytëzuar rreth 98%

Ju lutem, ky raport është konfidencial dhe të ketë kujdes në publikimin e të dhënave sidomos të rezidentëve të cilët me vendim të gjykatës janë në përkujdesje të kujdestarit ligjor.

Qendra për Punë Sociale

Detyrat programore të Qendrës për Punë Sociale janë të rregulluara me Ligjin mbi Asistencën Sociale, Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Përkujdesjen Materiale të Familjeve me Fëmijë të Aftësisë së Kufizuar si dhe Ligje dhe Akte tjera të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në kuadër të veprimtarisë së vetë profesionale, Qendra për Punë Sociale:

1. Zbulon dhe përcjellë nevojat dhe problemet sociale të qytetarëve,
2. Zbulon familjet në gjendje të vështirë materiale dhe zbaton formën e ndihmës sociale në kuadër të kriterëve të përcaktuara me Ligj,
3. Propozon, organizon dhe ndërmerr masa në aplikimin e formave adekuate të mbrojtjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve sociale,

4. Inicon, organizon dhe koordinon punën profesionale dhe vullnetare në lëmin e mbrojtjes sociale,
5. Mbanë kontakte dhe bashkëpunon me OJQ dhe institucione që kanë fushëveprimin e mbrojtjes sociale.

Përveç punëve të lartëcekura, Qendra kryen edhe punë dhe shërbime të përcaktuara nga Ligji mbi Familjen, Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, pra kryen punë si ato të kujdestarisë:

1. Merr pjesë në procesin e marrjes së aftësisë së veprimit dhe rikthimit të sajë ndaj personave,
2. Kryen kujdestari të drejtëpërdrejtë përmes punëtorëve të vetë profesional,
3. Merr pjesë në marrjen e së drejtës prindërore dhe rikthimit,
4. Kryen punë të adoptimit,
5. Ofron ndihmë në rregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe familjare,
6. Jep mendim dhe propozim Gjykatës për pajtim të bashkëshortëve, besimit të fëmijëve dhe ndërrimit të vendimit për besim të fëmijës,
7. Ofron ndihmë në problemet zhvillimore të fëmijëve dhe çrregullime në sjelljet e tyre,
8. Ofron ndihmë familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar,
9. Ofron ndihmë dhe trajton personat e trafikuar dhe viktimat e dhunës në familje si dhe personat e abuzuar seksualisht,
10. Sistemon të moshuarit në shtëpi të pleqëve.

LËVIZJA E NUMRIT TË SHFRYTËZUESVE DHE REALIZIMIT TË FORMAVE TË MBROJTJES SOCIALE

Në periudhën raportuese mund të themi se kanë ardhë në shprehje maksimale të gjitha grupmoshat të shprehura përmes kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale dhe janë ofruar shërbime apo forma adekuate të mbrojtjes sociale. Krahasuar me vitin paraprak kemi ngritje të shërbimeve dhe të kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale.

ASISTENCA SOCIALE

Pranë QPS-së, Vushtri në Asistencë Sociale janë 1094 familje, prej tyre 1044 familje me 4586 anëtarë janë shqiptarë si dhe 50 familje me 64 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti janë parashtruar 43 kërkesa për asistencë sociale (ne SAS-in ekzistues) kurse me sistemin online përmes E- Kosova kanë qene 537 kërkesa, prej të cilave ne sistemin online janë aprovuar 145 kërkesa kurse ne SAS-in ekzistues janë aprovuar 14 familje kurse, 169 (39 nga SAS-I eksizes dhe 139 nga SAS Pilotimi) prej tyre janë refuzuar si familje, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa janë riaktivizuar 5 familje.

Nje numer i madh i lendeve te parashtruara ne SAS Pilotim jane ende ne procedure e siper.

Asistenca sociale i është ndërprerë 112 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

Në këtë periudhë raportuese kërkesa për ndihma momentale janë 1, prej tyre 1 janë aprovuar në vlerë prej 100 euro.

Gjatë kësaj periudhe në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 861 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 860 aplikues, janë refuzuar 13 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 7 te cilat gjate vitit jane ripranuar.

Gjatë kësaj periudhe 28 familje i kanë kthyer mjetet, pasi që janë refuzuar nga ATK dhe janë të obliguar t'i kthejnë mjetet. Kthimi i mjeteve bëhet për shumën e marrë të ndihmës sociale për një muaj.

SHËRBIMET SOCIALE

Në periudhën raportuese krahasuar me vitin paraprak numerikisht numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale. Të gjitha këto konkretizohen përmes shënimeve të mëtuqjeshme.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 42 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 9 kanë arritur pajtim dhe 33 ndarje.

Nga këto familje janë 52 fëmijë, prej tyre 22 i janë besuar nënës në përkujdesje, ndërsa 30 ju janë besuar babait në përkujdesje.

FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR

Edhe në këtë periudhë QPS-ja detyrë prioritare ka pasur punën me fëmijët pa kujdes prindëror dhe në përgjithësi fëmijët nga familjet devijante. Është bërë evidentimi i këtyre fëmijëve, hapja e dosjeve dhe përpunimi profesional i kësaj kategorie deri në përfundim e sipër si punë permanente. Kemi pasur 2 fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar, kurse gjatë këtij viti kemi 3 fëmijë të braktisur, pra gjithsej 5 fëmijë, ku i janë ofruar këto shërbime. Pas qëndrimit në spital për një periudhë një mujore fëmijët janë regjistruar, ju është caktuar kujdestari ligjor; 2 raste të bartura nga viti i kaluar janë adoptuar; 2 rastet e braktisjes së këtij viti fillimisht kanë kaluar në strehim familjar në komunitet e pastaj kanë kaluar në bashkim familjar, një fëmijë te nëna, një te babai; kurse 1 fëmijë i braktisur është vendosur në strehim familjar në komunitet. Gjate kesaj periudhe kemi 6 kerkesa nga Gjykata per vertetim te atesise.

Gjatë këtij viti i kemi pasur kërkesat për kujdestari të veçanta, kemi caktuar kujdestar ligjor për 11 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake, gjithsej 18 kujdestari aktive. Strehim familjar 16 raste, të gjithë fëmijët që janë në strehim familjar te të afërmit janë vizituar të gjitha rastet problematike, janë trajtuar në formën e duhur duke iu ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluese, e shërbime të tjera të nevojshme, DPSF na ka njoftuar përmes trajnimeve të organizuara me OJQ, OFAP sipas nevojave të kërkuara nga QPS mund të ofrohen shërbime dhe trajtime në fushën e psikologjisë për fëmijët në strehim familjar te të afërmit dhe në komunitet. Poashtu, kemi asistuar në gjykatë dhe kemi dhënë mendim, raport për 3 raste, martesë e të miturve.

Pra, krahasuar me vitin paraprak në periodën raportuese janë zbatuar në masë më të madhe format e mbrojtjes sociale si, vënia nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindëror, 4 raste, 11 kujdestari për raste të veçanta, asistencë sociale si dhe shërbime të tjera të punës sociale. Ndihma në natyrë këtë vit krahasuar me atë paraprak ka qenë shumë e vogël me që është varur nga donatorët.

TË MITURIT ME SJELLJE TË ÇRREGULLUARA DHE DELIKUENT TË MITUR

Në këtë periudhë kemi këtë gjendje 17 raste të delikucencës së të miturëve dhe 5 raste fëmijë me sjellje asociale, 25 raporte vlersuese rreth gjendjes sociale për fëmijë të cilët kanë bërë kundravajtje. Puntorët e shërbimeve sociale asistoin në polici dhe gjykatë për rastet e të miturëve delikuent në përgjithësi. Për kategorin e fëmijëve që bëjnë kundravajtje japin raport vlersues dhe propozues për masat ndëshkuese. Ndërsa për të miturit delikuent trajtimin dhe përpunimin e rasteve e bënë Shërbimi Sprovues të Kosovës, pra dhënjen e mendimeve gjykatave, ndërsa në i trajtojmë edhe më tutje në aspektin e mbiqkyrjes. Në këtë drejtim me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtëpërdrejt me policin, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjektet e tjera.

Veprat me të cilat karakterizohen të miturit me sjellje asociale janë bredhja, si rezultat i kësaj është prezente edhe trafikimi i vajzave të mitura. Ndërsa delikuenca e të miturëve karakterizohet më tepër me vepra penale, si vjedhje nga neni 135 LPK. Si dhe veprat prishje e rendit dhe qetësis publike, drejtim i automjetit pa patent shofer. Gjatë tretmanit psiko- social të

këtyre fëmijëve dhe të miturëve Qendra ka vendos kontakte permanente me të miturit, familjet apo kujdestarët e tyre si dhe bashkëpunim me subjekte tjera si OJQ, shkollat etj. Puna ka qenë e përqëndruar në identifikimin gjegjësisht diagnostifikimin e rastit, hulumtimin e personalitetit të fëmijut, identifikimin e interesave të të miturit dhe harmonizimin me normat e përgjithshme morale dhe juridike, organizimi dhe racionalizimi i kohës së të miturëve, etj.

VIKTIMA TE TRAFIKIMIT DHE TENTIM DHUNIMIT

Gjatë periodës raporutuese kemi 1 rast tentim dhunimi të të miturës, e cila është trajtuar nga Instituti i Mjeksis Ligjore dhe është referuar për trajtim psikologjik në Diakoni Kosova Mitrovicë pas trajtimit viktima është rikthyer në familjen e saj, dhe 1 rast e mitur e shfrytëzuar për pornografi rasti është në procedur, 3 raste të abuzimit seksual. Në këtë vit nuk kemi raste të të rriturave të cilat dyshohet për trafikim

Ekipi shërbimeve sociale në këto raste përcjellë këto viktima prej fillimit të hetuesisë në bashkëpunim me policin, gjykatën, familjet dhe subjektet e tjera. Vlen të theksohet se nga QPS-ja në këtë vit janë ndihmuar reth riintegrit 3 viktima të trafikimit nga vitet paraprake këto viktima të trafikimit kanë pasur edhe mbështetjen financiare me qëllim të rehabilitimit dhe riintegrit të tyre. Pra puna kryesore ka qenë e fokusuar në risocializimin, kthimin e tyre në familje dhe të rikthimit në shkollim të rregulltë. Në këtë drejtim nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me qendrën e shëndetit mendor, kemi pasur raste të trajtuar nga kjo qender dhe mendoim se ka pasur sukses në stabilizimin e tyre psiko-social.

DHUNA FAMILJARE

Gjatë periodës që po raportojmë ka pasur shtim të rasteve ku kemi 43 raste të raportimit të dhunës familjare, ndaj femrave dhe raste ndaj antarëve të familjes, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e Qendrës për Punë Sociale duhet të jenë në gadishmëri dhe të ju ofrojnë asistim në polici, asistim në gjykatë, vendosje në strehim të përkohshëm, seanca konsultuese e këshilluese dhe bashkimin familjarë.

Në këtë vit kemi 1 vajzë, dhe një grua të vendosura në strehimoren Raba Voca Mitrovicë. Dhe 1 rast të mbartur nga vitet e kaluara e vendosur në Shtëpinë e Sigurt Gjakovë.

Janë dhënë 43 urdhra mbrojtje prej gjykatës për rastet e dhunës në familje, 15 raste kemi arritur ta pajtoim, 16 ndarje, ndërsa rastet e tjera janë në procedur. Punëtorëve të shërbimeve sociale ju mbetet të vazhdojnë me trajtimin e këtyre rasteve në vitin vijues.

PERSONAT E MOSHUAR

Sikurse edhe kategorit tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periodë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 4 raste 2 në shtëpinë e pleqëve Skenderaj dhe 2 në Prishtinë, 1 kerkesa te reja, 1 kerkes eshte në procedur për tu vendosur ne shtëpi të pleqëve Prishtinë, dhe janë dhënë 20 raporte për bashkim familjar tek të afërmëve jashtë shtetit.

KATEGORI DHE SHERBIME TË TJERA

Në Qendër për Pune Sociale ofrohen sherbime edhe për këto gategori jane dhenë:

Vertetime për lirim nga shtetësia e Kosovës 21

Certifikata për zotësi të veprimit për punë dhe për armbajtje 753,

Asistime ne polici per fëmijët e mitur dhe raste te dhunës në familje 85,

Pjesmarrje ne seancë gjygsore 137,

Vizita në familje 185,

Kontaktim prind fëmijë 440,
 Seanca konsultime dhe këshillime 331
 Bashkëpunim me Institucione 178
 Konstatime Zyrtarë 41

Regjistrim i më vonshëm i fëmijëve 3 etj

Gjate këtij viti jane mbajtur 3 komisione mjekësore për fëmijët me aftësi të kufizuar në muajin Shkurt, Maj dhe Dhjetor kanë aplikuar 48 raste te reja, prej tyre 29 janë miratuar 14 plotësime dhe 4 janë refuzuar, 1 mungon.

Është punuar në bazë të shërbimeve sociale, bazën e strehimit familjar dhe bazë të fëmijëve me aftësi të kufizuar gjithsej 143 raste. Gjate këtij viti është bërë lëshimi i një baze të re online për dhunën në familje.

PENGESAT NË REALIZIMIN E DETYRAVE PROGRAMORE

Pengesat të cilat janë paraqitë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së institucionit dhe pengesat të cilat do të paraqiten në të ardhmen për realizimin e objektivave të këtij institucioni mendojm se janë të klasifikuara si në vijim:

- ✓ Numri i pamjaftueshëm i zyrtareve .
- ✓ Mospagimi i zyrtarëve të shërbimeve sociale për punë jashtë orarit zyrtarë (kujdestaris).
- ✓ Mos siguria në punë (puntorët e qendres rrezikohen në kryerjen e detyrave zyrtare nga kërcenimet dhe pengesat e palëve).
- ✓ Mungesa e një veture zyrtare për verifikimin e terrenit.
- ✓ Trajnimet shites të stafit punues me qëllim të avansimit profesional.

Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural gjatë vitit 2024 në kuadër të obligimeve dhe detyrave të saja ka zhvilluar një mori të aktiviteteve, aktivitete këto të bazuara kryesisht në planin e punës për vitin 2024.

Shpallja e thirrjes dhe zhvillimi i të gjitha procedurave të parapara për pagesa direkt për fermerët e komunës së Vushtrisë të cilët janë prodhues të qumështit për dy periudhë 6 mujore në vlerë të përgjithshme prej 140207.60€ , numër i përfituesve 107 fermerë (2 605 175 litra x 0.04 = 140,207.60).

Kemi pranuar si dhe vendosjen në sistem të AZHB lëndët në aplikim për litër qumësht dhe viça për majmëri në dy thirrjet e ministrisë numër i të aplikuarve 224 fermerë.

Kemi bërë digjitalizimin e sipërfaqeve të mbjellave me kultura bujqësore si dhe vendosjen në sistem të aplikimit për AZHB të mbarështuesve të kafshëve për 1590 fermerë.

Më poshtë po e paraqesim në formë tabelore fermerët:

Aplikuesit per subcencione në vitin 2024											
Nr	Vendbanimi	Grurë	Misër	Patate	Perime	Pemë		Lopë	dele	dhi	bletë
1	Akrashticë	67.74	75.8	17.29	17.3	9.26	187.39	15	100		107
2	Banjskë	62.1	36.9	1.4	6.51	3.89	110.8	17			

3	Balincë	26.1	26.6		1.09	1.15	54.94	5			
4	Beçiq	29.1	22.2		4.33		55.63				
5	Beçuk	31.77	50.28		0.53	3.09	85.67	13			
6	Begaj	7.75	11.06		3.83	3.96	26.6				65
7	Bivolak	36.24	42.87		8.13		87.24	10			
8	Brusnik	53.53	58.01	2.95	0.86	0.75	116.1	46			43
9	Bukosh	63.54	54.63	1.01	3.6	7.44	130.22	69	103	82	
10	Ceceli	14.5	14	2.08	13.7	3.26	47.54	28	70	65	123
11	Dalak	26.4	31.23	1.75	10.1	2.06	71.54	44			152
12	Doberllukë	115.8	27.8	287.5	31.2	1.62	463.92	12			70
13	Druar	93.95	101.7	5.77	6.38	2.73	210.53	52	63		67
14	Dubovc	35.73	19.8		1.09	1.39	58.01	12			35
15	Dumnicë e Epërme	30.16	35.77		7.46	3.37	76.76	25			
16	Dumnicë e Llugav	178.3	80.25		26	2.33	286.88	53	40		332
17	Dumnicë e Poshtme	103.8	114.5	6.79	24	1.17	250.26	72	322		
18	Galic	32.4	13		2.87		48.27	14	30		
19	Gllavotin	16	23.8		2.8		42.6	15			58
20	Gojbulë	8.88	4.45			1.91	15.24				
21	Gracë	26.2	25.9	6.39	0.36	0.65	59.5	13			
22	Gumnisht	5.26	6.03		4.81		16.1	32			74
23	Hercegovë	4.61	5.75		0.56	1.51	12.43	10	22		
24	Karaqë	14.7	15.73		3.53	5.82	39.78	72			
25	Kollë	65.2	214		1.95	0.82	281.97	76			30
26	Kunovik		10.94			2.53	13.47		104		200
27	Kurillovë	0	1.7	0.57	1.26		3.53	67			46
28	Liqej	52.52	39.47	1.3	18.7	1.89	113.88	19		30	175
29	Lumadh	7.37	33.03		0.22	1.29	41.91	5			
30	Maxhunaj	72.51	42.6	24.7	9.04	5.51	154.36	63			50
31	Mihaliq	89.74	98.97	18.43	19.9		227.04	11			125
32	Nedakoc	20.6	14.2	12.7	15.4	0.58	63.48	5			38
33	Novolan	219	88.14	0.74	11	4.42	323.3	98			65
34	Oshlan	101.4	55.13	1.22	21.4	16.3	195.45	11			365
35	Pantinë	61.6	37	8.13	6.21	3.79	116.73	32	85		
36	Pasomë	11.1	24.1	0.64	1.97	3.92	41.73	29	260		73
37	Pestovë	256.5	60	434.2	19.2	6.15	776.05	24	49		
38	Prilluzhë	151	106	2.28	2.03	2.43	263.74				30
39	Reznik	169.1	112.7	9.63	19.9	3.24	314.57	33			145
40	Ropicë	62.31	42.66		4.02	1.74	110.73	41			65
41	Samadrexhë	62.7	118.6	4.59	10.8	3.62	200.31	60			245
42	Sfaraqak I Epërm	5.71	6.91		4.04		16.66		32		
43	Sfaraqak I Poshtëm	28.7	31.8	78	8.41	4.45	151.36	5	135		78
44	Shalë	29.8	35	5.46	3.82	10.1	84.18	46	38		

45	Shlivovicë				1.76	2.29	4.05				
46	Shtitaricë	26.6	14.4	8.99	25.9	1.57	77.46				
47	Skromë	5.37	2.46		3.02		10.85	5	42		165
48	Sllakovc	3.64	2.6	0.76	0.84		7.84				
49	Sllatinë	12	33.51		4.44		49.95				
50	Smrekonicë	15.5	33.83		3.55	0.58	53.46	8			94
51	Stanovc i Epërm	281.7	336.6	2.02	25.6	5.22	651.14	231			125
52	Stanovc i Poshtëm	45.1	63	2.46	6.97	3.11	120.64	6			30
53	Strovç	28.6	43.08		5.58	0.71	77.97	21			151
54	Studime e Epërme	45.8	30.62		6.68	0.5	83.6	14			
55	Studime e Poshtme	117	79.03	2.56	16.6	2.84	218.03	32			389
56	Taraxhë	6.6	15.8		3.64	4.51	30.55				
57	Terllabuq	2.86	4.11			0.5	7.47	8			37
58	Vërmica	54.9	34.8	3.42	4.59		97.71	21			
59	Vesekovc	9.47	6.95	0.63		3.8	20.85	32			413
60	Vilanc	18.2	31.6		3.35		53.15				
61	Vushtrri	181	201	64.76	64.8	52.3	563.86	134	829	92	467
62	Zhilivod	9.33	18	0.42	2.63		30.38	13			
	TOTALI	3415.1	3022.4	1022	540.3	208.07	8207.36	1779	2324	269	4727

Në cilësi të anëtarit të komisionit për vlerësim të dëmeve kemi trajtuar të gjitha kërkesat me ç'rast kemi hartua raport mbi sasinë e dëmit.

Projekte me bashkëfinancim me organizatën IADK

Perkrahjet e fermereve te komunes se Vushtrrise me grante ne sektoret e ndryshem te bujqesise gjate vitit 2024				
N r.	Lloji i grantit	Nr. i përfituese ve	Vlera e grantit per perfitues/€	Donatori
1	Ngritja e serrës 176 m ² , me inpute dhe fidanë të perimeve	9	3,000.00	Bfdw
2	Laktofriz 300 L, 1 makinë mjelëse dhe 1 bidon të qumshetit me kapacitet 20 L	6	2,600.00	Bfdw
3	Ngritja e Njësisë për Përpunim të Qumështit	1	6,000.00	Bfdw
4	Ngritja e serrës 120 m ² , me inpute dhe fidanë të perimeve	11	2,000.00	FRIEDA
5	Perkrahja me fidane perimesh apo pajisje te vogla esenciale per pune ne perpunim	17	150.00	FRIEDA
6	Perkrahja me pajisje te vogla esenciale per pune ne perpunim	13	150.00	GIZ

7	Perkrahja me pajisje te vogla ne sektorin e pemeve dhe perimeve (sperkatese, gersher per krasitje)	4	55.00	GIZ
8	Perkrahja me pajisje te vogla ne sektorin e blegtorise (bidona per qumesht)	21	55.00	GIZ
	Gjithesejt	82		

Vendime për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.
Gjithsejtë vendime të lëshuara 41, me vlerë të përgjithshme 147,222.15€

Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, prandaj mbështetur në planin e punës së kryetarit të komunës, ka përgatitur Raportin e punës për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Drejtoria për Shërbime Publike bënë rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, bënë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjell largimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrë punën e lëmisë së furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon me procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve dhe gjelbërimit të qytetit, mbikëqyrë dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, etj.

Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve pas shqyrtimit në nivel të Drejtorisë, janë dërguar në procedura të mëtutjeshme për vendosje, siç është Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës. Është konstatuar se nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për rregullimin e infrastrukturës dhe problemeve tjera komunale, janë shumë të mëdha por për shkak të buxhetit të limituar dhe gjendjes jo të mirë ekonomike të vetë komunitetit, zgjedhja e këtyre problemeve është e vështirësuar.

Furnizimi me ujë

Gjatë këtij viti kemi qenë të orientuar në vazhdimin e instalimit te pompave për furnizim me ujë të konomive familjare fshatrave Ropicë Vilanc Samadrexhë dhe fshatrat tjera në pjesën lindore të Komunës së Vushtrrisë. Gjithashtu kemi qenë të orientuar në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të kësaj fabrike si dhe krijimin e TASK FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes në mënyrë që të kemi furnizim më të rregullt me ujë. **Numri i projekteve apo punë të planifikuara për rrjetin e ujësjellësit në vitin 2024 ka qenë vazhdimi i kontratës tre vjeçare, i cili është finalizuar gjatë vitit 2023.**

Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit po ashtu janë bërë investime të shumta sidomos në shtrirjen e rrjetit primar – kolektorëve kryesor në një numër të konsiderueshëm të fshatrave, duke implementuar kontratat për projekte dy vjeçare për vitet 2023-2024. **Gjate vitit 2024 janë realizuar aktivitetet e planifikuara dhe të kontraktuara pra tri kontrata dy vjeçare LOT 1, LOT 2 dhe LOT 3 për të cilat janë realizuar mjetet e planifikuara duke përfshirë nga LOT 2 fshatrat Akrahticë – Balinc 1800 m, Shtitaricë 900 m, Stanoc i Poshtëm 1780 m, Reznik 1865 m, Mihaliq 2000 m, Bruznik 1000 m dhe qytet rruga „Nimon Ferizi” 620 m, nga LOT 3 fshatrat Duboc 1817 m, Galicë 171 m, Liqej 1585 m, Pantinë-Ashlan 1126 m, Bukosh 502 m, Smrekonicë**

439 m, Kollë 605 m, Gllavotin 527 m, Gojbulë 679 m, Pasomë 2203 m, Pantinë lagja Shaqiri 918 m, dhe Pestovë 926 m. Ndërsa në LOT 1 janë realizuar punë në fshatrat Dumnicë e Poshtme 2700 m dhe një pjesë në Nadakoc – Studime 1900 m, fshatin Sfaraqak 2700 m dhe Maxhunaj 2700 m. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonomitë familjare sipas ASK-se. Pra gjatë vitit 2024 kanë qenë të planifikuara gjithësej 22 aktivitetet

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së Drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen Përparimi.

Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, ka bërë rishikimin e planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2022-2026. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh.. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Bajsk dhe aktualisht i kemi vetëm tri deponi të tilla. Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „Përparimi” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit. Tashmë shërbimet bazike të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve konsiderohen të përmbushura si rezultat i implementimit të plotë të Planit Operativ.

Përveç përmbjlljes së proceseve për shërbimet bazike, janë zhvilluar aktivitetet për fillimin e procesit të ndarjes së mbeturinave në burim.

Edhe pse jemi ballafaqar me problemet e shkaktuara nga ngritjet enorme të konsumit ditor, kemi arritur që të bëjmë inkasimin e mjeteve në vlerën 692,824.86 € si dhe kemi bërë filtrimin e listave duke implementuar Vendimet paraprake të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për lirim nga pagesa të rasteve sociale si dhe filtrimin e listave në bazë të kërkeve të qytetarëve dhe vlerësimit të komisionit për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Është ky viti i tretë prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale „Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e luleve dekorative, mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimit publik.

Gjithashtu përmes Ndërmarrjes komunale „Përparimi” është bërë mirëmbajtja e të gjitha hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së hapësirave publike në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës si dhe është bërë punë më e madhe në terren.

Gjithashtu Ndërmarrjes „Përparimi” i është kaluar në menaxhim i tërë procesi i grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2023 dhe gjithashtu është hartuar dhe dorëzuar në MAPL Raporti i Sistemit për Menaxhim të Performancës në ofrimin e shërbimeve komunale për vitin 2023.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja me ofrimin e shërbimeve për ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet që pranojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Në fushën e **mirëmbajtjes së gjelbërimit** me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si:

- Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ;
- Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit;
- Plani i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rrethojës, inventarit, gjelbërimit dhe drunjve në parqe;

- Plani i mirëmbajtjes së stazave dhe rrugicave në parqe;
- Është punuar edhe në planin e mirëmbajtjes së varrezave, në varreza të dëshmorëve, martirëve dhe atyre të qytetit

Gjithashtu është përfunduar kontrata për ndërtimin e parqeve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë me ç'rast janë përmbyllur ndërtimet e 4872 m², pra gjithsej sipërfaqja e parqeve dhe sheshe është 299772 m².

Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni

Në kuadër të projektit për ndërtimin e rrugëve me kubza betoni janë realizuar tri kontrata dhe janë investuar në LOT 2 45000.00 euro dhe janë realizuar gjithsej 450 m në LOT 3 43000.00 euro në gjatësinë 480 m, si dhe në LOT 1 janë investuar 17 000.00 euro.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar zgjerimi dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit të rrugëve në qytet dhe në fshatra si dhe ndriçimi i parqeve dhe shesheve sipas Marrëveshjes me Ndërmarrjen „Përparimi”.

Ndërtimi i trotuareve

Me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë për këmbësorët është duke u investuar në ndërtimin e trotuareve në 3 vendbanime në vlerën prej 40,000.00 € prej të cilave në fsh. Dobërllugë në gjatësinë 280 m, në fshatin Reznik në gjatësinë 470 m dhe në fshatin Stroc 315 m.

Ndërtimi i urave

Në kuadër të projektit për ndërtimin e urave janë investuar 51,690.00 euro dhe atë në fshatrat Akrashticë, Studime, Duboc, Ropicë dhe Smrekonicë, si dhe ndërtimi i urës te Lumi Podranqa në vlerën 41,000.00 €. Është bërë ndërtimi i vigut mbi lumin Silnica dhe Lumi Llap në vlerën prej 53,958.54 euro, si dhe ka vazhduar ndërtimi i shtratit të Lumit në fshatin Smrekonicë dhe Lumit Tërstena.

Gjithësej rrugë	Rrugë të ndërtuara	Trotuare	Ndriçim Publik	Shteg për bicikleta	Rrugë të sinjalizuara
750.332 km	746.845 km	174.671 km	343.96 km	16.2	285 km

Komunikacion

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Në fushën e transportit është hartuar Plani Komunal për Transport Lokal Publik të udhëtarëve 2024-2028 dhe gjithashtu në bashkëpunim me UN-Habitatin është duke u hartuar Plani i Mobilitetit për Komunën e Vushtrrisë përmes së cilit synojmë të krijojmë një rrjet funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të lirë të biçikletave. Gjithashtu është finalizuar kontrata për vendosjen e monitorëve digjital në hyrje të qytetit në vlerën prej 49,498.72 €

Po ashtu janë menaxhuar kontratat për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale.

Në fushën e transportit publik është bërë përpilimi i rrezeve të udhëtimit për operatorët e licensuar dhe ka vazhduar mbajtja e rendit të udhëtimit nga Operatorët Ekonomik të cilët mbulojnë rreth 54 vendbanime.

Gjithësej mjete	Parkingje	Vendparkingje	Parkingje për persona me	Vendbanime me transport publik	Vendndalime të sinjalizuara

motorike te regjistruara			nevoja te veqanta		
11640	29	1198	23	54	51

Parkingjet publike

Hapësira për parkingje brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë të cilat janë në shërbim të qytetarëve janë 29 me gjithsej 1168 vend parkingje prej të cilave 22 hapësira posedojnë vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta. Ndërsa lokacioni i rezervuar për parkimin e mjeteve motorik

Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Gjatë periudhës raportuese në fjalë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të këtyre Ligjeve dhe Urdhëresave administrative:

- Ligji mbi Kadastrën nr 04/-L-013 të dt 29.07.2011,
- Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 2002/5 mbi themelimin e regjistrave të drejtave në pronën e patundshmërive nr 04/L-009 të dt 21.07.2011,
- Udhëzimi Administrativ nr MSHP 2004/08 për zbatimin e ligjit për kadastër të dt 22.09.2004,
- Ligjin nr 2002/4 për hipotekat të dt 17.10.2002,
- Urdhëresat dhe Udhëzimet Administrative, të cilat merren – nxjerrën nga AKKja,
- Statuti i Komunës së Vushtrrisë etj.

Punët e kryera:

1. Regjistrimi i pronave të patundshme
2. Aktvendimet për korigjimin e regjistrit sa i përket emrit dhe mbiemrit të pronarëve,
3. Aktvendimet për regjistrimin e hipotekave,
4. Aktvendimet për çregjistrimin e hipotekave,
5. Lëshon vërtetime dhe certifikata të ndryshme,
6. Copëtimin – ndarjen dhe bashkimin e ngastrave kadastrale,
7. Incizimi i gjendjes faktike,
8. Identifikimi – përkufizimi i patundshmërive,
9. Ekspertizat Gjyqësore,
10. Lëshon kopjet e planeve,
11. Lëshon listat – certifikatat e patundshmërive (fleta poseduese),
12. Zgjidhjen e kërkesave zyrtare të Institucioneve të ndryshme, Ndërmarrjeve, Organizatave Qeveritare dhe joqeveritare,
13. Kontrollon dhe korigjon operatin kadastral dhe hartat kadastrale,
14. Kryen punët në teren nga veprimtaria e vet si dhe në rastet kur është e autorizuar me Ligj,
15. Vendos dhe mirëmban shenjat gjeodezike të ndarjeve të patundshmërive,
16. Me kërkesën e AKK-së, ndërmer veprime dhe aktivitete që kërkohen nga AKK-ja, dërgimi i shënimeve, informatave dhe dokumentacionit i cili kerkohet.
17. Punët tjera nga kompetenca e vet të parapara me Ligj, Urdhëresa administrative dhe akte tjera nënligjore.

Në bazë të organogramit të Kuvendit të Komunës për vitin 2024, për organizimin e administratës së komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë, është e organizuar në tre sektor: Sektori për Gjeodezi, Sektori për Kadastër dhe Sektori për Pronë.

Gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Nr. Rend.	LENDET E ARRITURA Janar- dhjetor 2024	Gjithsejtë
1.	KERKESAT E ARRITURA	8042
2	AKTVENDIME PER BARTJE TE PRONES	1330
3.	AKTV. PER PERMIRESIM TE EMRAVE NE RDPP	248
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	125
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	94
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA TE NDRYSHME	332
7.	NDARJE DHE BASHKIM TE PARCELAVE	642
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	46
9.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E BARRES TATIMORE	21
10.	KOPJE TE PLANIT	875
11.	LISTA POSEDUESE	3005
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	158
13.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E MASES SE SIGURISE	12
14.	LENDET NE PROCEDURE	38
15	Kërkesa tjera(identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	210

Në periudhën Janar-dhjetor 2024 kemi pranuar 1330 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka marr 1298 aktvendime me të cilat janë miratuar ose refuzuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje për vitin 2025 kanë mbetur 32 kërkesa (lëndë).

Kemi pranuar nga ana e palëve – qytetarëve 248 kërkesa për korrigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar 236 kërkesa të tilla ndërsa 12 prej tyre janë refuzuar. Këto kërkesa në lidhje me korrigjimin e emrit apo të mbiemrit bëhen pa pagesë.

Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe prone në periudhën janar-dhjetor 2024 ka pranuar 125 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe 94 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik.

Pas zhvillimit të procedurës kemi marr 125 aktvendime për regjistrimin e hipotekave dhe 94 aktvendime për çregjistrimin e hipotekave.

Për nevoja të përfituesve të ndihmës sociale janë lëshuar 920 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 314 certifikata pronësore. Pasi që përfituesit e ndihmës sociale janë të liruar nga pagesa për shërbime të tilla nga këto shërbime nuk janë inkasuar mjete financiare.

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar 3005 certifikata pronësore dhe 875 kopje të planit.

Gjatë periudhës raportuese nuk kemi zhvilluar asnjë procedurë të shpronësimit të pronës së paluajtshme për interes publik, ndërsa kemi zhvilluar tri procedura administrative lidhur me lirimin e pronës komunale.

Gjithsejtë të hyrat buxhetore për vitin 2024 nga drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë 94,459.00 euro, ndërsa të hyra nga dhënia me qira të pronave komunale janë inkasuar 47,569.05 euro.

Pranë kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

MENAXHIMI I PRONES KOMUNALE

Bazuar në nenin 22, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme, paraqesim Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore dhe lokaleve afariste në pronësi të komunës për periudhën 01.01.2024-31.12.2024.

Për momentin në menaxhim kemi 25 Kontrata për dhënie në shfrytëzim të tokave bujqësore në pronësi të komunës dhe 28 Kontrata për dhënie me qira të lokaleve afariste në pronësi të komunës. Gjatë kësaj periudhe janë bërë 5 këmbime të pronave, janë proceduar 2 prona për shpronësim, janë lëshuar 18 vendime për lirim të pronës së uzurpuar, janë lëshuar 25 njoftime për borgjet e pa shlyera të qirasë.

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, bazuar në Ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës të Komunës, ka përpiluar dhe publikuar në Uebfaqen e Komunës Listën e përgjithshme të pronave komunale.

Gjithashtu, kemi hartuar Listën e veçantë të pronave të komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025, e cila listë është miratuar nga Kuvendi i Komunës në seancën e muajit dhjetor ashtu si e parasheh ligji në fuqi.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nuk janë lidhur kontrata të reja për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.

Vlera e inkasuar nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024 arrin shumën prej 47,569.05€.

PUNET E KRYERA PER NEVOJA TE KOMUNES

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevojat të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)

Për kundër punëve dhe detyrave të punës të kryera në këtë vit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ballafaqohet me një seri problemesh të natyrës objektive dhe subjektive si:

Mungesa e Elaborateve kadastrale, të cilat janë plaçkitur nga okupatori serb në vitin 1999,

Problemet e trashëguara të natyrës pasurore-juridike si uzurpimet, kontestet e bartura nga komasacioni etj.

Mungesa e stafit dhe mos funksionalizimi i Sektorit të Pronës deri në gjysmën e vitit 2024 na ka sjellë problem në menaxhimin kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, lirimi i pronës komunale nga uzurpimet dhe në përgjithësi menaxhimin i pronës komunale

Drejtoria për Diasporë

Në përputhje me objektivat e Komunës së Vushtrrisë dhe politikave të saj për diasporën, Drejtoria për Diasporë ka për qëllim forcimin e lidhjeve dhe mbështetjes për qytetarët vushtrrias që jetojnë jashtë vendit. Gjatë vitit 2024, Drejtoria ka realizuar aktivitete të shumta, duke ofruar shërbime të ndryshme dhe duke mundësuar zhvillimin e mundësive të reja për diasporë, me qëllim përmirësimin e kushteve për ta dhe promovimin e potencialeve të komunës në nivel ndërkombëtar.

Objektivat e Drejtorisë për Diasporë

- Të forcohen lidhjet dhe bashkëpunimi me diasporën vushtrriase.
- Të ofrohen shërbime dhe asistencë për qytetarët vushtrrias që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

- Të promovohen mundësitë për investime dhe zhvillim ekonomik nga diaspora.
- Të mbështetet dhe stimulohen projekte që mund të sjellin përfitime për komunën dhe diasporën.
- Të krijohen mundësi për rritjen e angazhimit të diasporës në çështje kulturore, edukative dhe sociale.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2024

Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative

- **Festivalet dhe aktivitete kulturore:** Aktivitetet kulturore përfshinë organizimin e manifestimeve dhe ekspozitave me temë kulturore dhe historike, ku diaspora kishte mundësinë të prezantonte trashëgiminë e saj. Këto aktivitete janë mbështetur financiarisht nga donatorë të ndryshëm dhe kanë kontribuar në forcimin e lidhjeve kulturore.

Projekte zhvillimore dhe investime nga diaspora

- **Krijimi i mundësive për investime nga diaspora:** Drejtoria ka punuar në zhvillimin e mundësive për investime të diaspora, duke përfshirë takime me investitorë dhe promovimin e mundësive që ofron Komuna e Vushtrrisë për biznese të reja. Gjithashtu, janë realizuar kontakte me disa kompani nga diaspora që kanë shprehur interes për investime në Vushtri.
- **Mbështetje për projekte infrastrukturore dhe sociale:** Diaspora është inkurajuar të kontribuoni në financimin e projekteve të infrastrukturës dhe atyre sociale në Komunën e Vushtrrisë. Ky mbështetje ka ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Sfida dhe Vështirësi

- **Mungesa e financimeve për disa projekte:** Ndër sfidat kryesore ka qenë mungesa e fondeve të mjaftueshme për disa projekte që kanë pasur si qëllim zhvillimin e mundësive për diaspora, si dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim dhe investime.
- **Komunikimi dhe koordinimi i ngadaltë:** Ndër sfidat tjera është edhe nevojja për përmirësim të komunikimit dhe koordinimit me disa institucione, që mund të bëjnë më të lehtë asistencën dhe shërbimet për diasporën.

Prioritetet për vitin 2025

- **Zhvillimi i platformës online për diasporën:** Puna në krijimin e një platforme online që do të mundësojë shërbime më të shpejta dhe efikase për diasporën, si dhe mundësi për investime dhe projekte.
- **Fuqizimi i marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare të diasporës:** Krijimi i mundësive të reja për diasporën për të investuar në projekte të përbashkëta që përfshijnë zhvillimin ekonomik, kulturor dhe social të Komunës së Vushtrrisë.
- **Mbështetje për rinovimin dhe rritjen e investimeve nga diaspora:** Angazhimi i diasporës në krijimin e mundësive të reja për krijimin e bizneseve dhe investimeve në komunë.

Organizimi i Diteve të Diasporës – 25-28 Korrik 2024, Komuna e Vushtrrisë

Dita e Diasporës është një ngjarje e rëndësishme që organizohet çdo vit për të festuar arritjet dhe kontributet e komunitetit të diasporës për zhvillimin e Kosovës dhe të Komunës së Vushtrrisë. Aktivitetet e organizuara në këtë periudhë synojnë përfundimisht forcimin e lidhjeve midis diasporës dhe atdheut, si dhe krijimin e mundësive për bashkëpunim të mëtejshëm në fusha të ndryshme, përfshirë kulturën, ekonominë dhe shoqërinë. Kjo ngjarje është një mundësi për të promovuar arritjet e bashkatdhetarëve tanë jashtë vendit dhe për të ofruar mundësi për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm.

2. Qëllimi i Diteve të Diasporës

- Të forcohet lidhja e diasporës me atdhenë, përmes aktiviteteve kulturore, edukative dhe ekonomike.
- Të promovohen mundësitë për investime dhe zhvillim ekonomik në Komunën e Vushtrrisë.
- Të shfaqen arritjet dhe kontributet e diasporës për zhvillimin e Kosovës.
- Të krijohen mundësi për rinovimin dhe mbështetje për projekte zhvillimore nga diaspora.

3. Programi i Diteve të Diasporës (25-28 Korrik 2024)

Kontaktet dhe Përpjekjet për Bashkëpunim me Ansamblet dhe Organizatat Kulturore të Diasporës në Shtetet e Evropës dhe më gjerë

Drejtoria për Diasporë e Komunës së Vushtrrisë ka ndërmarrë një seri nismash dhe përpjekjesh për të krijuar dhe forcuar lidhje me ansamblet dhe organizatat kulturore të diasporës, veçanërisht në shtetet e Evropës dhe më gjerë. Ky bashkëpunim ka për qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore, promovimin e identitetit shqiptar, si dhe rritjen e mundësive për shkëmbime kulturore dhe edukative ndërmjet diasporës dhe atdheut.

Objektivat e Bashkëpunimit me Ansamblet dhe Organizatat Kulturore:

- **Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore:** Organizimi i aktiviteteve kulturore, shfaqjeve, ekspozitave dhe festivaleve që reflektojnë kulturën dhe traditat e Komunës së Vushtrrisë.
- **Shkëmbimi i kulturave dhe artit:** Krijimi i mundësive për shfaqje dhe festivale të përbashkëta, ku ansamblet dhe grupet kulturore nga diaspora të mund të prezantojnë artin dhe kulturën e Kosovës në shtetet ku jetojnë.
- **Promovimi i mundësive për investime dhe zhvillim ekonomik:** Pjesëmarrja e ansambleve kulturore në aktivitete që promovojnë mundësitë e zhvillimit ekonomik dhe turistik të Komunës së Vushtrrisë, duke inkurajuar investimet nga diaspora.
- **Mbështetje dhe stimulim i projekteve të përbashkëta:** Nxitja e krijimit të projekteve kulturore, edukative dhe sociale që përfshijnë diaspora dhe Komunën e Vushtrrisë.

Aktivitetet dhe Përpjekjet për Bashkëpunim në Evropë dhe më gjerë:

Takime virtuale dhe vizita me Ansamblet e Diasporës:

- **Vizita në shtetet e Evropës:** Pjesë e aktiviteteve të Drejtorisë për Diasporë ka qenë zhvillimi i takimeve online, ku ka grupe dhe ansamble kulturore të diasporës vushtrriase. Këto takime virtuale kanë pasur për qëllim njohjen me aktivitetet kulturore dhe mundësitë e bashkëpunimit, si dhe forcimin e lidhjeve të bashkërenduara për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.
- **Takime me organizatat kulturore:** Drejtoria ka zhvilluar takime të drejtpërdrejta online me përfaqësues të organizatave dhe ansambleve kulturore shqiptare në shtetet e Evropës (Gjermani, Zvicër, Austri, Suedi, etj.). Gjatë këtyre takimeve, janë diskutuar mundësitë për organizimin e festivaleve të përbashkëta, si dhe aktivitete të tjera kulturore dhe edukative që përfshijnë anëtarët e diasporës dhe qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

Organizohet Pjesëmarrja e Ansambleve të Diasporës në Evente Kulturore në Kosovë:

- **Festivalet dhe Panairët e Diasporës:** Ansamblet kulturore dhe grupet artistike nga diaspora janë ftuar të marrin pjesë në festivale dhe aktivitete kulturore që organizohen në Vushtri, si pjesë e Diteve të Diasporës. Këto ngjarje janë mundësi për ansamblet e diasporës të prezantojnë artin dhe kulturën e tyre dhe të krijojnë lidhje më të ngushta me brezat e rinj të Kosovës. Ansambli "Shqiponjat" me seli në Gjermani.
- **Shkëmbimi i grupeve kulturore:** Një nga qëllimet ka qenë që grupet kulturore nga Vushtria të udhëtojnë në shtetet ku ka ansamble vushtrriase, duke organizuar shfaqje dhe aktivitete që promovojnë kulturën e Komunës. Ky lloj shkëmbimi ndihmon në rritjen e bashkëpunimit dhe krijimin e mundësive për projektet e përbashkëta, vlen të theksohet vizita në Selanik të Greqisë dhe Malmo të Suedisë.

Pjesëmarrja në Evente të Organizuar nga Ansamblet e Diasporës:

- **Festivale ndërkombëtare:** Pjesëmarrja e ansambleve dhe grupeve kulturore të Komunës së Vushtrrisë në festivale të organizuara nga diasporat shqiptare në Evropë (si Festivali i Diasporës në Suedi). Ky lloj bashkëpunimi krijon mundësi të shkëlqyera për promovimin e kulturës vushtrriase dhe për forcimin e identitetit shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Përpjekjet për Bashkëpunim me Ansamblet në Shtetet Jashtë Evropës

Përveç shteteve të Evropës, Drejtoria për Diasporë ka intensifikuar përpjekjet për lidhje me ansamblet kulturore dhe organizatat shqiptare në shtetet e tjera, si në SHBA. Ky bashkëpunim ka për qëllim:

- **Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe festivaleve** për të promovuar trashëgiminë kulturore të Komunës së Vushtrrisë.
- **Shkëmbimin e ideve dhe praktikave të mira** në organizimin e ngjarjeve kulturore dhe aktiviteteve që ndihmojnë në forcimin e lidhjeve midis Kosovës dhe diasporës, veçanërisht në këto shtete që kanë një prani të madhe të shqiptarëve.

Sfidat dhe Mundësitë e Bashkëpunimit

- **Mungesa e financimeve të mjaftueshme** për mbështetje të aktiviteteve kulturore dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.
- **Barierrat logjistike dhe administrative** për organizimin e aktiviteteve ndërkufitare.

- **Kërkesa për më shumë shkëmbime dhe prezantime të kulturës vushtrriase** jashtë vendit, veçanërisht në shtetet ku ka një numër të madh të diasporës shqiptare.

Vizita në Vaxjö, Suedi – Tetor 2024

Në tetor të vitit 2024, Drejtoria për Diasporë e Komunës së Vushtrrisë realizoi një vizitë të rëndësishme në Vaxjö, Suedi, me qëllim të forcohet lidhja me diasporën vushtrriase dhe për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, përfshirë ato kulturore, edukative dhe ekonomike. Vëxjö është një qytet me një komunitet të madh shqiptar dhe vushtrrias, dhe kjo vizitë kishte si objektiv promovimin e mundësive për zhvillim të përbashkët dhe nxitjen e aktiviteteve që mund të kontribuonin në forcimin e lidhjeve midis diasporës dhe atdheut.

Qëllimet e Vizitës

- **Forcimi i lidhjeve me diasporën vushtrriase** në Suedi, me fokus në promovimin e mundësive për zhvillim të përbashkët.
 - **Rritja e mundësive të bashkëpunimit ekonomik** dhe promovimi i mundësive për investime nga diaspora.
 - **Shkëmbimi i përvojave dhe projekteve kulturore dhe edukative** midis Komunës së Vushtrrisë dhe komunitetit shqiptar në Suedi.
 - **Promovimi i Komunës së Vushtrrisë dhe mundësive të zhvillimit të saj** përmes lidhjeve më të ngushta me diasporën dhe përfaqësuesit e institucioneve në Suedi.
 - **Eventi “Dimri në Shesh”**
 - Në vitin 2024, Drejtoria e Diasporës organizoi eventin **“Dimri në Shesh”**, një ngjarje festive dhe promocionale që synonte të promovonte traditat dimërore, si dhe mundësitë e zhvillimit të bizneseve lokale. Ky aktivitet u zhvillua gjatë muajve të dimrit, duke ofruar një platformë për biznese të ndryshme nga Komuna e Vushtrrisë për të shfaqur dhe shitur produktet e tyre në një ambient të jashtëm, në sheshin kryesor të qytetit.
 - **Qëllimi i Eventit dhe Organizimit të Shtepizave:**
 - **Mbështetje për bizneset lokale:** Bizneset e Vushtrrisë, veçanërisht ato që veprojnë në sektorët e ushqimit dhe pijes, patën mundësinë të ekspozojnë dhe shesin produktet e tyre përmes shtepizave të vendosura në shesh. Kjo ndihmoi në promovimin e tyre dhe ofroi mundësi për rritjen e shitjeve dhe angazhimin e klientëve të rinj.
 - **Promovimi i produkteve tradicionale dhe dimërore:** Bizneset që morën pjesë kishin mundësi të promovonin produkte të veçanta të sezonit, si ushqime tradicionale, pije të ngrohta, etj.
 - **Mënyra e Organizimit të Shtepizave:**
- Shtepizat ishin të hapura për një periudhë njëmuajore gjatë muajve të dimrit, duke u ofruar bizneseve një mundësi të shkëlqyer për të shfrytëzuar sezonin festiv dhe për të pasur vizitorë të shumtë.
- **Mbështetje e Drejtorisë për Diasporën dhe Komunën:** Drejtoria për Diasporën dhe Komuna e Vushtrrisë ofruan mbështetje logjistike dhe administrative për bizneset pjesëmarrëse, përfshirë sigurimin e hapësirave për shtepizat dhe ndihmën për organizimin e aktiviteteve të tjera mbështetëse.

- **Përfundimi i Eventit:**
- **"Dimri në Shesh"** rezultoi të ishte një mundësi e shkëlqyer për forcimin e bashkëpunimit midis bizneseve lokale dhe komunitetit, duke ofruar gjithashtu një mundësi për rritjen e njohjes dhe promovimin e traditave dhe produkteve lokale. Ky event ndihmoi në mbështetje të zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë dhe ofroi një platformë për bizneset që të shfaqin potencialin e tyre, duke sjellë gjithashtu një atmosferë festive për qytetarët dhe vizitorët.

Përmbledhje e Shkurtër për Veprimtarinë e Drejtorisë së Diasporës – 2024

Në qershor të vitit 2024, Drejtoria për Diasporë e Komunës së Vushtrrisë ka filluar të përmbushë misionin e saj për të forcuar lidhjet midis atdheut dhe diasporës, duke u angazhuar në aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës, arsimit, turizmit dhe ekonomisë. Puna e drejtorisë është fokusuar në mbështetje për komunitetin e diasporës, promovimin e mundësive për investime dhe organizimin e aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin ndërkulturor.

Aktivitetet Kryesore të Vitit 2024

- **Organizimi i Diteve të Diasporës (25-28 Korrik 2024):** Ky aktivitet ka pasur një pjesëmarrje të gjerë nga përfaqësues të diasporës, panairë të bizneseve dhe aktivitete që promovojnë mundësitë për zhvillim të përbashkët.
- **Vizita në Vaxjö, Suedi (Tetor 2024):** Drejtoria ka realizuar një vizitë të rëndësishme në Vaxjö, ku është forcuar lidhja me diasporën vushtrriase, janë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në sektorët e turizmit, arsimit dhe investimeve.
- **Organizimi i Eventit "Dimri në Shesh" (Dhjetor 2024):** Ky event ka promovuar mundësitë e turizmit dimëror në Komunën e Vushtrrisë, duke bashkuar bizneset lokale dhe vizitorët për të nxjerrë në pah potencialet natyrore dhe kulturore të Shishit.

Iniciativa për Bashkëpunim Ekonomik dhe Kulturor

Drejtorja ka zhvilluar kontakte të vazhdueshme me ansamblet kulturore, organizatat dhe bizneset e diasporës, për të mbështetur projekte që ndihmojnë në ruajtjen e identitetit kulturor dhe rritjen e mundësive të investimeve. Në këtë kuadër, janë zhvilluar takime dhe aktivitete që promovojnë mundësitë për zhvillim të përbashkët ekonomik dhe kulturor.

Përfundim

Viti 2024 ka qenë një vit me aktivitete për Drejtorinë e Diasporës, me fokus të veçantë në forcimin e lidhjeve me diasporën, promovimin e mundësive për investime dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe edukative. Angazhimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me përfaqësues të diasporës, si dhe mbështetje për bizneset lokale, ka ndihmuar në arritjen e qëllimeve të drejtorisë për vitin 2024 dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim.

Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjatë vitit 2024 fokus të posaçëm ka pasur fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024 pasi që të njetit i ka ska duar afati i paraparë ligjor si dhe ka lind nevoja për ndryshimin e PZHK-së. Ku kemi mbajtur disa takime si ekip komunale në konsultim me kompanin Konsulente e cila është kontraktuar nga komuna për mbeshtetjen në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032 përmes prokurimit publik me të

cilen edhe kemi filluar takimet për fillimin e databazes së këtij dokumenti i planifikimit PZHK-së se re 2024-2032.

Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e kanë përcjellë angazhime të shumta në shërbim të qytetarëve që kanë rezultuar me përfundimin dhe realizim e shumë projekteve kapitale përkatësisht ndërtimin e objekteve publike: shkollave, objekteve shëndetësore dhe projekteve tjera infrastrukturore.

-DUMM sa i përket planeve hapësinorë ka vetëm Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024 i aprovuar me vendim nr.01Nr.126/17 të dt.04.05.2017 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë për periudhën 2016-2024, i cili është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton çaqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshin planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare

Gjatë periudhës Janar –Djetor 2024, DUMM ka zbatuar në përpikëri Planin Zhvillimor Komunal ku zyrtaret përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranura që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunalë (PZHK-lë) 2016-2024.

Zyra për çështje ligjore Jap udhëzime-këshilla profesionale nga aspekti ligjor për drejtorinë, janë këshilluar bashkëpunëtorët lidhur me legjislacionin në fushveprimtarinë e kësaj drejtorie.

Pjesë e hartimit të rregulloreve Komunale, vendime ,udhëzime dhe prpopozim-vendime për Kuvendin Komunal , dhe akte tjera juridike konform ligjeve dhe akteve tjera normative .

Anëtare në komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e raportit të LMK-së.

Ju është kthyer përgjigjeje në shkresat e parashtruara nga institucionet dhe palët brenda afatit të paraparë ligjor.

Pjesëmarrja ne konferenca te organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, kur është kërkuar kemi mbajtur edhe konsultime të rregullta me zyrtaret e kesaj drejtorie , propozimet e ndryshme përlegjislacionin si dhe takimet e rregullta me nivelin qendror rreth legjeslacoionit e cila ka të bëjë me fushën e ndërtimit , planifikimit, mbrojtjes së mjedisit, legalizimit (trajtimin të ndërtimeve pa leje) , sisitemit të adresave .

Si dhe rritja e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtorit tjera për qëllim të rritjes së profesionalizimit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta në dobi të Komunës së Vushtrrisë.

Sektori i Urbanizmit –gjatë periudhës janar-dhjetor për vitin 2021 është marr me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me caktim të lokacioneve, Kushtet e Ndërtimit, Lejeve Ndërtimore për kategorinë I dhe II, Pëlqimeve Paraprake, Lejeve për rrënimin e objekteve, Leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese duke kaluar nëpërmes procesit të daljes në teren dhe incizimit të gjendjes faktike ne terren ku përmes sektorit për planifikim urban e ka vazhduar procesin e mëtutjeshëm për finalizim si dhe punë të tjera në komisione siç janë: Shfrytëzime të hapësirave publike para lokaleve etj.

Legalizimi- Gjatë këtij viti kemi pranuar 112 kërkesa të parashtruara nga palët për legalizimin e objekteve për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimit,

Duke parë volumin e madh të punëve në drejtori si dhe mungesën e stafit, shpresojmë që ta rrisim stafin e kësaj drejtorie.

Pranimi i kërkesave për legalizim regjistrimi sistemimi, shqyrtimi i kërkesave përgatitja e faturave ,vendimmarrja , dërgimi i lëndëve në Kadastwr pwr regjistrimin e objekteve të legalizuara ne RDPP.

- Vendime për legalizim.....42
- Informim për taksë Fatura..... 51

- Plotësim dokumentacioni.....45
- Dërgesë dokumentacioni – dorëzim palës..... 48
- Dërgimi i dosjeve të legalizimit në Kadastër.....58
- Kërkesat e reja të pranuar për legalizim.....50

Taksat e inkuara për Legalizimin e objekteve pa leje përfshinë vlerën: 9,430.28€

Lejet ndërtimore:

Janë lëshuar 13 Leje të kategorisë së II-të si dhe janë lëshuar 17 leje ndërtimore të kategorisë së I-rë

- Çertifikata që posedon Leje Ndërtimore 4 ;
- Leje rrenimi 6;

Taksat e inkuara për Leje Ndërtimore dhe Leje rrenimi përfshinë vlerën: 754,492.01€

Sistemi i Adresave- Republika e Kosovës e cila është në tranzicion, gjithnjë është në hulumtim të mundësive më të mira për zbatimin e projekteve të rëndësishme të madhe për lehtësimin e jetesës së qytetarëve dhe për zhvillimin e bizneseve në tërësi kështu që Bashkësia Evropiane ka krijuar një qasje të veçantë financiare për krijimin e sistemit të adresave në Kosovë. Ky projekt u zbatua nëpërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe mirëmbahet në mënyrë sistematike nga zyra urbanistike e komunës. Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit uniform të adresave është një nga shërbimet më të rëndësishme që pushteti vendor dhe qendror i siguron qytetarëve të Kosovës. Sistemi unik, i saktë dhe i qëndrueshëm i adresave i bën qytetarët më të përgjegjshëm për zbatimin e ligjit, e përmirëson shërbimin ndaj qytetarëve në shërbimet publike e private por edhe në raste emergjencash të operojnë efektivisht.

Spektori për planifikim urban – gjatë kësaj periudhe një vjeçare është bërë sistematizimi i lendeve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, zgjidhje dhe përgjigje të kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në teren-mbikqyrja e projekteve, monitorimi dhe aprovimi për Kushte dhe leje Ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, Takimet me grupet punuese dhe UN-Habitatin .

Gjatë kësaj periudhe sektori për planifikim ka kryer këto punë:

Ka bërë kordinim profesional dhe ligjor brenda drejtoris.

Kordinimi lidhur me hartimin e PZHK

Ka bërë kordinim me Drejtorin e Kadastrit dhe të tjera.

Kemi bërë detyra projektuse për hartimin e projekteve të ndryshme.

Kemi bërë skica për disa projekte ma specifike.

Kemi kryer punë sipas Vendimeve të Drejtorit dhe Kryetarit.

Takime me Kompanin Konsulente e cila është duke na mbështetur për hartimin e PZhK 2024-2032.

Sa i përket Investimeve kapitale, jemi duke i realizuar punimet sipas projekteve të parapara për realizim

- Asfaltimi i rrugëve në qytet;
- Asfaltimi i rrugëve në fshatra;
- Rikonstruimi i Sheshit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit;
- Asfaltimi i rrugës Drenica;
- Asfaltimi i rrugës Bekim Berisha Abeja;

-Asfaltimi i rrugës Lumni Surdullj;

Spektori për mbrojtje të mjedisit-

Bazuar në Planin e punës e cila ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, ju njoftojmë se bazuar në investimet kapitale për këtë vit komuna ka realizuar projektet që ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit siç janë projekte për gjelbërim, pastrimi i rrugëve, mbikëqyrja dhe përkujdesja e parqeve në pjesë të ndryshme të qytetit ku janë të përfshira edhe sektorët nga Drejtoritë përkatëse siç është Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Gjendja e Mjedisit është përmirësuar dukshëm, duke filluar nga menaxhimi i mbeturinave ku kompania për menaxhimin e mbeturinave ka bërë shtrirje të menaxhimit në tërë territorin e komunës.

Reforma për menaxhim të mbeturinave është duke vazhduar, grumbullimi i mbeturinave dhe transporti i tyre në deponi bëhet vazhdimisht.

Vetëm në vitin 2024 është bërë mbjellja e 900 drunjëve dekorativ.

Po ashtu janë kryer edhe pune tjera të ndryshme që kanë qene të nevojshme për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtës së Mjedisit si:

- Menaxhimi i kontratës për mbjelljen e drunjëve dekorativ
- Përgatitja e dokumenteve për Planin Zhvillimor Komunal nga sektori për Mbrojtjen e Mjedisit,

Komision vlerësimi për verifikim të dëmtimit të drunjëve dekorativ

Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale kemi shqyrtuar kërkesa të palëve kemi lëshuar tetë (13) Leje Mjedisore Komunale .

Taksat e inkasuara për Leje Mjedisore Komunale përfshinë vlerën: 90,092.55€

Përfundim

Drejtoria ballafaqohet me një numër mjaft të vogël të stafit e cila e bënë të pamundur zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësive përkatësisht në sektorin e Urbanizmit.

DUMM gjatë punës në këtë vit ka qenë i ngarkuar me mjaftë punë të cilat besojmë që i kemi kryer me sukses, edhe për kunder numrit shumë të vogël të stafit që ka pas kjo drejtori.

Kulturë Rini Sport

Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport veprojnë sektorë të ndryshëm, andaj edhe raporti i punës së kësaj drejtorie paraqitet sipas sektorëve. Sa i përket mbarëvajtjes së punëve në këtë periudhë kohore, jemi munduar që të bëjmë më së miri punën që është kërkuar nga ana jonë. Në vazhdim paraqesim të dhëna mbi punën vjetore sipas sektorëve të DKRS-së:

OK "Hasan Prishtina"

Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina" funksionon në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në kuadër të objektit të Qendrës së Kulturës funksionojnë këto institucione: Zyra e drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, zyra e Drejtoreshës për Diasporë, Biblioteka "Naim Frashëri", Arkivi i qytetit, Teatri i Qytetit "Adem Mikullovc", Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Hasan Prishtina", Organizata e Veteranëve të Arsimit "Hasan Prishtina" si dhe veprimtarinë e ushtron balerina e baletit Kombëtar të Kosovës, e cila funksionon në bazë të marrëveshjes mes Komunës së Vushtrrisë dhe Baletit Kombëtar, ku ushtrojnë fëmijët e qytetit tonë. Gjithashtu në objekt kemi edhe Galerinë e arteve si dhe atelienë, por që nuk kanë staf të angazhuar zyrtar nga komuna, si dhe zyra e rekrutimit e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Personelit.

Në kuadër të stafit të Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina”, kemi këtë përbërje: Drejtori i Qendrës për Kulturë, udhëheqësi i AKV-së (instrumentist), Koreografi i AKV-së (i pensionuar gjatë këtij viti 24 maj 2024), tre instrumentistë dhe dy punëtorë teknikë, por edhe një konsulent për kulturë, i cili ka filluar angazhimin e tij në fund të vitit 2024, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, por edhe tre punëtorë të mirëmbajtjes të cilët janë pjesë e Ndërmarrjes “Përparimi”.

Stafi i Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina” gjatë këtij viti ka mbështetur apo ka organizuar të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme, në të cilat është kërkuar ndihma jonë, qoftë nga organizatat rinore, grupet e intelektualëve apo shkollat e komunës së Vushtrrisë. Ne, në vazhdimësi kemi mbështetur, por edhe kemi marrë pjesë në organizimin e shumë takimeve letrare, si promovime të librave në territorin e komunës sonë, kryesisht të autorëve vushtrrias. Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre, në Galerinë e Arteve në Qendrën e Kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e Qytetit “Adem Mikullovcit”. Një punëtor i QK “Hasan Prishtina” mban në vazhdimësi të hapur dhe përkujdeset për Kalanë e Qytetit. Vlen të përmendet se në këtë vit kemi qenë të angazhuar edhe në organizimin e disa akademive përkujtimore, për nder të disa personaliteteve të rëndësishme nga Vushtrria.

Në aktivitetet e zakonshme që i organizojmë si drejtori, por edhe aktivitet tjera të organizuara qoftë nga Kryetari i Komunës, Drejtorja e Arsimit, Drejtorja e Diasporës apo edhe sektorët e tjerë përbrenda DKRS-së ne kemi qenë të angazhuar në mbarëvajtjen e atyre organizimeve, qoftë në mbështetje teknike me mjete të zërimit apo edhe mjete tjera teknike.

Ndër aktivitetet kulturore që janë organizuar nga Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, ku kemi marrë pjesë në organizim apo kemi qenë organizatorë të aktiviteteve veçojmë:

Organizimi i ceremonisë për shpalljen e Sportistëve të vitit 2023;

Akademi përkujtimore dhe zbulimi i lapidarit për dëshmorin e kombit Mehdi Haziri;

Mbështetja në organizimin e Akademisë për Mehmet Konjuhin;

Përgatitja e kushteve në Qendrën e Kulturës për shfaqje nga Teatri i Mitrovicës (pasi që objekti i teatrit në Mitrovicë ishte në rinovim);

Akademi Solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;

Ekspozitë e piktorit vushtrrias Ismet Bylykëmini;

Përrurimi i librit “Rrezet e lirisë”, i autorit Gani Lahu;

Organizimi i aktiviteteve për Epopenë e UÇK-së “Nata e zjarreve” me ushtarë të UÇK-së në fshatin Stroc;

Përgatitja e kushteve për organizimin e “Ditës së Mësuesit”;

Përrurimi i librit “Aventurat në Mbretërinë Magjike” i autores vushtrriase Alejna Selimi;

Aktivitet me fëmijët me Sindrom Doën mbështetur nga Instituti Younus Emre;

Aktivitet i organizuar nga komuniteti turk dhe i mbështetur nga ana jonë;

Organizimi i një koncerti në Selanik të Greqisë, në bashkëpunim me shoqatën “Jeta” në Greqi;

Akademi përkujtimore dhe film dokumentar për dëshmorin Shemsi Istrefi;

Është shpallur konkursi për pranimin e poezive për Festivalin “Takimet e Poeteshave Shqiptare”, janë pranuar poezitë dhe jemi në fazën përgatitore për organizimin e festivalit;

Koncert i përbashkët me austriakë, organizuar përmes mërgimtarëve shqiptarë në Austri;

Përgatitja e kushteve për ceremoninë e nënshkrimit të Kontratës Sociale, organizuar nga USAID;

Akademi Përkujtimore “Studimja '99”;

Akademi Përkujtimore për nder të përkujtimit të masakrës së 22 Majit në Vushtrri;

Akademi Përkujtimore për Masakrën mbi Familjes Gërzhaliu;

Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të Ditës së Fëmijëve - 1 Qershori 2022;

Përrurimi i librit “ Monografi për Tafil Morinës”, i autorit Halil Mulaku;

Akademi Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë – 17 qershor 2022;

Ceremonia e diplomimit të gjimnazistëve vushtrrias;

Mbështetje në organizimin e 112 - vjetorit të ngritjes së flamurit në Vesekoc dhe Kuvendit të Kurillovës;

Më 15 dhe 16 korrik 2024, me rastin e 100 vjetorit të rezistencës në Arbërinë e Vogël, janë mbajtur aktivitete të ndryshme.

Organizimi i Manifestimit “Ditët e Diasporës”, në bashkëpunim me Drejtorinë për Diasporë; Aktivitet me mërgimtarë në fshatin Skromë;

Përfundimi i librit “Harrova të jetoj”, të autores Ymrije Beqiri.

Tryezë me temën: “Mërgata - dje, sot dhe nesër”

I Shtatori – Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vushtrrisë;

Përfundimi i librit “Bunjakët nëpër shekuj” të autorit Jakup Krasniqi;

Përfundimi i librit “Sad Nallbani”, të autores Sevëme Fetiçi;

Përfundimi i librit “Musli Melenica” – Shënime, përjetime, kujtime, dokumente;

Organizimi i Edicionit të 42-të të Festivalit “Takimet e Poeteshave Shqiptare”;

Kolonia e artistëve e mbështetur nga DKRS-ja;

Ekspozita “Art dhe trashëgimi”;

Akademi Solemne për 28 Nëntorin - Ditën e Flamurit;

Akademi përkujtimore në nderim të veteranit të luftës - Major Milaim Fejzullahut, me rastin e zbulimit të lapidarit.

BIBLIOTEKA “NAIM FRASHËRI”

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, në sektorin e bibliotekës komunale “Naim Frashëri” Vushtrri, janë realizuar detyra dhe aktiviteteve të punës që lidhen me sektorin e bibliotekës.

U organizuan edhe një mori aktivitete, si Akademi të ndryshme ku kontribuoi edhe sektori i bibliotekës duke ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Në sektorin e bibliotekës kishte edhe vizita nga delegacionet e ndryshme, vizita të nxënësve të shkollave të komunës sonë. Po ashtu, sektorin e bibliotekës së qytetit “Naim Frashëri” e vizituan edhe dhurues të shumtë të librave, cilët e pasuruan bibliotekën tonë me libra të ndryshëm. Sektori i bibliotekës komunale “Naim Frashëri” në Vushtrri, frekuentohet shumë nga studentë, nxënës dhe qytetarë të cilët e shfrytëzojnë sallën e leximit e cila posedon kushte shumë të mira për studim dhe hulumtim. Salla është e hapur për lexues nga ora 8:15 deri në orën 17:45 nga e hëna deri të premten. Po ashtu salla posedon edhe Këndin Arkivor, ku studentët mund të marrin të dhëna për hulumtime nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave – Republika e Shqipërisë.

Aktivitetet në sektorin e bibliotekës komunale “Naim Frashëri” Vushtrri, për periudhën janar – dhjetor 2024:

Sektori i bibliotekës për periudhën janar-dhjetor 2024, ka evidentuar këto aktivitete:

Librat më të kërkuara për lexim gjatë kësaj periudhe:

Sektori për fëmijë: “Verorja”, autor Rexhep Hoxha

Sektori për të rritur: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, i autorit Ismail Kadare

Libri shkencor i kërkuar gjatë kësaj periudhe: “Viciana – Vushtrria I”, autor Izet Miftari;

Aktivitetet e punës në sektorin e bibliotekës së qytetit: “Naim Frashëri” Vushtrri:

- Libra të përpunuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2024

Përpunuar	1898
Vulosje	6259
Signim	2583
Vendosje e tiketave	1853

Inventarizim	2886
Regjistrim në kompjuter	1543

Libra të huazuara në sektorin e fëmijëve	5322
Libra të huazuara në sektorin e të rriturve	3746
Sallën e leximit e shfrytëzuan	1008
Lexues të ri të regjistruar gjithsej	191

Biblioteka komunale "Naim Frashëri" Vushtrri, gjatë periudhës janar-dhjetor ka qenë e përfshirë në të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga DKRS-ja.

Gjatë vitit 2024 janë dhuruar gjithsej 4646 libra.

Vizitat e delegacioneve të ndryshme dhe nxënësve të shkollave të komunës sonë në bibliotekën e qytetit,

Bibliotekën e qytetit gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 e vizituan personalitete të ndryshme, si, poet, intelektual, mërgimtar, publicist, veteran të arsimit, drejtor të institucioneve, të bizneseve, qytetar dhe nxënës të shkollave, vlen të theksohet vizita e delegacionit nga Suedia, nga Gjermania dhe nga Greqia;

Gjatë vitit në bibliotekën e qytetit janë realizuar vizita pothuajse nga të gjitha shkollat e qytetit por edhe të fshatrave.

MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

Në kuadër të punëve hulumtuese në terren janë vizituar shtëpi e familje nga Komuna e Vushtrrisë, duke identifikuar ekspozate të ndryshme nga fusha e etnologjisë, folklorit, teknologjisë dhe arkeologjisë.

Si rezultat i punës në terren të stafit të muzeut në hulumtimin e trashëgimisë materiale të luajtshme dhe shpirtërore, gjatë vitit 2024, muzeu u pasurua me 18 ekspozate etnologjike, 9 ekspozate arkeologjike, 8 (tetë) vepra arti (piktura të punuara në materiale të ndryshme).

Muzeu- sektori i fototekës u pasurua me 77 fotografi të vjetra familjare të Vushtrrisë, të realizuara kryesisht në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX. Si dhe me 15 fotografi nga historia dhe ngjarjet e zhvilluara në fshatrat dhe malet e Komunës së Vushtrrisë gjatë "Luftës së Fundit të vitit 1998-1999".

Në kuadër të bibliotekës është punuar me studentë dhe lexues, duke iu ofruar shënime dhe literaturë shkencore në realizimin e detyrave dhe punimeve shkencore.

- Në muze u inventarizuan gjithsejtë 122 ekspozate nga kultura materiale:
 - 73 - nga fusha e etnologjisë;
 - 31 - nga fusha e arkeologjisë;
 - 18 - nga fusha e teknologjisë.

Gjatë vitit 2024 muzeu organizoi aktivitete të cilat qëllimin kryesor kishin promovimin, edukimin dhe vetëdijesimin e gjeneratave të reja përmes komunikimit muzeor.

Disa nga aktivitetet e realizuara janë:

- Vizita në shkollat e zonave rurale të Komunës së Vushtrrisë për qëllim të hulumtimit të pasurive muzeore, por edhe për të ligjëruar në kuadër të procesit mësimor tek lënda shoqëria dhe mjedisi.

- Rëndësi të veçantë i është kushtuar pritjes të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në realizimin e vizitave edukative e mësimore në Muzeun e Vushtrrisë / në monumentin “Mahmut agë Gjinolli”, si dhe në monumentet e trashëgimisë kulturore në Vushtri.
- Disa nga aktivitetet e organizuara për të shënuar datat e rëndësishme kulturore janë:
 - Përvjetori i 19-të i themelimit të Muzeut të Vushtrrisë;
 - Dita Ndërkombëtare e Muzeve;
 - Dita Ndërkombëtare e Trashëgimisë Kulturore;
 - 1 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve;
 - Dita e Evropës;
 - Dita Ndërkombëtare të Arkeologjisë.

Në ambientet e Muzeut të Vushtrrisë janë realizuar edhe aktivitete të pikturimit me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Vushtrrisë. Aktivitetet janë zhvilluar në bashkëpunim me piktoresh Fjolla Ferati si një mundësi mësimi për të pikturuar, por edhe për qëllim të promovimit të vlerave kulturore dhe muzeut, i cili më pastaj u kurorëzua me një ekspozitë të organizuar për nder të festës së “28 Nëntorit”.

Muzeu i Vushtrrisë së bashku me fëmijët e ‘Qendrës Edukative Dua’ ka zhvilluar aktivitete festive për nder të festës së “28 Nëntorit”. Aktivitetet u zhvilluan me vizitë në Muzeun e Vushtrrisë, duke vazhduar me valle dhe këngë kushtuar festës së ‘28 Nëntorit’.

Edhe gjatë muajve të fundit të vitit muzeu priti nxënës e mësimdhënës nga Komuna e Vushtrrisë dhe komuna të tjera, të cilët përpos që mësuuan për pasuritë e muzeut, gjithashtu mësuuan edhe për trashëgiminë kulturore, kulturën shpirtërore, mjeshhtëritë dhe artizanatet e vendit të tyre.

Gjithashtu, stafi i muzeut ishte pjesë edhe e aktiviteteve të shumta kalendarike të organizuara në kuadër të DKRS-së.

SEKTORI I RINISË

Përgatitja e planit të punës për sektorin e Rinisë për vitin 2024.

Së bashku me Qendrën Rinore, bordin e KVRL-së dhe grupet joformale u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2024, po ashtu u bë edhe ristrukturimi i këtij këshilli.

Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ-ve rinore gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dhe janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE, ku janë plotësuar disa pyetësor që janë dërguar nga ta edhe njëherë OSCE ka shpreh gatishmëri që të bashkëpunojë në aktivitete të ndryshme në fushat të cilat mund të na ndihmojë OSCE-ja.

Qendra Rinore “Hareja” ka mbajtur trajnime për Rrobaqepësi dhe Modë për të gra dhe vajza të grup moshave të ndryshme, në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrësve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve.

Janë njoftuar të gjitha OJQ-të rinore, KVRL-ja, Qendra Rinore si dhe grupet jo formale të të rinjve për thirrjen publike për mbështetje financiare nga Komuna, po ashtu janë njoftuar edhe për thirrjet nga MKRS-ja, njëherësh do tu ofrohet mbështetje aq sa do të jetë e mundur në kapacitetet tona. Në këto takime u planifikua për projektet që parashihet të organizoj KVRL, po ashtu diskutua për sfidat dhe problemet që ka KVRL e një ndër to edhe hapja e llogaris nga KVRL si dhe çështje të ndryshme rreth KVRL-së.

Organizata Rinore “Access” në bashkëpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Takim me përfaqësuesin e OJQ “Lëvizja Koha” me të u diskutua për projektet që parashihet të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje në fonde të donator të ndryshëm.

Është realizuar projekti “Komuna për të Rinjtë” ky projekt është realizuar nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore si dhe organizatës facilituese CDF. Ky projekt ka pasur një ndikim të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shuma totale për mbështetjen e të rinjve në total ka arritur vlerën 250,000.00 dollar amerikan.

Organizata Rinore “Access” në bashkëpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, meqë rast edhe është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Janë mbajtur trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore “Hareja” e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar.

SEKTORI I SPORTIT

Është organizua turneu në basketboll(Streetball).

Ekipet pjesëmarrëse kanë qenë katër (4).

Arsyeja e turneut ishte organizimi i ditëve të diasporës.

Është organizuar turneu memorial “Jeton Tërstena – TOTA”, ku pjesëmarrëse në këtë turne ishte edhe ekipi nga Qipro KKTC Hendboll, po ashtu turneun e nderuan me pjesëmarrje edhe ekipet më të mira të Kosovës si Besa Famgas nga Peja dhe Vjosa nga Komuna e Shtimes.

RAPORTE NGA SUKSESET

Sukseset e klubeve të Vushtrrisë për edicionin garues 2023/2024.

Në komunën tonë janë të regjistruara (33 klube, shoqata).

Klubet seniore

1.KLUBI FUTBOLLIT “VUSHTRRIA “ në bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Komunës ka bërë një organizim shumë të mirë që të bëhet anëtar i super ligës për sezonin e ardhshëm.

2. KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka arritur që të jetë në super ligën e Hendbollit Kosovar, edicionin e ri garues do të jetë pjesëmarrëse edhe në garat ndërkombëtare.

3.KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA”(F) ka arritur që të jetë një ndër ekipet me të mira në super ligen e Hendbollit Kosovar ka arritur që të jetë në gjysmë finale të Kupës së Kosovës.

4.KLUBI HENBOLLIT “ SAMADREXHA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë.

5. KLUBI HENBOLLIT “ SAMADREXHA” (F) ka garuar në super ligë, dhe ka ruajtur statutin e Superliges, dhe me rezultatet e treguara ka arritur që të jetë pjesëmarrëse në garat ndërkombëtare.

6. KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë duke u renditur e dytë (2).

7. KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA BASKET” (F) ka garuar në Ligën e Parë dhe ka arritur që të jetë në vendin e tretë.

8.KLUBI VOLEJBOLLIT “ASVUSHTRRIA” (M) ka garuar në Super ligë, dhe ka ruajtur statutin e Super ligës,

9. KLUBI VOLEJBOLLIT “AS VUSHTRRIA” (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arritur që të jetë në vendin e parë në Ligen e Parë Lindje.

10 . KLUBI VOLEJBOLLIT “VUSHTRRIA” (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arritur që të jetë në vendin e parë dhe të bëhet pjesë e ekipeve të superligës së Kosovës në Volejball

11. KLUBI I FUTSALLIT FC “VUSHTRRIA” ka garuar në Ligën e parë, dhe ka arritur që të ruaj statutin në ligën e parë duke u renditur e dyta (2) në edicionin garues 2022/2023.

Klubet e kategorive të reja

1. KLUBI FUTBOLLIT “VUSHTRRIA “ Kampion U 18 , Liga Regjionale.
2. KLUBI FUTBOLLIT “VUSHTRRIA” Kampion U 17 , Liga Regjionale.
3. KLUBI FUTBOLLIT “EL CLASICO “ Fitues I Kupes U 17 , Liga Regjionale .
4. KLUBI FUTBOLLIT “FORCA “ Vendi I Dytë (2) , Liga Regjionale.
5. KLUBI VOLEJBOLLIT “AS VUSHTRRIA “ Finalist , U 18 , U 16
VUSHTRRIA “Finalist , U 18 , U 1.

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik është institucion i cili pranon , evidencon, rregullon dhe publikon lëndën arkivore, mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat civil-juridik. Arkivi kryen veprimtarinë në përputhje me ligjin dhe aktet e përgjithshme juridike, ky institucion punët i kryen nëpërmjet këtyre shërbimeve:

- Shërbimi për mbrojtjen e lëndës arkivore brenda dhe jashtë arkivit
- Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale
- Evidentimi , rregullimi dhe klasifikimi i dokumenteve arkivore brenda arkivit
- Aktivitete tjera në kuadër të DKRS-së
- Punët e depos, mirëmbajtja, renditja si dhe mbikëqyrja e dokumentacionit
- Punët e udhëheqjes në arkiv
- Aftësimi profesional i punëtorëve

Shërbimi për mbrojtjen e dokumenteve arkivore jashtë arkivit	<ul style="list-style-type: none">• Në periudhën Janar- dhjetor 2024 kemi bashkëpunuar me Kuvendin Komunal Vushtrri , konkretisht me Drejtorinë e Administratës e cila ka përgjegjësin e dokumentacionit i cili gjendet në depon e Komunës . Materiali i cili ka qenë në depon e Komunës nuk ka qenë në gjendje të rregullt për shkak të kushteve minimale. Arkivi së bashku me Drejtorinë komunale ka inspektuar materialin arkivor në depon e arkivit të brendshëm në Komunë, u konstatua se ky material duhet të zhvendoset në Arkivin e qytetit.
Pranimi i lëndës arkivore	<ul style="list-style-type: none">• Gjatë vitit 2024 kemi pranuar material nga Drejtoria e Administratës , librat e regjistrit për fshatrat dhe qytetin të cilat janë rregulluar në formë të regjistrit arkivor, të cilat janë dorëzuar në arkiv.
Evidentimi rregullimi dhe klasifikimi dokumenteve arkivore	<ul style="list-style-type: none">• Mungesa e rafteve paraqet problemin kryesor për sistemimin e lëndës arkivore e cila nuk është në gjendje të mirë.• Materialin e Administratës është rregulluar dhe sistemuar nga zyrtarët e administratës në bashkëpunim me Arkivin.
	<ul style="list-style-type: none">• Si njësi arkivore dhe si staf zyrtar kemi bashkëpunuar me DKRS dhe fushat tjera të Kuvendit komunal Vushtrri.• Angazhimi në komisione për vlerësim të ofertave të prokurimit, rekrutimit të zyrtarëve komunal si dhe angazhimi për menaxhimin e kontratave për projektet në kuadër të DKRS-së,• Në muajin maj një delegacion nga Komuna e Vaxjo ka qenë në Komunën e Vushtrrisë, konkretisht vizita kishte të bënte me

Aktivitetet tjera	<p>Arkivin dhe lëndën arkivore. Gjatë vizitës së tyre kemi prezantuar gjendjen faktike në Arkivin e Vushtrrisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në kuadër të bashkëpunimit të Komunës së Vushtrrisë me qytetin e Vaxjo-Suedi kemi zhvilluar vizitën në muajin shtator për të bartur përvojat administrative dhe arkivore në mënyrë reciproke. • Nga përvojat e fituara në vizitën e fundit në Suedi kemi promovuar rezultate pozitive. Në kuadër të obligimeve që kemi marrë si zyrtar të Komunës së Vushtrrisë jemi angazhuar për krijimin e një rregullore për krijimin e aktit të brendshëm administrative i cili ka përfunduar në muajin dhjetor .
Punët e udhëheqjes në Arkiv	<ul style="list-style-type: none"> • Arkivi Historik i qytetit menaxhohet nga udhëheqësi dhe stafi i Arkivit në bashkëpunim me DKRS-Vushtrri. • Në arkivin e qytetit janë gjatë vitit 2024 janë rekrutuar dy zyrtar - Arkivist. Në muajin maj ka filluar punën si arkivist Bashkim Sadiku, ndërsa pozita tjetër është plotësuar në muajin dhjetor, por ende nuk ka filluar punën.
Aftësimi profesional i punëtorëve	<ul style="list-style-type: none"> • Gjatë këtij viti të punës sa përket aftësimin profesional nuk ka pasur trajnime në drejtim të lëndës së Arkivistikës si lëmi përkatëse për arkiv.

TRASHËGIMI KULTURORE

Gjatë muajit janar më shumë kemi kryer disa çështje administrative si; komision për vlerësime të ofertave në prokurim, disa komisione të brendshme në DKRS, etj. Në muajin shkurt, isha pjesë e Këshillit organizues për 17 Shkurtin Ditën e Pavarësisë. Më saktësisht kemi organizuar turneun në Futsall, ku ishin prezent mbi 40 ekipe vendore, por edhe nga Shkupi, Kumanova, etj. Turneu ishte për nder të heroit Afrim Bunjaku.

Me datën 27 shkurt, një delegacion nga Universiteti i Tubingenit të Gjermanisë të cilin e kryesonte Prof. Dr. Harald Floss i shoqëruar nga arkeologu Luan Gashi nga Instituti Arkeologjik i Kosovës ishim në teren. Në fshatin Samadrexhë te lokaliteti “Gomure” e që është hera e dytë me profesor Flossin dhe hera e tretë me IAK që hulumtojmë në atë lokalitet për gjetje artefaktesh që i takojnë periudhës Paleolitike. Dhe në bazë të gjetjeve materiale në atë lokalitet, ka shumë shpresë që artefaktet i takojnë periudhës së paleolitit. Përveç fshatit Samadrexhë, ne ishim edhe në fshatin Stroc. Aty profesor Floss për njohu dy shpella. Njëra s’kishte të bënte me arkeologji, por tha se është shpellë interesante që deri më sot nuk kishte hasur në diçka të ngjashme dhe i takon gjeologëve që të hulumtojnë tutje. Kurse te shpella “Guri I kishës” profesor Floss bashkë me studentet e tij nga Universiteti i Tubingenit, vërejtën disa vizatime primitive e që sipas tyre janë prehistorike, edhe pse, lokaliteti “Gjyteti i Strocit” njihet për periudhën romake, ajo shpellë ka të bëjë me para historinë e që në kontinuitet është përdorur.

Nga objekti i Shtëpisë së Kulturës ku isha për disa vite, kam kaluar ne objektin e Muzeut te qytetit “Shtëpinë e Mahmut Agë Gjinollit” Po ashtu kemi bashkëpunuar me QRTK-Mitrovicë, rreth futjes nën mbrojtje të dy shtëpive; “Kahriman Pasomës” në Vushtrri dhe “Selatin Gerxhaliut” në fshatin Studime e Ulet. Ishim ne trajnim për prokurim për tre dite radhazi në Durrës, ku mësuam për çështje të menaxhimit të kontratave. Tash, veç jam përzgjedhur menaxher i një kontrate, atë për renovimin dhe restaurimin e objektit “te Ish Arkivit”, ku punimet do të fillojnë ne fund te muajit korrik 2024. Punimet në këtë objekt kanë ecur me ritëm te shpejtë dhe punët janë duke u kryer sipas planit dinamik. Bashkë me menaxherët teknik dhe monitoruesit nga QRTK-Mitrovicë, e kemi përcjell çdo punë të kryer. Tash pasi jam vendosur me zyre në objektin e muzeut, kam filluar të merrem me inventarizimin e artefakteve arkeologjike të cilat janë gjetur nëpër territorin e Vushtrrisë. Tash së fundi jam menaxher edhe i një kontrate tjetër, asaj për “renovimin e memorialëve dhe varrezave”,

ku operatori veç ka filluar në një rën nga memorialët të rinovoj, atë Gllavatin. Kemi kryer edhe punë të tjera që i përkasin DKRS-së, ose kemi asistuar në to.

TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Në muajin janar ishte filluar me projektin nëpër shkolla me temë "Teatri, rinia dhe edukimi". Në teatrin e qytetit në Vushtrri janë mabjtur ligjëratat me të rinjtë me temën në fjalë. Interesimi i të rinjve ishte shumë në nivel, ku u informuan për ecurinë e punës se si realizohet një shfaqje. Nga ana teorike interesimi i të rinjve ishte loja. Në vazhdim ata për formuan në skenën e teatrit duke marrur sugjerime nga aktori. Nga ana diksionale të rinjtë mësuuan se si duhet të artikulohet fjalia duke e kuptuar se çfarë thotë aktori në skenë. Të rinjtë pasi morën disa detyra ushtrime arritën ta kuptojnë se si koordinohet loja skenike me tekst. U ndan të kënaqur me punën dhe angazhimin dhe do të vazhdojnë të jenë prapë në teatër.

Në bazë të kalendarit vjetor të aktiviteteve të Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport po vazhdon vizita në shkolla nga Teatri i Qytetit "Adem Mikullovci". Ky aktivitet ofron një platformë për shfaqjen e aftësive artistike të nxënësve, duke përfshirë aktrimin, regjinë dhe skenografinë. Për më tepër, kjo ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit dhe aftësive të komunikimit të nxënësve, duke i përgatitur ata për të ardhmen.

Më 15 korrik dhe 16 korrik 2024, në kuadër të manifestimit 100 vjetori të rezistencës së Azem dhe Shote Galicës, Teatri i qytetit ishte në të gjitha organizimet e këtij manifestimi.

Tani në teatrin e të rinjve vazhdon përgatitja për realizimin e komedisë "Burri Burrë", tekst i Kristo Floqit, që presim që në muajin nëntor të jete si premier.

Në muajin gusht kemi filluar provat për përgatitjen e përvjetorit të 1 shtatorit "Ditës së dëshmorëve", ku, si teatër kanë marrë përsipër një recital skenik dhe poezi për nder të kësaj dite. Gjithashtu, teatri u angazhua me program artistik si dhe në realizimin e pjesës që është përgatitur për atë ditë xhirim .

Inspektimet

Drejtorja Për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë gjatë kësaj periudhe kohore me rastin e ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse, aktivitetet inspektuese i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira operatorëve ekonomik në aplikimin e dispozitave ligjore dhe ushtrimin e veprimtarive .

Në kuadër të Drejtorisë për Inspektime veprojnë Inspektorë të fushave të ndryshme, andaj raportin vjetor të punës po e paraqesim në mënyrë të detajuar për secilin sektor janë paraqitur aktivitetet sipas fushave të bazuar në planin e punës për vitin 2024. Inspektori i Tregut paraqet këtë:

Inspektorati i tregut

- Gjatë kësaj periudhe aktivitetet e veta i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera nënligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira në aplikimin e dispozitave ligjore.

	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	NR/SASIA	VLERA NË €
1	PROCES VERBALE	178	

2	PRANIME TEKNIKE TË LOKALEVE	85	11,444.00 €
4	KËRKESA TË PRANUARA	92	
5	KËRKESA TË MIRATUARA	85	
6	KËRKESA TË REFUZUARA	5	
7	KËRKESA NË PROCEDURË	2	
8	GJOBA TË SHQIPTUARA	12	
9	GJOBË MANDATORE TË REALIZUARA	12	2.550.00 €
10	GJOBË mandatore e realizuar- NDERMJETËSIM – Gjykatë	/	
11	GJOBË MANDATORE TË REALIZUARA me UNIREF - MINT		
12	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	2	
13	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJËSIMI I MALLIT – VLERA NË €	127.337.92 €	
14	PAGESË PËR ASGJASIM TË MALLRAVE	3	1732.50 €

**SUBJEKTE AFARISTE TE PAJISURA ME PËLQIM MBI PLOTËSIMIN
KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE**

Bartës i aktivitetit - Inspektorati i Tregut

APLIKUAR	92
TË VENDOSURA	85
NË PROCEDURË	2
Mjete të inkasuara në €	11,444.00 €

Mall i asgjasuar

Sasia e mallit të asgjësuar vlera në euro	127,337.92 €
Të hyra nga malli i asgjësuar	1732.50 €

NË TOTAL TË HYRAT

Pranime teknike	11.444.00 €
Gjoha mandatore	2.550.00 €
Të hyrat nga mallrat e asgjësuar	1732.50 €
Totali i të hyrave	15.726.50 €

Me kërkesën e subjekteve afariste nga shitja dhe qarkullimi janë larguar mallra me afat të skaduar dhe njëkohësisht mallrat me afat të skaduar janë asgjësuar në prani të personave përgjegjës tek personi juridik .

INSPEKTORËT E KOMUNIKACIONIT, Veprimtaria dhe e tërë puna e Inspektorëve të Komunikacionit është bazuar në planprogramin të hartuar nga Drejtoria Për Inspektime. Gjatë zbatimit të planprogramit të hartuar nga inspektorët e komunikacionit për këtë periudhë kohore kemi lëshuar: procesverbale, vendime për pranime teknike të autotaksive, vendime për gjoha mandatore, ku dhe janë inkasuar mjete bazuar në vendimet. Me qëllim të përmirimit të gjendjes së transportit rrugor në teritorin e Komunës së Vushtrrisë janë marrë masa konform dispozitave ligjore si dhe inspektimet janë kryer në bashkëpunim me Policinë e Kosovës- Stacioni në Vushtri:

Qëllimi i inspektimit :

Mbikqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarve dhe mallrave, që qarkullojnë në teritorin e Vushtrrisë:

- Inspektimi i Autotaksive;
- Operatorët “Taksi”;
- Ndermarrjet të cilat mirren me transport të udhëtarve;
- Ndalimi i operatorve ilegal, masat e ndermarura ndaj tyre;
- Kushtet teknike të automjeteve;
- Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave;
- Kontrollimin e vijave Komunale urbane dhe urbano-periferike.

Inspektorati i Komunikacionit

- Inspektimi i transportuesve
Taxi, Kombi Busave, Autobusëve
- Kontrollimi i transportuesve tjerë që merren me transportimin e mallrave të ndryshme

TË HYRAT

Pranime teknike të automjeteve	385.00 €
Gjoha mandatore	400.00 €
Totali i të hyrave	785.00 €

Pranimi teknik i automjeteve

APLIKUAR	41
TË VENDOSURA	41
NË PROCEDURË	-
Mjete të inkasuara në €	385.00 €

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare

Inspektorati	Nr. i kërkesave	Procesverbale	Fletparaqitje	Aktivendime/Urdh ëresa	Gjjoba mandatore
Inspektorët e Komunikacionit	46	162	-	51/111	10

Sektori për shërbime publike

Aktivitetet:

- Inspektimi i hapësirave publike – ekspozimi i mallrave jashtë lokaleve, në trotuare dhe sheshe,
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave,
- Vazhdimi i lëndëve sipas afateve kohore të dhëna nga Inspektorët,
- Raportet e punës.

Inspektimi në bazë të Planit të Punës është bërë kryesisht në rrugën “Ismail Qemajli”, sheshi “Hasan Prishtina” dhe sheshi “Adem Jashari”. Përveç aktiviteteve në bazë të planit të punës, kemi bërë edhe inspektimin në pjesë të tjera të qytetit sipas nevojës, në bazë të detyrës zyrtare, me sygjerim të Drejtorit të Drejtorisë për Inspektim.

Përveç inspektimeve, te angazhimet tjera hyjnë edhe vendimet për inspektimet e kryera dhe raportet e vazhdueshme rreth punës.

Tabela e punës:

Procesverbale	124
Vendime	30
Gjjoba	31
Gjjoba te realizuara	21
Shuma e mjeteve nga gjjobat e realizuara	3325 € euro

Pas inspektimit të subjektet e caktuara, kemi bërë edhe riinspektimin dhe kemi përcjellë ato në vazhdimësi për të parë nëse janë zbatuar urdhërat e dhëna me procesverbal. Deri tani, përveç një rasti i cili është më specifik, rastet e tjera janë të përfunduara. Gjatë këtyre tre muajve sa jam pjesë

e Drejtorisë për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë, kam shqiptuar një gjobë e cila është paguar brenda afatit të paraparë me ligj.

INSPEKTORATI I NDËRTIMIT

Gjatë kësaj periudhe, Inspektorët e Ndërtimit kanë kryer inspektime në bazë të ligjit dhe rregulloreve që janë në fuqi për fushën e ndërtimit.

Për këtë periudhë janë kryer inspektime lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrrisë, ndërprerjen e të gjitha ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve me leje ndërtimi, rrënimin e objekteve pa leje.

Për të ardhur deri te një analizë sa më e saktë e punëve kemi bërë grumbullimin e të dhënave për aktivitetet a planifikuara dhe atyre të realizuara, duke nxjerrë statistika e deri te rekomandimet për të rritur efikasitetin në punë.

Aktivitetet e implementuara

- Në kuadër të kontrollimit të terrenit, janë përpiluar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje ndërtimi, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor menjëherë si dhe janë vendosur shirit rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore, shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afaristë.
- Kontrollimi i objekteve me leje ndërtimi,

Procesverbale

Procesverbalet janë lëshuar për ndërtimet të bëra pa leje ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pas edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: te rrasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi

Vendimet për ndërprerje të punimeve janë lëshuar për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi, vendimet për ndërprerjen të punimeve kanë karakter të urdhëresës së prere për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje ndërtimi.

Gjoba mandatorë

Gjobat mandatorë janë lëshuar në bazë të udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatorë, për ndërtimet e bëra pa leje dhe pjesëmarrësve në ndërtim si dhe në mbështetje të Ligjit për Kundërvajtje 05/L-087 të cilët kanë punuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me ndërtimin e objekteve.

Takimet me palë	12
Lëndët (kërkesat) e pranuar	370
Informata nga investitorët-----	97
Lëndët e përfunduara	271
Lëndët të refuzuara.....	2
Lëndët e pezulluara	3
Lëndët në procedurë.....	3
Vendime për ndërprerje të punimeve -----	14
Vendime për rrënim-----	2
Gjoba mandatorë-----	3
Objekte të inspektuara me leje ndërtimi	16
Objekte të inspektuara --Totali me leje dhe pa leje ndërtimi -----	08

Kërkesat kanë të bëjnë kryesisht me inspektimet rutinë të cilat bëhen nga Investitorët e ndërtimeve me leje ndërtimi për inspektimet e fazave të ndërtimit, prej fillimit të ndërtimeve deri në përfundimi

të ndërtimit, ne si drejtori i jemi përgjigjur këtyre kërkesave duke vizituar vend ndërtimet dhe plotësuar kartelën e inspektimit.

Po ashtu ka pasur kërkesa të natyrës së ndryshme të ankesave nga qytetarët të cilët kanë kërkuar inspektime të gjendjeve faktike në terren.

Për të gjitha kërkesat e drejtuar drejtorisë sonë i jemi përgjigjur komfor përgjegjësive dhe kompetencave.

Sfidat

Pavarësisht mbarëvajtjes së punës, në Drejtorinë për Inspektime kemi hasur edhe në sfida të ndryshme të cilat kanë penguar rrjedhën normale të punës, që edhe ka qar deri te shkëlja e ligjit nga ana e qytetarëve, ndër sfidat kryesore të evidentuara janë:

- Mungesa e Planifikimit Hapësinor dhe Planeve Rregulluese të hollësishme, në shumicën e zonës mungojnë planet rregulluese po ashtu pa përputhshmëria e planeve me gjendjen faktike në terren, mangësi të tilla detyrojnë qytetarët të ndërtojnë objekte pa leje ndërtimi.
- Vonesat procedurale në lëshimin e lejeve ndërtimore,
- Pamundësia për tu pajisur me leje ndërtimore (mungesa e Planeve Rregulluese, zona nën komasacion, problemet pronësore, etj.), propozojmë që kuvendi komunal të hartojë rregullore komunale për lehtësimin dhe tejkalimin e këtyre sfidave,
- Nevoja për banim (rritja e familjes, shtimi i numrit të të martuarve, nevoja për banim më të qëndrueshëm),
- Kërcënimet dhe sulmet e vazhdueshme ndaj stafit, mungesa e mbështetjes shëndetësore dhe financiare,
- Mungesa e stafit, numri i vogël i inspektorëve, , objektet me shkallë të lartë të rrezikshmërisë mungesa e inspektorëve profesional për këtë lëmi),
- Mungesa e automjeteve dhe pajisjeve teknologjike për terren,

Rekomandimet

Analiza e aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të realizuara si dhe sfidave na dërgon deri te rekomandimet, me përmirësimin e të cilave puna dhe efikasiteti në Drejtorinë për Inspektime përkatësisht në sektorin e ndërtimit do të rritet, si rekomandime kryesore që do të ndikonin në performancë janë:

- Rritja e numrit të inspektorëve,
- Profesionalizimi dhe trajnimet adekuate lidhur me fushat që i përkasin Inspektoratit të ndërtimitarisë
- Pagesa për rrezikshmërinë,

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare

	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	NR/SASIA	TOTALI NË €
1	PROCES VERBALE	534	
2	PRANIME TEKNIKE TË LOKALEVE	85	11,444.00€
3	PRANIME TEKNIKE TË AUTOMJETEVE	41	385.00 €

4	URDHËRESA TË NDRYSHME	164	
5	KËRKESA TË PRANUARA	573	
6	KËRKESA TË MIRATUARA	530	
7	KËRKESA TË REFUZUARA	13	
8	KËRKESA NË PROCEDURË	19	
9	GJOBA TË SHQIPTUARA	56	
10	GJOBË MANDATORE TË REALIZUARA	46	7475.00 €
11	VENDIME PËR RRËNIM		
13	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	3	
14	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJËSIMI I MALLIT - <u>VLERA NË €</u>	127,337.92 €	
15	PAGESË PËR ASGJASIM TË MALLRAVE		1732.50 €
16	ANKESA TE PRANUARA	24	
17	ANKESA TË MIRATUARA	16	
18	ANKESA TË REFUZUARA	4	
19	ANKESA TE HEDHURA POSHTË	4	

Mbrojtje dhe Shpëtim

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë realizimit të planit të punës ka qenë e angazhuar në realizimin e detyrave dhe zbatimin e normave ligjore të cilat janë nxjerrë nga aktet ligjore, të Ligjit për mbrojtje nga zjarri nr. 02/L-41 dhe Ligjit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nr. 02/l-68, të cilat janë të hartuara dhe azhuruara nga drejtoria si në vijim:

- Vlerësimi i rrezikshmërisë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës.
- Plani i gatishmërisë emergjente për Komunën e Vushtrrisë.
- Plani komunal për mbrojtje nga zjarri (sipas situatave në terren)
- Plani komunal për reagim emergjent.
- Plani për reagim emergjent gjatë vërshimeve.
- Plani për reagim emergjent në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në ndërtesën e komunës.
- Plani i evakuimit të personelit nga ndërtesa.

Angazhimi për azhurnimin dhe hartimin e planeve të cekura ka qenë detyrë permanente e kësaj drejtorie gjatë tërë vitit.

Qëllimi i azhurnimit i këtyre planeve është:

- Që të bëhet koordinimi i të gjitha shërbimeve për reagim emergjent në nivel komunal, si dhe asistimi i qytetarëve në rast të fatkeqësive natyrore, teknologjike dhe fatkeqësive të tjera;
- Që të kemi një strukturë të koordinuar civile, shërbimet emergjente komunale (shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, shërbimin emergjent komunal medicinal, kryqi i kuq , OJQ-të), PK-ën, në mënyrë që këto struktura të jenë të gatshme të reagojnë shpejt dhe me efikasitet në raste emergjente civile.

Me këto struktura jemi në kontakt të përhershëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste emergjente. Caktimi i subjekteve përgjegjëse, identifikimi i pikave emergjente caktimi i prioritetëve dhe koordinimi sa më efikas në mes të këtyre subjekteve që të reagojnë shpejt, profesionalisht dhe me efikasitet në raste të fatkeqësive natyrore, teknologjike etj. Që të shpëtohen jetët e njerëzve në radhë të parë, pasurisë të mirave materiale dhe stabilizimi i situatës së krijuar gjatë dhe pas emergjencës.

Realizimi i këtyre synimeve kërkon një angazhim të madh jo vetëm të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, por të gjitha organeve komunale për përmbushjen e nevojave me mjetet materiale teknike me qëllim të ngritjes së efikasitetit.

Gjatë vitit 2024 në DMSH ka pasur angazhime të rregullta por edhe raste emergjente veçanërisht me vërshime ku edhe kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar për angazhim në situata emergjente në terren për eliminimin e disa pikave kritike .

Kemi pasur takime me pjesëtarë të FSK-së, AME-së me Policinë e Kosovës - Stacioni në Vushtrri, KFOR-in , Kryqin e Kuq në Vushtrri, QOR 112.

Gjatë këtij viti në Komunën e Vushtrris karakterizohet me fatëkeqësi të vogla natyrore dhe fatkeqësi tjera në krahasim me vitet paraprake.

Megjithë atë edhe në këtë periudhë ka pasë fatëkeqësi të cilat edhe kanë shkaktuar dëme të konsideruara materiale dhe fizike.

Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatëkeqësitë Ntyrore dhe Fatkeqësitë tjer , në bazë të kërkesave të qytetarëve kanë dalë në nendin e ngjarjes dhe kanë bërë vlerësimin e dëmeve , të cilat paraqiten në raportin vjetor të Komisionit për vlerësimin e dëmeve.

Gjatë vitit 2024, në Komunën e Vushtrrisë, janë shkaktuar dëme në ekonomi Familjare dhe në bujqësi nga faktorët natyrorë dhe faktorët e tjerë si: era, breshëri, zjarri dhe qentë endacak. Të gjitha këto dëme i

kemi përmbledhur në formën e shkruar dhe në formë tabelare për secilin muaj që ka ndodhur fatkeqësia si më poshtë:

Dëmet në ekonomi, janar 2024

Më dt. 12 janar 2024, një qytetar nga fshati Bajskë/K.Vushtrri, ka parashtruar kërkesë se me datën 11.01.2024, nga zjarri i është djegur objekti të cilin e ka shfrytëzuar për qeljen dhe rritjen e zogjve.

Dëmet në bujqësi, shkurt 2024

Me datën 9 shkurt 2024, nga era e fortë e cila ka përfshirë territorin e komunës sonë kemi pasur dëme në serra, ku kërkesa për kompensim të dëmeve në sera me sipërfaqe më të vogla se 5 ari kanë parashtruar 9(nëntë) fermer, kurse për sera me sipërfaqe mbi 5 ari ka parashtruar 1(një) qytetar.

Me datën 4 shkurt 2024, një qytetar nga fshati Akrashicë/K.Vushtrri, nga zjarri i janë djegur rreth 70 ari të mbjellura me lajthi, ku 30 ari me lajthi i janë dëmtuar tërësisht. Shkaktari i zjarrit nuk dihet.

Dëmet në bujqësi, mars 2024

Me datën 11 mars 2024 - Nga era e fortë e cila ka përfshirë një pjesë të territorit të komunës sonë kemi pasur dëme në serra, ku kërkesa për kompensim të dëmit në serra me sipërfaqe mbi 5 ari kanë parashtruar 2(dy) qytetar.

Dëmet në bujqësi, maj 2024

Më dt. 27 maj 2024, një qytetar nga Vushtrria, ka parashtruar kërkesë se gjatë natës qentë endacak i kishin ngrënë 400 pula. Pulat i ka patur të rrethuara me tel, por qentë e kanë dëmtuar rrethojën nga teli dhe janë futur brenda rrethojës.

Dëmet në Ekonomi, qershor 2024 Më dt. 25 qershor 2024, një qytetar nga fshati Novolan/K.Vushtrri, ka parashtruar kërkesë se me datën 22.06.2024, nga zjarri i është djegur kulmi i stallës.

Dëmet në Bujqësi, korrik 2024

Më dt.30 korrik 2024, një erë e fortë dhe breshër e ka përfshirë një pjesë të territorit të Vushtrrisë, ku ka dëmtuar një pjesë të serës me sipërfaqe prej 7.36 ari, pronë e fermerit Besim Xhaferi nga fshati Dobërllukë/K.Vushtrri.

Dëmet në Bujqësi, gusht 2024

Më dt.3 gusht 2024, një mot i ligë me breshër e ka përfshirë një pjesë të territorit të Vushtrrisë, ku ka dëmtuar 65 % të parcelës e mbjellur me pjepër në sipërfaqe prej 2.44 ha, pronë e fermerit, Ali Xhafa nga fshati Sllatinë/K.Vushtrri.

Dëmet në Ekonomi, shtator 2024 Më dt. 11 shtator 2024, një qytetar nga fshati Stanoc i Poshtëm/K.Vushtrri, ka parashtruar kërkesë se me datën 1 shtator 2024, nga zjarri i është djegur kulmi i deposë(stallës) pronë e z. Hajrullah Aliu.

PARAQITJA TABELARE E DËMEVE PËR VITIN 2024

Tabela 1

LISTA E DËMTIMEVE NË EKONOMI - VUSHTRRI,					Periodha janar 2024
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Brahim Uka	Bajskë	objekti për qeljen dhe ruajtjen e zogjëve	Zjarri	2,159.00 €

Tabela 2

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI,					Periodha shkurt 2024
Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit	
1	Abit Bojku	Druar,	sera -1 ari- folia	Era e fortë	185.00 €
2	Ajshe Kadrija	Novolan	sera -0.5 ari- folia	Era e fortë	118.40 €
3	Ilmi Zekolli	Maxhunaj, "Zek Dumnica"-nr.5	sera -0.4 ari- folia	Era e fortë	74.00 €
4	Remzi Isufi	Pestovë	sera -1 ari- folia	Era e fortë	185.00 €
5	Sabri Imeri	Liqej, "Idriz Mehana"-	sera -0.4 ari- folia	Era e fortë	74.00 €
6	Samir Bekteshi	Stanoc i Poshtëm	sera -1.6 ari- folia	Era e fortë	296.00 €
7	Selim Izmaku	Vushtrri, Qemajl Shaqiri"-nr.27	sera -2 ari- folia	Era e fortë	370.00 €
8	Vesel Latifi	Silatinë, nr.72	sera -2 ari- folia	Era e fortë	370.00 €
9	Sabri Gashi	Begaj	Sera – 0.5 ari	Era e fortë	118.00 €
10	Zenë Haradinaj	Stanoc i Epërm	sera -30 ari- folia	Era e fortë	4,440.00 €
11	Jeton Zeka	Akrashticë, nr.22	30 ari Lajthi	Zjarri	7,228.00 €

Tabela 3

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI,					Periodha mars 2024
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Anife Zhegrova	Stanoc i Poshtëm	Sera -Folia	Era e fortë	8,880.00 €
2	Agnesa Bajgora	Vushtrri	Sera -Folia	Era e fortë	832.50 €

Tabela 4

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI,					Periodha maj 2024
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Naim Sinani	Vushtrri	Pula	qent endacak	756.00 €

Tabela 5

DËMET NË EKONOMI - VUSHTRRI, Periudha qershor 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Rasim Vatovci	Novolan	Kulmi i stallës	zjarri	7,850.00 €

Tabela 6

DËMET NË BUJQËSI - VUSHTRRI, korrik 2024					
Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbani mi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Besim Xhaferi	Dobërluk ë	sera – 7.36 ari – folia - tranguj 3 ari - domate 3 ari	Era e forte dhe breshëri	1,636.85 €
					1,636.85 €

Tabela 7

DËMET NË EKONOMI - VUSHTRRI, Periudha Gusht 2024					
Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbani mi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Ali Xhafa	Sllatinë	65% e sip. prej 2.44 ha-Pjepër	Breshëri	11,368.45 €

Tabela 8

DËMET NË EKONOMI - VUSHTRRI, Periudha shtator 2024					
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlera e dëmit
1	Hajrullah Aliu	Stanoc I Poshtëm	Kulmi i depose(stallës)	zjarri	985.00 €

Tabela 9: Dëmet e Përgjithshme

Nr. Ren	Përshkrimi i dëmit	Shuma e dëmit
1	Gjithsej dëme në ekonomi në muajin janar 2024	2,159.00 €
2	Gjithsej dëme në bujqësi në muajin shkurt 2024	13,458.40 €
3	Gjithsej dëme në bujqësi në muajin mars 2024	9,712.50 €
4	Gjithsej dëme në bujqësi në muajin maj 2024	756.00 €
5	Gjithsej dëme në ekonomi në muajin qershor 2024	7,850.00 €
Viti shkollor 2024/25 ka filluar më 2 shtator 2024, ndërsa gjysmëvjetori i parë ka përfunduar më 24 dhjetor 2024, bazuar në UA.04/2024. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka hapur platformën për aplikim për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore me datën: 25.08.2024. Aplikimi për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore ka qenë i hapur në Platformën E-Kosova deri në fund të muajit shtator. Furnizimi me libra në dy javët e para të shtatorit ka hasur në vështirësi për shkak se libraritë nuk janë furnizuar me kohë dhe kjo ka paraqitur vështirësi në fillimin e mbarë të procesit mësimor. Ndërsa, në disa lëndë mësimore si në Gjuhën angleze, TIK, Kimi dhe Fizikë, Njësia e personelit nuk ka mundur t'i rekrutojë punëtorët sepse sistemi i platformës për hapjen e vendeve të lira me kohë të caktuar nuk është lanësuar me kohë nga DMZP-ja (Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë). Të gjitha objektet e shkollave ofrojnë kushte teknike për një fillim të mbarë. Drejtoria Komunale e Arsimit, paraqet këtë Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025. Drejtoria Komunale e Arsimit, objektivat e veta të planifikuara i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI-Prishtinë), me Sektorin e Inspektoratit në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit.

▪ Numri i nxënësve në nivele për vitin shkollor 2024/25:

Niveli 0: 1046 nx.

Niveli 1: (1-5) 4721 nx.

Niveli 2: (6-9) 3951 nx.

Niveli 3: (10-12) 2193 nx.

Gjithsej: 11911 nxënës

▪ Numri i paraleleve:

Grupmoshat: 1, 2, 3, 4, 5:

Grupa 5-6 – Parafillor: 42

Fillor: klasa 1-5: 270

I mesëm i ultë: 209

I mesëm i lartë: 103

Gjithsej: 642 paralele

▪ Personeli:

Drejtorë: 37

Zëvendës drejtorë: 7

Pedagogë/e: 10

Psikologë/e: 9

Bibliotekistë/e: 8

Këshilltarë karriere: 2

Sekretarë/e: 16

Punëtorë teknik: 140

Punëtorë administrativ: 230

Edukatore parashkollore: 25
Edukatore në çerdhe: 48
Mësimdhënës/asistentë 12 për FNV, mësues mbështetës: 3
Mësimdhënës klase: 279
Mësimdhënës lëndor kl. 6-9: 347
Mësimdhënës lëndor kl. 10-12: 178
Gjithsej mësimdhënës/e edukatore dhe mësimdhënës/e: 894
Numri total i punëtorëve: 1124

Numri i institucioneve publike: 37 prej tyre

- ⇒ 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizike e cila është në procedurë të pavarësimi
- ⇒ 3 shkolla fillore
- ⇒ 2 Shkolla të mesme të ulëta
- ⇒ 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta
- ⇒ 3 shkolla të mesme të larta

Numri i institucioneve private:

- ⇒ 5 çerdhe private
- ⇒ 1 shkollë e mesme e mjekësisë

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/25, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë, me qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

II. Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrisë, që në objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit;
- Takime të rregullta me KFORIN sloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsim;
- Nga ekipi komunal për vlerësimin e nxënësve janë vlerësuar 11 nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe janë rivlerësuar po ashtu 11 nxënës;
- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e DKA-së: kontrata për furnizim me material për mirëmbajtje të objekteve, kontrata për furnizim me inventarë zyrtar-shkollor, kontrata për furnizim me letër, kontrata për furnizim me lëndë djegëse (dru) në shkolla, kontrata e transportit të nxënësve, kontrata për internet, kontrata për material zyrtar;
- Vizita të rregullta në qendrën arsimore të Komunitetit VORAE në Prilluzhë;
- Transporti i nxënësve është realizuar në 36 vija udhëtuese;
- Në SHMP “Bahri Haxha” – Vushtrri, është realizuar projekti fitues Çmimi mjedisor „Dervish Rozhaja” në vlerë 10.000 euro. Me këtë projekt janë instaluar 15 klima efçente, 18 BTU financuar nga YENI dhe CARITASI Zviceran nga pjesëmarrja në projektin „Ndikimi i rinisë në mjedis” YENI I CARITASIT - „Ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike. -Eko-klubi i SHMP „Bahri Haxha,, ishte fitues i çmimit të parë mjedisor. Ka vazhduar projekti mësimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI-të dhe XII-të kanë kryer praktikën në vendin e punës. Ka vazhduar „Mësimi dual,, për 24 nxënësit e profilit “Tregtarë me pakicë dhe shumicë”.
Është nënshkruar marrëveshja me të cilën SHMP “Bahri Haxha” do të jetë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin CultiVeting, ndër shkollat e para publike e përfshirë në këtë program (gjatë muajt nëntor është realizuar vizita e dytë studimore në Bruksel). Njëzet e dy nxënës janë trajnuar dhe certifikuar në trajnimin “Edukimi i të rinjve për artin, kulturën dhe trashëgiminë”. Është nënshkruar e marrëveshja e financimit për grantin e fituar nga RCF (fondi rajonal i sfidave i cili financohet nga Qeveria gjermane dhe Zvicrane) në vlerën 491899 euro. - SHMP “Bahri Haxha” është pjesë e “Super shkollave”, financuar nga zyra e RYCO-s në Prishtinë;
- Në SHMU-1 u pasurua biblioteka me mbi 700 tituj nga autorë të ndryshëm, si dhe u certifikuan 400 nxënës për kodim
- Më datën: 20 shtator 2024 nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me kryqin e kuq për mbajtjen e ligjëratave të Ndihmës së Parë Bazike në shkollat e Komunës sonë ku u certifikuan ekipet e të gjithë shkollave;
- Më datë: 02.10.2024, Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri dhe OJQ – Olimpiada Speciale e Kosovës,- Drita Dushi-Parduzi, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit e cila synon gjithëpërfshirjen në aktivitete sportive të fëmijëve me nevoja të veçanta;
- U mbajt pilotimi i testit Pisa me nxënës të SHMP “Bahri Haxha” – Vushtrri;
- Pjesëmarrje në takim me ekipe shkollore “Gjithëpërfshirja dhe Mbështetja për Fëmijët me Autizëm dhe Nevoja të Veçanta, Roli i Arsimit dhe Shëndetësisë në Komunë”, organizuar nga “ORDA”;

- U mbajt tryezë diskutimi me temë kryesore: Shëndeti mendor, Sfidat dhe mundësitë e njeriut në shek. XXI". - Në këtë tryezë morën pjesë psikologë të shkollave, drejtorë dhe dr. Ferid Agani;
- U mbajt aktivitet me nxënësit e Gjinnazit "Eqrem Qabej", për shëndetin mendor;
- U mbajt tryezë informuese për ditën e vajzave në SHMU2;
- Aktiviteti në shkollën "Mustafë Venhari", shitja e produkteve nga ana e nxënësve për t'i dalë në ndihmë familjeve skamnore;
- U mbajt ligjëratë informuese me nxënësit e klasës së VII në SHFMU Nedakoc me temën: "Pasojat e përdorimit të tepërt të rrjeteve sociale si dhe vetëlëndimet";
- Aktivitet në SHMLT "Lutfi Musiqi", me rastin e përmbylljes së muajit Rozë;
- Vlera Kastrati, me ekipin përgjegjës për vlerësimin përfundimtar të projektit zviceran YENI, zhvilluan hulumtimin për eko-klubet dhe projektin nga CARITAS-i zviceran, më datë: 22 tetor 2024, i cili hulumtim përkon me punën e kryer;
- Më datën: 24 tetor u certifikuan 21 mësimdhënës certifikimin nga KosED dhe IP lidhur me shqyrtimin e teksteve shkollore;
- U mbajt tryezë e diskutimi për të shënuar Ditën Botërore Kundër Abuzimit të Fëmijëve, për të vënë në pah rëndësinë e ndikimit të kësaj teme në shëndetin mendor të secilit nxënës. Takimi u mbajt në SHMU 1 – Vushtri, më datë: 19.11.2024, nga ora 11: 00;
- Datë 22. 11. 2024, u mbajt aktivitet në SHMP "Bahri Haxha" projekti për trashëgimi kulturore ku nxënësit u paisen me certifikata;
- Më 29. 11. 2024, u mbajt aktivitet me fëmijët me nevoja të veçanta. Aktiviteti u realizua në shtëpinë e kulturës;
- Më datë: 02.12.2024 ndanë 43 certifikata për zhvillim profesional me bazë në shkollë për shkollat: SHF "Mustafë Vehari" Vushtri, SHMU-1 Vushtri, SHF "Naim Frashëri" Vushtri, SHF "Ali Kelmendi" Vushtri;
- Më datë: 02. 12. 2024, nga përfaqësues të MASHT-it u prezantua Zbatimi i politikave për mbrojtjen e fëmijëve;
- Dt. 04. 12. 2024, nga organizata Terres de Hommes u trajnuan zyrtarë me temën "Hyrje në antigjipsizëm";
- Më datë 19. 12. 2024, u mbajt sesion informues për hartimin e Planit Individual të Arsimit në bashkëpunim me Qendrën Burimore "Nënë Tereza" – Mitrovicë.
- Gjatë periudhës shtator 2024 e deri më tani, DKA-ja ka shpallur 21 konkurse ku janë punësuar 31 mësimdhënës, ndërsa 3 konkurse janë anuluar për shkak të mungesës së kandidatëve për drejtimet deficitare si : 1. Fizikë në SHMU-1-Vushtri, 2. Teknologji Informative në SHFMU "Hajrullah Shala" – Akrahticë dhe 3. Gjuhë Gjermane në SHFMU "Migjeni" – Stanoc.

III. Garat e diturisë dhe garat sportive

- Nxënësjja e SHMU 2 – Vushtrri, Rajana Podvorica (nxënëse e klasës së 7-të), ka përfaqësuar Kosovën në garën e Gjuhës angleze “Hippo 2023” në Romë, ndërsa është kualifikuar për në Paris;
- Nxënësi i SHMU 2 – Vushtrri, Taulant Tahiri, ka fituar vendin e parë në garën kombëtare të Kimisë, organizuar nga Kolegji “Meçmet Akif”;
- Ekipi komunal i ERBM u vlerësua me mirënjohje nga MASHTI për punën e parandalimit të braktisjes në Arsim si dhe ekipi i SHMU 2 – Vushtrri;
- Në garën e Olimpiadës Matematike Komunale, për klasat e 7-ta, vendin e parë e mori Uran Ademi, nxënës i SHMU 2. Për klasat e 8-ta, vendin e parë e mori Alejna Selimi, nxënëse e SHMU 2 – Vushtrri. Për klasat e 9-ta, vendin e parë e mori Lis Mehollli, nxënës i SHMU 2 – Vushtrri. Për klasat e 10-ta, vendin e parë e mori Endrit Gërçhaliu, nxënës i Gjinnnazit “Eqrem Çabej” – Vushtrri. Për klasat e 11-ta, vendin e parë e mori Leart Krasniqi, nxënës i Gjinnnazit “Eqrem Çabej” – Vushtrri dhe të 12-ta vendin e parë e mori Bedri Haliti nxënës i Gjinnnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri;
- SHFMU “Liria” Stroc, ka zënë vendin e parë me vajza, në garën Futsall, në nivel komunal;
- SHMU-1, Vendi i parë në basketboll në nivel komunal, Vendi i dytë në basketboll në nivel komunal, Vendi i parë në futsall në nivel komunal, Vendi i parë në futsal në nivel regional, Vendi i parë në futsal në nivel republikan;
- SHMU-2 - Vendi i parë, i dytë dhe i tretë në shah, në turnirin e organizuar nga instituti “Hasan Tahsin” dhe DKA (në kategorinë e meshkujve). Vendi i parë (meshkujt) vendi i dytë (femrat) në garat komunale në futsall. Vendi i parë për meshkuj dhe femra në garat komunale të ping-pongut. Vendi i parë për meshkuj në garat regjionale të ping-pongut;
- Në Olimpiadën e fizikës Laurent Maxhuni, nxënës i klasës së IX-të në SHMU 2-Vushtrri , mori Vending e parë, në garat komunale të fizikës, për klasat e X-ta Ajdesë Kadriu, nxënëse e Gjinnnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri mori Vending i parë, në garat komunale të fizikës, për klasat e XI-ta Aida Kovaçi, nxënëse e Gjinnnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri mori Vending i parë, në garat komunale të fizikës, ndërsa për klasë të XII-ta, Erti Rushti, nxënës i Gjinnnazit “Eqrem Çabej” Vushtrri Vendi i parë, në garat komunale të fizikës;
- Erti Rushti, nxënës i Gjinnnazit “Eqrem Çabej” – Vushtrri, mori vendin e tretë në Olimpiadën Kosovare të fizikës, i cili do të marr pjesë një ndër garat e fizikës në Olimpiadën Ndërkombtare të Fizikës 2025 (International Physics Olympiad IPhO), 17 – 25, korrik, 2025, Palaiseau, Ecole Polytechnique, Francë.- Olimpiadën Europeane të Fizikës 2025 (European Physics Olympiad EuPhO), 13 – 17, qershor 2025, Sofie, Bullgari;

- SHFMU “Bahri Kuqi” Shtitaricë në garat e SHPIK-ut në sfidën Bebras Computing Challenge. Shkolla u përfaqësua nga klubi i saj dhe dy nxënës, Art Berisha dhe Tuana Qunglla, arritën rezultate mbi 75% të pikëve, konkretisht 80 pikë, duke u renditur në mesin e 15 nxënësve më të mirë nga 1762 pjesëmarrës në gjithë Kosovën. Ata u kualifikuan në vendin e tretë në nivel vendi.

III. Investimet kapitale:

- SHFMU “Liria” – Stroc u pajisë nga Komuna me 4 televizorë “Fuego 60”, në vlerë 2000 €;
- SHFMU “Bahri Kuqi”, është pajisur me dy “Smart TV 65” dhe një klimë 1200 BTU për ngrohje;
- Gjimnazi “Eqrem Çabej” – Vushtrri, nga Komuna u pajis me perde (për 6 klasë) në vlerë 1000 euro. si dhe regullimi i ndriçimit në sallën e sporteve, riparimi i një pjese të njejeve sanitare, riparimi i disa qeramikave në korridoret e shkollës me vlerë 2600 euro.
- SHFMU “Latif Berisha” – Doberllukë, u pajis nga Komuna me 1 smart TV LED dhe një projektor;
- SHFMU “Mustafë Shyti” – Oshlan, është pajis nga Komuna me 2 smart TV;
- SHMP “Bahri Haxha” – Vushtrri, janë pajisur me SMART TV të gjitha klasat e mësimi dhe kabinetet (planifikim me buxhetin e shkollës). Janë pajisur me llaptopë personal të gjithë mësimitdhënësit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- Investime në ShMU 1, nga buxheti i shkollës dhe i Komunës: televizor për klastë, video-projektor për klastë, perde për klastë, makinë dore për bari (trimer), makinë dore për bari (trimer), aparatet për fikjen e zjarrit, 20 drunj dekorativ, zhavori për parking, ndërrimi i dyerve të tualeteve, ngjyrë për disa klasë, makinë e barit;
- SHMU 2, u pajis nga Komuna nga 23 llaptopë;
- SHMP “Bahri Haxha” – Vushtrri, është pajisur me mjete bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale, kabinetet e kimisë, teknologjisë ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës).

IV. Donacionet

- SHFMU "Liria" – Store, pranoi doacion nga Këshilli i fshatrave Stroc, Beçuk, Gllavotin, Bivolak dhe Zhilivodë. Donacion shkollës me dy klima SENSSECCO 12BTU – në vlerë prej 1000 € si dhe nga Sticking MIRA – Donacion shkollës me dy klima SENSSECCO 18 BTU në vlerë prej 1200 €;
- SHFMU "Bahri Kuqi" Shtitaricë, pranoi donacion nga Sami Pllana dhe Besnik Pllana, të dy banues në Gjermani, kontribuan me nga 250€, duke siguruar gjithsej 500€, me të cilat u realizua instalimi i ri i ujit dhe u vendosën fontana dhe rubinete të reja për banjot e nxënësve si Rexhep Pllana dhuroi 150€, të cilat gjatë gjysmëvjetorit të parë u shpenzuan për nevojat e shkollës, për programet festive dhe higjienën;
- Foleja 2 – Vushtrri, pranoi donacion nga Fabrika e miellit dhe keksëve "Molitoria". – Dhuroi disa kilogramë miell dhe disa pako me keksa për institucionin tonë. Kompania "Liri", dhuroi çanta dhe keksa për fëmijët e grupmoshës 2-3 vjeç. Kompania "Fruti", dhuroi lëngje për fundvit për të gjithë fëmijët e kopshtit tonë;
- Gjinnazi "Eqrem Çabej" – Vushtrri, ka pranuar donacion nga fondet e Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me Kosova Education Center dhe Ipko Foundation, Klubi Kundër Diskriminimit, i cili është nën mentorimin e profesorit Artin Dushi, është shpërblyer me një dron si vlerësim për kontributet e tyre, dhe për t'i ndihmuar ata në realizimin e projekteve që i kanë në kuadër të projektit "Action Against Discrimination For All". – Donacion nga Prof. Raif Mehmeti, ish-profesor i gjinnazit që vepron në Suedi, ka dhuruar 300 euro për tre nxënës nga 100 euro. Donacion nga Ndërmarrja Komunale "Përparimi", Ndërmarrja komunale "Përparimi" i ka dhuruar shkollës 8 pisha për mbjellje në oborrin e shkollës;
- SHFMU "Latif Berisha" – Dobërlukë, kanë dhuruar 259 euro për shkollën;
- SHFMU "Mustafë Shyti" – Oshlan, ka vazhduar marrëveshjen që ka pasur me MZHE-në për internet të shpejtë dhe të sigurt, ku tashmë interneti funksionon në komplet objektin, me pajisje extra-moderne;
- SHF "Mustafë Venhari" Vushtrri: Kompania Kosmonte Foods shpërndau dhurata për nxënësit e klasave të para si dhe INTEREX, me pronar z. Shaip Mikullovc, duke i gëzuar me dhuratat tuaja për festat e fundvitit;
- SHF "Naim Frashëri" Vushtrri pranoi donacion nga prindërve janë instaluar 7 klima nëpër klasë. Po ashtu dy prindër dhuruan 140 euro për veshje kombëtare si dhe një prind dhuroi 21 lektura të ndryshme për klasën II/3;
- Në SHFMU "Pestova, "Vipa Chips" ka dhuruar nxënësve dhurata për fundvit;
- SHMU-1 pranoi donacion: Inventar nga QKMF, tavolina për zyre karrige dhe dollapa nga QKMF-ja me vlerë 1400€. Biblioteka e shkollës 350€ drejtori, 100€ zv, Bibliotekistja 50€ dhe 230 € mësimdhënësit. Ujëmbledhëse për banjot dhe pas shkollës, drejtori i shkollës me vlerë 85€. Kamerat në koridor, 5 copa, 200€ nga drejtori, koordinatori dhe mësimdhënësit. Bravë për dyer, drejtori I shkollës me vlerë 150€. Ngjyrë për kabinetin e artit nga drejtori me vlerë 90€. Zyra e koordinatorit të cilësisë nga koordinatori me vlerë 50€. Ngjitja e fjalëve të urta në shkallë nga Burim Plakolli me vlerë 250€. Zmadhuesi i zërit dhe 4 mikrofonat nga Fllanza Ademi, Drejtori-Koordinatori me vlerë 220€, Ngjyra brusha pëlhura për nxënës, nga OJQ Harea 350€. Qeshmja e shkollës nga drejtori i shkollës 40€. Guaca e çezmës nga Sekretarja

130€. Donacion i Tv-së nga Benny Shop me vlerë 400€. Printer dhe dollap me vlerë 200€. 3 projektor nga Naser Imeri me vlerë 1200€. Laptop nga Safct Imeri me vlerë 400€. Pesë kubik beton për oborr të shkollës dhe ulëse nga Ariani Company me vlerë 350. Ngjyrë për klasë nga German Color 50€ Makinë për ujë të pijes nga Interplast me vlerë 120€. Smart tabelë dhe një projektor nga IPKO me vlerë 2000€. Ndërsa edhe mësime të cilët dhanë donacion në mjete: Jehona Zabërxha me 560 €, Esat Beka me 265€, Majlinda Ramaj me vlerë 1200€, Valdete Bunjaku me vlerë 400€. Sebahate Vatovci me vlerë 200€. Fllanza Ademi me vlerë 450€, Lulejtë Miftari me vlerë 100€. Dafina Dërguti me vlerë 71€. Xhenta Venhari me vlerë 151€ dhe Medije Hyseni me vlerë 105€. Afërsisht donacion që ka tërhequr kjo shkollë 13.000€;

- SHFMU “Nazmi Zhegrova” – Stanoc, ka pranuar donacion nga KFORI Danez, klima në të gjitha klasat e mësimit;
- SHFMU” Rexhep Musa” – Ceceli, ka pranuar donacion nga bashkëqytetari Irfan Perçuku, i cili jeton dhe vepron në Gjermani, i ka dhuru shkollës një donacion me pajisje sportive, në vlerë 108 euro;
- SHFMU “A. Z. Çajupi” – Vushtrri, ka pranuar donacion: Rregullimi i bankave për dy klasë dhe ngjyrosja e një klase nga prindërit;
Ndërrimi i të gjitha dritave led në klasa, donacion nga kompania “Zariqi Group” në vlerë 1100€; Firma “Urban Group” me pronar Agim Maloku, investoj në rregullimin e dy dyerve të bodrumeve në katin e parë; Ngjyrosja e korridoreve të shkollës, ndërrimi i dritave led dhe rregullim i parmakëve, në vlerë 2600€, donacion nga kompanitë (mobileria “Duli”, fabrika e dyerve “Preteni”, “German Color” “Soni Tours” dhe prindërit e komunitetit të shkollës;
- SHMU 2, pranoi donacion 26 palë dresa për ekipet e shkollës, donacion nga kompania "NIKU Travel".

V. Suksesi i gjysmëvjektorit të parë 2024/25

Periudha e njëjtë	Suksesi i gjysmëvjektorit të parë, viti shkollor 2024/25, klasa 1-5, krahasuar me periudhën e njëjtë					
	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2024	65.69%	19.42%	11.42%	2.68%	0.73%	0.43%
2023	64.62%	20.05%	11.14%	2.98%	1.20%	0.00%
Krahasueshmëria	1.07%	-0.63%	0.28%	-0.30%	-0.47%	0.43%

Shkëlqyeshëm: ka ngritje të suksesit për 1.07%


Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 0.63%

Mirë: ka ngritje të suksesit për 0.28 %

Mjaftueshëm: ka rënie të suksesit për 0.30%

Të pamjaftueshëm: ka ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.047%

Suksesi i gjysmëvjektorit të parë, viti shkollor 2024/2025, klasa 1-5



Suksesi i gjysmëvjeteri të parë, viti shkollor 2024/25, klasa 6-9, krahasuar me periudhën e njëjtë						
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2024	24.32%	20.98%	18.40%	3%	33.09%	0.18%
2023	24.89%	21.06%	18.31%	4.49%	30.80%	0.45%
Krahasueshmëria	-0.57%	-0.08%	0.09%	-1.49%	2.29%	-0.27%

Shkëlqyeshëm: ka rënie të suksesit për 0.57%

Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 0.08%


Mirë: ka ngritje të suksesit për 0.09 %

Mjaftueshëm: ka rënie të suksesit për 1.49 %

Të pamjaftueshëm ka ngritje për 2.29%

Sukesesi i gjysmëvjtorit të parë, viti shkollor 2024/2025, klasa 6-9

■ 2024 ■ 2023 ■ Krahasueshmëria



Suksesi i gjysmëvjektorit të parë, viti shkollor 2024/25, klasa 10-12, krahasuar me periudhën e njëjtë

Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2024	8.05%	14.11%	12.28%	16.28%	49.12%	0
2023	8.47%	15.61%	14.47%	9.88%	50.58%	0.98%
Krahasueshmëria	0.42%	1.50%	2.19%	-6.40%	1.46%	0.98%

Shkëlqyeshëm: ka rënie të suksesit për 0.42%


Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 1.50%

Mirë: ka ngritje të suksesit për 2.19%

Mjaftueshëm: ka ngritje të suksesit për 6.40%

Të pamjaftueshëm ka rënie për 1.46 %

Sukesesi i gjysmëvjektorit të parë, viti shkollor 2024/2025, klasa 10-12



VI. Numri i mungesave të gjysmëvejtorit të parë, të vitit shkollor 2024/25

Klasa	Numri i nxënësve	Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Të arsyeshme në raport me nx.	Të paarsyeshme në raport me nx.
Klasa 1	947	5077	394	5	0.1
Klasa 2	938	5676	583	6	0.1
Klasa 3	974	8259	623	8	0.1
Klasa 4	938	7357	1150	8	0.2
Klasa 5	925	7272	918	8	0.1
Klasa 6	951	8837	2173	9	0.2
Klasa 7	1032	14715	2373	14	0.2
Klasa 8	925	11904	5351	13	0.4
Klasa 9	989	15163	5167	15	0.3
Klasa 10	804	8638	9532	11	1.1
Klasa 11	806	12806	9710	16	0.8
Klasa 12	709	11831	10857	17	0.9
Gj.	10938	117535	48831	11	0.4

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO
 KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRIN

Nr. / No. 10184125
 Nr. i fq. / No. of: -7
 Data: / Datum: 07.03.2025

VUSHTRRI VUČITRIN
 Republika e Kosovës



Republika Kosova • Republic of Kosova



Komuna Vushtrri

Opština Vučitrn • Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Inspektime

DATE/A	06/03/2025
REFERENC-Ë:	13Nr.31/25
PËR/ZATO:	Kuvendin Komunal –Vushtrri KPF-në
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi 
NGA/OD/FROM:	Besim Demitaj Drejtor i Drejtorisë për Inspektime 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	INFORMATË PËR KUVEND

Të nderuar,

Në bazë të inspektimeve të realizuara nga inspektorati i ndërtimit gjatë vitit 2024 ju informojmë mbi gjendjen aktuale në sektorin e ndërtimit në Komunën e Vushtrrisë.

Aktivitetet e inspektoratit

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësit, si dhe në mbështetje të ligjeve në fuqi si organ mbikëqyrës, Inspektorati komunal i ndërtimit, ka ushtruar disa aktivitete inspektuese në terren lidhur me ndërtimet në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Aktivitetet inspektuese janë zhvilluar me qëllim të mbikëqyrjes së përputhshmërisë me legjislacionin aktual në fuqi nga fusha e ndërtimit.

Inspektimet janë kryer në këto fusha kryesore:

- Verifikimi i lejeve të ndërtimit dhe përputhshmëria me projektet e miratuara.
- Kontrolli i kushteve të sigurisë
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje ndërtimi

Gjetjet kryesore

Nga inspektimet e realizuara janë vërejtur këto çështje kryesore:

- Shumica e investitorëve kanë respektuar procedurat ligjore për marrjen e lejeve ndërtimore
- Ndërtimet pa leje – janë evidentuar raste të ndërtimeve pa leje për të cilat janë ndërmarrë masa përkatëse
- Shkelje të kushteve teknike – Në disa raste janë konstatuar devijime nga projektet e miratuara duke përfshirë ndryshime në strukturë dhe mos respektim të standarteve teknike.
- Siguria në punë

Po ashtu krahas aktiviteteve inspektuese të cilat janë zhvilluar qoftë sipas detyrës zyrtare apo edhe duke u bazuar në ankesat e qytetarëve, në ato raste kur kemi hasë në parregullsi kemi marrë masa ligjore komfor ligjeve në fuqi.

Masat e ndërmarra

Për rastet e shkeljeve procedurale të konstatuara nga ana e inspektoratit të ndërtimit janë marrë këto masa:

- Lëshimi i Vendimeve për Ndërprerjen e punimeve
- Shqiptimi i gjobave ndaj subjekteve që kanë shkelur rregullat ligjore
- Paraqitja e rasteve në organet përkatëse për procedim të mëtejshëm.

Gjatë kësaj periudhe të vitit kalendarik janë kryer inspektime në bazë të ligjit dhe rregulloreve që janë në fuqi për fushën e ndërtimit.

Deri në muajin e Prill, planifikimi dhe rrjedha e punëve ishte në nivelin e duhur të dinamikës së punëve, përjashtimisht rasteve emergjente të pa planifikuara. Planifikimi është bërë duke u bazuar në aktivitetet e planifikuara dhe të implementuara.

Për këtë periudhë janë kryer një numër i inspektimeve- aktiviteteve inspektuese lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrrisë, ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje ndërtimi lëshuar nga ana e organit kompetent, kontrollimin e objekteve me leje ndërtimi . Në rastet kur kemi hasë në parregullsi janë marrë masa ligjore për eliminimin e këtyre parregullsive si janë shqiptuar gjoba, vendime për ndërprerje të punimeve si dhe vendime për rrënimin e objekteve pa leje ndërtimi .

Për të ardhur deri te një analizë sa më e saktë e punëve kemi bërë grumbullimin e të dhënave për aktivitetet a planifikuara dhe atyre të realizuara, duke nxjerrë statistika e deri te rekomandimet për të rritur efikasitetin në punë.

Ligjet në të cilat duhet bazuar:

- Ligji Nr. 04/L-110 Për Ndërtim;
- Ligji Nr.04/L- 175 Për Inspektoratin e Mjedisit, Ujerave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit;
- Ligji nr08/L-067 për Inspektimet

- Udhëzimi Administrativ 05/2017 Për Mbikëqyrjen Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit;
- Udhëzim Administrativ Nr. 20/2013 Për Mënyrën Dhe Shumën e Gjobave Ndaj Pjesëmarrësve Në Ndërtim;
- Udhëzim Administrativ 04/2017 Për Kategorizimin e Ndërtimeve;
- Rregullore Nr.205/13 Për Rregullat Dhe Procedurat e Ndërtimit Të Objekteve.

Aktivitetet e planifikuara

- Planifikimi dhe zbatimi i punëve të planifikuara në kuadër të Drejtorisë për Inspektime,

- Njoftimi dhe aplikimi me bazën ligjore që do të përdoret në kuadër të sektorit,
- Identifikim i problemeve dhe propozimet për tejkalimin e tyre,
- Përgatitja e raporteve javore, mujore.
- Kontrollimi i terrenit,
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje,
- Kontrollimi i ndërtimeve me leje,
- Inspektimi përfundimtar i objekteve të ndërtuara,
- Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi dhe objekteve të vjetra të cilat paraqesin rrezik për shoqërinë.

Aktivitetet e implementuara

- Në kuadër të aktiviteteve inspektuese në terren pas vizitave, janë përpiluar Procesverbalet dhe Aktvendime për ndërprerje të punimeve lidhur me ndërtimet pa leje ndërtimi.
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje ndërtimi, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor menjëherë si dhe janë vendosur shirit rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore, shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afaristë.
- Kontrollimi i objekteve me leje ndërtimi.
- **Procesverbale 70**

Procesverbalet janë lëshuar për ndërtimet të bëra pa leje ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pas edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: te rasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

- **Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi 14**

Vendimet për ndërprerje të punimeve janë lëshuar për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi, vendimet për ndërprerjen të punimeve kanë karakter të urdhëresës së prere për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje ndërtimi.

- **Vendimet për rrënim..... 3**

• **Gjoha mandatorë 3**

Gjobat mandatorë janë lëshuar në bazë të udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatorë, për ndërtimet e bëra pa leje dhe pjesëmarrësve në ndërtim të cilën kanë punuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me ndërtimin e objekteve.

Në drejtorinë për inspektime –sektori ndërtimit janë pranuar gjithsejtë këto kërkesa për inspektim si dhe informata të investitorëve :

- Kërkesa për inspektim gjithsejtë	370
- Informata nga investitorët	91
○ Lëndët e përfunduara.....	271
○ Lëndët të refuzuara	2
○ Lëndët e pezulluara.....	3
○ Lëndët në procedurë.....	3
○ Ankesa	6
○ Takime me palë	12

Kërkesat që janë drejtuar Drejtorisë për Inspektime, përkatësisht sektorit të ndërtimit dhe kanë të bëjnë kryesisht me inspektimet rutinë të cilat bëhen nga Investitorët e ndërtimeve me leje ndërtimi për inspektimet e fazave të ndërtimit, prej fillimit të ndërtimeve deri në përfundimi të ndërtimit, ne si drejtori i jemi përgjigjur këtyre kërkesave duke vizituar vend ndërtimet dhe plotësuar kartelën e inspektimit.

Kemi pas edhe kërkesa të natyrës së ndryshme të ankesave nga qytetarët të cilët kanë kërkuar inspektime të gjendjeve faktike në terren.

Për të gjitha kërkesat e drejtuar drejtorisë sonë i jemi përgjigjur komfor përgjegjësive dhe kompetencave.

Sfidat

Pavarësisht mbarëvajtjes së punës, në Drejtorinë për Inspektime kemi hasur edhe në sfida të ndryshme të cilat kanë penguar rrjedhën normale të punës, që edhe ka qar deri te shkelja e ligjit nga ana e qytetarëve, ndër sfidat kryesore të evidentuara janë:

- Mungesa e Planifikimit Hapësinor, Mungesa e Hartës Zonale dhe Planeve Rregulluese të hollësishme, në shumicën e zonës mungojnë planet rregulluese po ashtu pa përputhshmëria e planeve me gjendjen faktike në terren, mangësi të tilla detyrojnë qytetarët të ndërtojnë objekte pa leje ndërtimi.
- Vonesat procedurale në lëshimin e lejeve ndërtimore,
- Pamundësia për tu pajisur me leje ndërtimore (mungesa e Planeve Rregulluese, zona nën komasacion, problemet pronësore, etj.), propozojmë që kuvendi komunal të hartojë rregullore komunale për lehtësimin dhe tejkalimin e këtyre sfidave,
- Nevoja për banim (rritja e familjes, shtimi i numrit të të martuarve, nevoja për banim më të qëndrueshëm),
- Kërcënimet dhe sulmet e vazhdueshme ndaj stafit, mungesa e mbështetjes shëndetësore dhe financiare,
- Mungesa e stafit, ku gjatë tërë vitit Inspektorati i ndërtimit ka qenë me një inspektor të vetëm gjë që nuk reflekton mirë për Komunën e Vushtrrisë në aspektin e inspektimit sa i përket inspektimit në fushën e ndërtimit me arsyetimin, duke u nisur nga fakti se në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë duke u kryer punime lidhur me ndërtime të reja e që është e papërballueshme për një inspektor të vetëm të ndërtimit kjo përgjegjësi për tërë Komunën e Vushtrrisë.
- Mungesa e automjeteve dhe pajisjeve teknologjike për terren,

Rekomandimet

Analiza e aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të realizuara si dhe sfidave na dërgon deri te rekomandimet, me përmirësimin e të cilave puna dhe efikasiteti në Drejtorinë për Inspektime përkatësisht në sektorin e ndërtimit do të rritet, si rekomandime kryesore që do të ndikonin në performancë janë:

- Rritja e numrit të inspektorëve, aktiviteteve inspektuese dhe mbikëqyrja e rreptë e kushteve të sigurisë.
- Profesionalizimi dhe trajtimet adekuate,
- Automjetet për inspektime,
- Pagesa për rrezikshmërinë,
- Mjetet teknologjike për punë
- Fuqizimi i bashkëpunimit me organet kompetente për parandalimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi.
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese për operatorët e ndërtimit mbi rëndësinë e respektimit të ligjit..

Nga kjo që u tha më lartë, duke parë sfidat me të cilat ballafaqohet Komuna e Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në përvojën dhe praktikat profesionale shprehim gatishmërinë në ofrimin e të gjitha këshillave të nevojshme për tejkalimin e këtyre sfidave.

Në përfundim, mbetemi të përkushtuar për të siguruar një zhvillim të rregullt urban dhe mbrojtjen e interesit publik në sektorin e ndërtimit..


Për çdo informacion shtesë jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me Kuvendin dhe institucionet përkatëse.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

DATE:	06.03.2025
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Hyrie Uka Hoxha, Drejtore e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
PËRMES:	Kryetarit të Komunës, z. Ferit Idrizi 
LËNDA:	Informatën lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Të nderuar/a,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Informatën lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Me respekt!



Drejtoria për Administratë

**Informatë
Për vitin 2024**

Datë: 06.03.2025

Informata vjetore e Drejtorisë së Administratës në Komunën e Vushtrrisë ofron një përmbledhje të aktiviteteve dhe arritjeve gjatë vitit 2024. Qëllimi i kësaj informate është të paraqes në detaje përprjekjet e drejtorisë për modernizimin e administratës publike dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët.

Gjatë vitit të kaluar, Drejtoria ka punuar vazhdimisht për të përmirësuar proceset administrative, për të rritur transparencën dhe për të siguruar efikasitet më të madh në shërbimet publike. Kjo informatë përfshin objektivat e arritura, aktivitetet kryesore dhe sfidat e hasura, duke ofruar një pasqyrë të qartë të progresit të bërë dhe hapave të ardhshëm për zhvillimin e administratës lokale.

Ndër aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit, veçojmë iniciativat për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e kushteve të punës. Përveç modernizimit të shërbimeve, janë organizuar trajnime për menaxhimin e stresit, zbatimin e Kodit Etik. Këto trajnime kanë qenë pjesë e një angazhimi të gjerë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të krijuar një ambient pune të sigurt dhe respektues për të gjithë punonjësit.

Drejtoria e Administratës mbetet e përkushtuar të jetë një faktor kyç në zhvillimin dhe përparimin e Komunës së Vushtrrisë, duke kontribuar në forcimin e shërbimeve publike dhe garantimin e një administrate transparente dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve.

Për të realizuar me sukses funksionet e saj, Drejtoria e Administratës është e organizuar në disa sektorë kryesorë, të cilët mbulojnë shërbime të ndryshme për qytetarët dhe administratën komunale. Këta sektorë përfshijnë:

1. Sektori për Gjendjes Civile;
2. Sektorin për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative;
3. Qendrën për Shërbim me Qytetarët;
4. Sektori për të Drejtat e Njeriut.
5. Sektori për logjistikë dhe furnizim

Secili nga këta sektorë ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e administratës publike dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

Objektivi i përgjithshëm strategjik i Drejtorisë së Administratës ka qenë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve administrative duke siguruar qasje të lehtë për qytetarët dhe bizneset, bazuar në procedura të qarta dhe të arsyeshme administrative, si dhe duke integruar metodat e e-qeverisjes. Po ashtu, një prioritet kyç ka qenë arkivimi elektronik dhe digjitalizimi i arkivit komunal, si hap drejt modernizimit të administratës.

Për realizimin e këtyre objektivave dhe funksionalizimin e administratës digjitale, Drejtoria ka ndërmarrë iniciativa të rëndësishme, përfshirë hartimin e **tri akteve administrative** për rregullimin dhe standardizimin e kësaj fushe:

1. **Lista e Shenjave të Klasifikimit të Dokumenteve** dhe afatet e ruajtjes së tyre për Komunën e Vushtrrisë,
2. **Rregullat për Administrimin dhe Menaxhimin Zyrtar të Dokumenteve dhe Arkivimin e tyre,**
3. **Udhëzuesi për informacione lidhur me shërbimet komunale.**

Në kuadër të përpjekjeve për digjitalizimin e arkivit komunal, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar dy takime pune me delegacionin e Komunës së Vaxjës në Suedi, si pjesë e projektit trevjeçar “**Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal**”. Ky projekt ka për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimin për standardizimin dhe avancimin e procedurave arkivore në Komunën e Vushtrrisë.

Si rezultat i tri takimeve të mbajtura – një në Vushtri dhe dy në Vaxjë – janë marrë përvoja të vlefshme, të cilat janë reflektuar në aktet administrative të hartuara, duke siguruar një qasje më moderne dhe më efektive ndaj menaxhimit të dokumentacionit komunal.

Projektet e realizuara gjatë kësaj periudhe

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Administratës ka proceduar dhe realizuar një sërë projektesh me qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve komunale. Ndër projektet kryesore të zbatuara janë:

- **Rimodelimi dhe inventarizimi i sallës së takimeve**, duke krijuar një ambient më funksional për mbledhjet dhe takimet zyrtare.
- **Ridizajnimi i Qendrës për Shërbim me Qytetarët** dhe krijimi i **8 sporteleve** në hyrje të komunës (kati përdhës) për ofrimin më të shpejtë dhe efikas të shërbimeve për qytetarët.
- **Renovimi dhe funksionalizimi i toaleteve** për të përmirësuar kushtet higjienike dhe qasjen për të gjithë përdoruesit.
- **Ngjyrosja e mureve në sektorin e Gjendjes Civile**, duke përmirësuar ambientin e punës.
- **Libërlidhja e akteve dhe dokumenteve të ndryshme**, duke siguruar arkivimin e tyre në formë të rregullt.
- **Libërlidhja e protokollit të komunës për vitin 2023**, për të garantuar ruajtjen dhe administrimin korrekt të dokumentacionit zyrtar.

Përveç këtyre projekteve, janë realizuar edhe **procedurat e rregullta të furnizimit**, duke përfshirë:

- **Furnizimin me pajisje të Teknologjisë Informative (TI)** për nevojat e administratës komunale.
- **Furnizimin me inventar**, për të përmirësuar ambientet e punës.
- **Furnizimin me karrige**, për të plotësuar nevojat e zyrave dhe hapësirave të shërbimit.

Pasqyra e të hyrave e Drejtorisë për Administratë për këtë periudhë

Të hyrat e drejtorisë

Të hyrat nga shërbimet administrative	36054.50 €
---------------------------------------	------------

Sektorin e gjendjes civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-Qershor i ka pranuar mbi 28502 kërkesa të qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme dhe për të gjitha këto kërkesa zyra e gjendjes civile ka ofruar përgjigje dhe shërbime në mënyrë efektive dhe efektive duke vendosur për së cilën kërkesë veç e veç, trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit, profesionalizmit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesit të digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendjes civile dhe harmonizimit të procedurave në ofrimin e shërbimeve dhe të lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile.

Objektivat e sektorit të gjendjes civile për vitin 2024 kanë qenë:

1. Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit gjatë përditësimit të shënimeve dhe të dhënave personale të qytetarëve në Regjistrin Qendror Elektronik të gjendjes Civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik.

2. Shqyrtimi i kërkesave në mënyrë të drejtë dhe nxjerrja e vendimeve për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes.
3. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të fakteve të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar dhe në regjistrin qendror të gjendjes civile, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore duke krijuar dosje për së cilën rast dhe arkivimi i tyre.
4. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të martesave brenda orarit të punës dhe regjistrimi i martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës, duke i shtypur dhe mbajtur aktet në mënyrë korrekte, cilësore dhe duke krijuar dosje për së cilën rast.
5. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të tjera të Gjendjes Civile, si dhe dhënia e shërbimeve të tjera në mënyrë efektive dhe pa gabime.
6. Azhurnimi i të gjitha kërkesave në intranet duke ju dhënë përgjigje dhe zgjidhje në mënyrë efektive dhe pa gabime.
7. Ndërlidhja dhe harmonizimi i të dhënave personale të gjendjes civile për të gjithë qytetarët ndërmjet regjistrat qendror elektronik të gjendjes civile me platformën (elektronike) online E-Kosova me qëllim që të krijohet mundësia e pajisjes (nxjerrjes) së certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë pa pasur nevojë që të kontaktohet zyra e gjendjes civile.
8. Ngritja e përgjegjësisë në ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parasheh ligji.

Për realizimin e këtyre objektivave në mënyrë efektive dhe efikase janë caktuar dhe ndërmarrë 80 aktivitete dhe detyra.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat të qytetarëve dhe ju kemi dhënë përgjigje sipas afateve ligjore dhe janë dhënë shërbime efikase dhe efektive.

Më së miri punën e zyrës së gjendjes civile për periudhën janar-dhjetor e pasqyrojnë tabelat e poshtëshënuara, të cila tregojnë në tërësi punën që është bërë nga zyra e gjendjes civile në shërbim të qytetarëve duke i proceduar dhe realizuar kërkesat e palëve dhe duke bërë lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të tjera të gjendjes civile nga zyra e Gjendjes Civile për komunën e Vushtrisë.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të tjera:

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	1
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	29
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	43
3.	Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ	22
4.	Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik	51
5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	9
6.	Dëshmi të vdekjes	242
7.	Lajmërime dhe ç'lajmërime të adresës së vendbanimit	836
8.	Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes,	5
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes	1
10.	Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës	0

11.	Aplikime për natyralizim(litim të shtetësisë)	207
12.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	13

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	29571
2.	Certifikata të lindjes	4349
3.	Certifikata të martesës	4340
4.	Certifikata të vdekjes	3170
5.	Certifikata të Statusit martesor	185
6.	Certifikata të shtetësisë	221
7.	Certifikata familjare	3733
8.	Certifikata të vendbanimit	2407
9.	Vërtetim nga arkivi	390
Gjithsej		48366

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	118
2.	Martesa	553
3.	Regjistrime të vdekjes	345
4.	Regjistrime të Shtetësisë	216
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	557
6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	81
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	51
9.	Shkurorëzime	91
Gjithsejtë regjistrime të bëra		2012

Spektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Spektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin sistemit të teknologjisë informative të komunës, lekturimi i materialeve të organeve të komunës dhe përkthimi i materialeve zyrtare të komunës nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas si dhe asistimi në përkthimin simulant për nevoja të organeve të komunës, mirëmbajtjen e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në ambientet e objekteve të komunës, ndërrimi dhe riparimi i stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar si dhe të gjitha punët që kanë të bëjnë me logjistikë.

Aktiviteti i Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ishte i përkushtuar në këto qëllimet kryesore:

1. Funkcionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës
2. Monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale;
3. Integriteti dhe ruajtja e të dhënave;
4. Mbështetja lidhur me përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të TI;
5. Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta

Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative sipas planit vjetor ka pasur 5 objektiva të përcaktuar të përshkruara më lart, ku për arritjen e këtyre objektivave ka zhvilluar 15 aktivitete të tjera të paparapara sipas planit vjetor të veprimit. Të gjitha këto kanë dalë si rezultat i nevojave të Administratës në përmbushjen e obligimeve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Përshkrimi i punëve, detyrave dhe intervenime të bëra	
Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e probleme softuerike.	292
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	512
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	260
Postime në ueb faqe dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare	14
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës si dhe konsultime për lekturim.	53
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulantë sipas nevojës të organeve komunale	127
Riparime dhe punë të ndryshme për mirëmbajtje të objektit komunal.	457

Shërbimet Online nga eKosova:

- **Totali i Shërbimeve Online: 27,273**
 - Ekstrakt i lindjes: 10,881
 - Certifikata të lindjes: 13,053
 - Certifikata të martesës: 2,905
 - Certifikata të vdekjes: 434

Shërbimet Online nga eKiosku:

- **Totali i Shërbimeve nga eKiosku: 737**
 - Ekstrakt i lindjes: 369
 - Certifikata të lindjes: 242
 - Certifikata të martesës: 52
 - Certifikata të vendbanimit: 58
 - Certifikata e shtetësisë: 16

Këto shërbime online janë një avantazh i madh për qytetarët, duke i ofruar atyre mundësi të shpejta, të sigurt dhe efikase për të marrë dokumentet e nevojshme, pa humbur kohë dhe pa kaluar nëpër procedura komplekse.

Qendra e Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë

Qendra për shërbim të qytetarëve - QSHQ, është njësi organizative e cila operon si sektor i Drejtorisë së administratës. Aktiviteti i saj ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për qytetarët, bizneset dhe subjektet tjera të cilat i drejtohen organeve të Komunës me kërkesë për shërbime të caktuara.

Kjo qendër aktivitetin e vet e bazon kryesisht në pranimin e kërkesave nga qytetarët dhe shpërndarjen e atyre kërkesave nëpër drejtori – zyrat përkatëse si dhe pranimin e përgjigjeve (vendimeve) nga këto drejtori – zyra me qëllim të shpërndarjes së tyre deri tek qytetari i cili ka parashtruar kërkesë. Qendra gjithashtu ka për obligim që të mbaj evidencë, përcjell dhe në rastet kur afati i përgjigjes për ndonjë lëndë të caktuar i ofrohet skadimit, të intervenoj tek drejtorja-zyra së cilës i është adresuar lënda në mënyrë që përgjigja të kthehet brenda afatit të paraparë ligjor. Shërbimet të cilat i ofron QSHQ, janë shërbime ndërmjetësuese dhe përbëjnë këto:

- Pranimi elektronik i kërkesave
- Skanimi i kërkesave
- Protokoli elektronik
- Unifikimi i protokollit
- Procesimi elektronik i lëndëve
- Kthimi elektronik i përgjigjeve
- Tavolina informative, etj.

Tabela e mëposhtme përshkruan numrin e kërkesave të parashtruara në drejtoritë komunale të cilat janë pranuar nga zyrtaret e QSHQ-se.

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 27037 kërkesa, prej të cilave janë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1	Drejtoria për Administratë	40097
2	Drejtoria për Gjcodezi dhe Kadastër	8042
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2279
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1074
5	Drejtoria për Shërbime Publike	1060
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2146
7	Drejtoria për Arsim	816
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	664
9	Drejtoria për Inspeksion	619
10	Personeli	1561
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	506
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	326
13	Zyra Ligjore	1637
14	Kryetari i Komunës	176
15	Drejtoria e Prokurimit	35
16	Kuvendi i Komunës	66
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	11
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	6

19	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	613
20	Drejtoria për Diasporë	0
		61734

Njësi Komunal për të Drejtat e Njeriut

Në vitin 2024, Njësi për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar një sërë aktivitete të ndryshme, duke u fokusuar në promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, të drejtat e fëmijëve dhe parandalimin e diskriminimit. Aktivitetet kanë pasur një impakt të rëndësishëm për komunitetin dhe janë realizuar në përputhje me planet dhe objektivat e Njësisë.

Aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2024:

Shënimi i Ditëve të Rëndësishme:

Shënimi i Diteve të të Drejtave të Njeriut, Diteve të të Drejtave të Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore.

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mosdiskriminimit.

Dita e Mundësive të Barabarta, ku u promovua integrimi dhe mbështetja për të gjithë individët, pa dallim.

Shënimi i 21 marsit, Dita e Personave me Sindromën Daun, ku në bashkëpunim me Institutin Jonuz Emre u organizua aktiviteti “Piktura me Artin Fbri”, dhe punimet e realizuara u shitën në bizneset e komunës.

Shënimi i Ditës së Demokracisë dhe aktivitete të tjera për rritjen e ndërgjegjësimit.

Aktivitete për Barazi Gjinore dhe të Drejtat e Fëmijëve:

Organizuam tryeza diskutimi mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë tema si edukimi dhe mundësitë e barabarta për të dyja gjinitë.

Vizita në shkolla për promovimin e sigurisë së nxënësve, ku u diskutua për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga rreziqet dhe kërcënimet sociale.

Fushatat e Ndërgjegjësimit:

Hapja e fushatave kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kundër kancerit të gjirit, me qëllim edukimin dhe informimin e komunitetit për këto çështje të rëndësishme.

Pjesëmarrja aktive në aktivitete të tjera për sensibilizimin e qytetarëve ndaj të drejtave të njeriut dhe shëndetit publik.

Mbështetje për Personat me Aftësi të Kufizuara:

U zhvilluan gjithsej 6 aktivitete të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, ku u shënua Dita e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe u ofruan mundësi për integrimin e tyre në shoqëri.

Aktivitete kishin si qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara dhe promovimin e mundësive të barabarta.

Raportimi dhe Monitorimi i Performancës Komunale:

Njësi për të Drejtat e Njeriut ka vazhduar të mbledhë informacione dhe të raporojë për performancën komunale, duke monitoruar 13 indikatorë të performancës që ndihmojnë në matjen e progresit të komunës në çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut.

Marrëveshje për Analizën Gjinore:

Njësiti ka nënshkruar një marrëveshje me Germinin dhe Drejtoreshën e Administratës për angazhimin e një konsulenti për analizën gjinore për vitin 2023. Ky projekt ka për qëllim analizimin e politikave dhe aktiviteteve të komunës në aspektin gjinor dhe përmirësimin e mundësive të barabarta për të gjithë.

Viti 2024 ishte një periudhë dinamike dhe produktive për Drejtorinë e Administratës në Komunën e Vushtrrisë, me suksese të dukshme në digjitalizim, efikasitet administrativ dhe transparencë. Plani për vitin 2025 do të fokusohet në fuqizimin e shërbimeve dhe lehtësimin e proceseve administrative për qytetarët.

Me respekt

Hyrrie Uka Hoxha

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI



**Për,
Propozues,**

Kuvendin e Komunës
Kryetari i Komunës
Ferit Idrizi

**Hartues,
Çështja për shqyrtim,**

Drejtoria për Shërbime Publike
Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12 dhe 58 "h" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040/2008, nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (KKV) Nr. 03/23 prot. nr. 49/23 datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____ 2025 merr këtë:

**V E N D I M
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT**

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.99/22 dt. 28.04.2022 për shërbimet e varrimit në Komunën e Vushtrrisë, ashtu që rritet vlera e tarifës nga dyqind euro (200.00 €) në dyqind e shtatëdhjetë euro (270.00 €).
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli
Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS	
KOMUNA E VUSHTRISË	
№ Nr./Br.	39/22
№ Llog./Bil. d.	- 1 -
Dana / Datum	28. 04. 2022
VUSHTRRI, VUÇITRË	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" në lidhje me nenin 17, paragrafi 1, shkronja "s" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 28 prill 2022, merr këtë:

**VENDIM
PËR RITJEN E VLERËS SË TARIFËS PËR SHËRBIMET E VARRIMIT**

1. Me këtë vendim rritet vlera e tarifës për shërbimet e varrimit, në shpenzimet komunale për ritet fetare që ofrohen nga Bashkësia Islame Dega në Vushtri, nga 180 € sa është aktualisht në 200 €.
2. Rritja prej njëzet (20 €) e vlerës së kësaj tarifës bëhet si rezultat i rëndimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike, në kushtet e ngritjes së çmimeve dhe shtrenjtimit të kostos së jetesës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtorja e Shërbimeve Publike, si dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



Formulari per kerkese apo anekese

Drejtorati/Njesia
Kryetari i Komunës

Data 07/03/2025

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Bashksia Islame Kosoves

Adresa e vendbanimit

/

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

44607877

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Kërkesa

Ne proces

Numri personal

/

E-mail Adresa

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

02-104/02-0010251/25

Afati i zgjedhjes

06/04/2025

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kerkese per modifikimin e memorandumit per sherbime te varrimit

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Bashksia Islame Kosoves vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.


(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: berat.januzi



BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
Islamic Community of Kosova
KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME NË VUSHTRRI



Rr: "Isa Boletini" nr. 67, Vushtrri, Kosovë
Tel: +383/028 571 213, email: kbivushtrri@outlook.com
www.kbivushtrri.com

Nr. Protok. 105/2025 datë: 07.03.2025

PËR:	DR. FERIT IDRIZI KRYETAR I KOMUNËS SË VUSHTRRISË
NGA:	KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME NË VUSHTRRI
LËNDA:	KËRKESË

I nderuar Kryetar,

Në vitin e kaluar, duke marrë parasysh rrethanat e reja ekonomike, gjegjësisht gjendjen ekonomike gjithnjë e më të rënduar, kemi parashtruar një kërkesë për modifikimin e Memorandumit për shërbimet mortore, gjegjësisht për rritjen e shumës për shërbimet.

Arsyetim


1. Gjendja e rëndë ekonomike e cila ka shkaktuar ngritjen e çmimeve;
2. Ankesat e vazhdueshme dhe të justifikueshme të shërbyesve fetarë të cilët konsiderojnë se shërbimi që ofrojnë, pastrimi me theks të veçantë, as përsëafërmimi nuk shpaguhet me shumën që përfitojnë;
3. Praktikrat e komunave tjera të cilat kanë bërë ndryshime në memorandumet përkatëse duke e rritur shumën për shërbimet në fjalë.

Ne, duke u thirrur në raportet e shkëlqyera që kemi ndërtuar dhe në synimet e përbashkëta për t'i shërbyer sa më mirë kësaj shoqërie, mbesim me shpresë se ndryshimi që kemi propozuar në shumën 270 (dyqindeshatëdhjetë) euro do të miratohet nga ana juaj.

Me respekt,

(Dr. Ejup Haziri, kryetar)





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

DATË:	12.03.2024
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Drejtori, Lorik Maxhuni: 
PËRMES:	Kryetarit të Komunës Ferit Idrizi 
LËNDA:	Kërkesë për mbështetje financiare



Të nderuar,

Duke u bazuar në kërkesën e _____ për mbështetje financiare i propozoj Kuvendit të Komunës që të njëjtit i ndahet shuma prej 4.000 eurove nga kategoria e subvencioneve.

Me respekt!



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës
Hartues: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 datë 04 qershor 2008), si dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2025 merr këtë:

V E N D I M PËR SHFUQIZIM TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 656/06 datë 09.11.2006 për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit banesorë për raste sociale dhe objekte tjera të infrastrukturës në Komunën e Vushtrrisë.
2. Qëllimi i shfuqizimit të vendimit të cekur në pikën paraprake është krijimi i mundësisë që sipërfaqja prej 20 ari e cila gjendet në parcelën nr. 2254, vendi i quajtur “Selisht” fleta poseduese nr. 45 ZK-le Vushtrri, pronë e komunës së Vushtrrisë të shfrytëzohet për nevoja të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Vushtrri.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Vushtrri.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Vendimi për të marrë në shfrytëzim 20 ari tokë për nevojat e QKMF-s (Qendra e Kryesore e Mjekësis Familjare) është një hap i domosdoshëm dhe i mirëfilltë për të përballuar rritjen e fluksit të pacientëve dhe për të siguruar kushte më të mira për shërbime mjekësore. Pas zhvendosjes së zyrave administrative të QKMF-s, është krijuar një ngarkesë e konsiderueshme mbi hapësirat ekzistuese të qendrës. Ky fluks ka ndikim jo vetëm në ngarkesën e shërbimeve mjekësore, por edhe në kapacitetin e parkingut, duke e bërë të vështirë parkimin dhe qasjen në qendrën mjekësore për pacientët dhe personelin.

Po ashtu, zhvendosja e laboratorit në këtë hapësirë do të sjellë një rritje të mëtejshme të fluksit të pacientëve, çka e bën edhe më të domosdoshëm krijimin e kushteve të reja për menaxhimin e hapësirave. Hapësirat ekzistuese janë të pamjaftueshme për të përballuar këtë rritje të fluksit dhe kërkesat për shërbime të mëtejshme mjekësore.

Në këtë kontekst, investimi në shtimin e hapësirës është i nevojshëm për të siguruar një mjedis më të përshtatshëm dhe funksional për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjetit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministrstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

181858

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-02253-24

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

18-959/25
12.03.2025 - 11:44
VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI
Vushtri / Vushtri / Vushtri
VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202016-02253-24	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	19388		03.04.2023	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SELISHTE			03.04.2023	



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

Për: **Komitetin për Politikë dhe Financa - Kuvendin e Komunës**

Propozues: **Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës**

Hartues: **Izet Miftari, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport**

Tema: **Propozim – vendim**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenin 5 paragrafi 2, lidhur me nenin 12 të Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2025, merr këtë:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

1. Me këtë vendim Dr. Shkodran Imeraj, Bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, i ofrohet përkrahje financiare në shumën prej tremijë euro (3,000.00€) për realizimin e projektit studimor “Masakrat e forcave serbe në Studime të Vushtrrisë (1999)”, që për qëllim studimi dhe ndriçimi ka masakrat që kryen faretat pushtuese serbe në Studime.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i komunës kategoria subvencione dhe transfere, të drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe në drejtoritë ku ka mjete të lira.
3. Përfituesi i mjeteve financiare nga pika 1 e këtij vendimi duhet të dorëzojë në Komunë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa brenda 7 ditësh pas përfundimit të projektit raport kthyes për shfrytëzimin e subvencionit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë

Melihate Basholli Latifi
Kryesues e Kuvendit

Arsyetim

Më datë 07.02.2025 në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport kemi pranuar kërkesën me nr.02-104/02-00548/25, të datës 05.02.2025, me të cilën Dr. Shkodran Imeraj, Bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, me kërkesë për mbështetje financiare për botimin e veprës-librit **"Masakrat e forcave serbe në Studime të Vushtrrisë (1999)"**.

Duke e vlerësuar këtë studim të rëndësishëm për historinë më të re të Vushtrrisë, si dhe duke pasur parasysh se përmes kësaj vepre do të dokumentohen shkencërisht krimet serbe që janë kryer ndaj civilëve shqiptar në Vushtrri, me theks të veçantë në Studime, vlerësojmë se ky projekt duhet të përkrahët nga ana e institucioneve komunale të Vushtrrisë.

Përmes botimit të librave të tillë nga studiues serioz dhe me kredibil, si dhe duke marrë në konsideratë se botues do të jetë Instituti i Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, do të faktohen krimet e rënda që regjimi serb ka kryer ndaj civilëve shqiptarë në fund të shekullit XX.

Izet Miftari 
Drejtore i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

Vushtrri me 05 shkurt 2025

Drejtuar:
Komunës së Vushtrrisë
Dr.Ferit Idrizi, kryetar

Lënda:

Kërkese për mbështetje financiare për projektin monografik: "Masakrat e forcave serbe në Studime të Vushtrrisë (1999)"

I nderuar kryetar Dr.Idrizi,

Duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në detyrat e juaja si kryetar i Komunës së Vushtrrisë, nëpërmjet kësaj shkrese kërkoj nga ana e juaj që të me përkrahni financiarisht si Komunë e Vushtrrisë, për projektin monografik: "Masakrat e forcave serbe në Studime të Vushtrrisë (1999)", projekt ky i nisur që disa vite nga ana ime.

Projekti në fjalë është një dëshmi për krimet e gjenocidit serb që u krye në fshatin Studime të Vushtrrisë në maj të vitit 1999, ku nga forcat serbe të ushtrisë dhe policisë, u vranë e u ekzekutuan dhjetar shqiptar civil të pambrojtur.

Libri është i ndërtuar mbi dokumentacione relevante që dalin nga dokumente të Tribunalit të Hagës, Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Vushtrri, Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykatë Themelore të Mitrovicës, shtypi ditor në Kosovë dhe Shqipëri, dëshmitë e mbledhura në teren gjatë ekspeditave tona për gjatë harkut kohë disa (2018-2025), nga të arriturat e deritanishme të historiografisë sonë.

Jemi duke bere përpjekjet maksimale që libri të përfundohet të afati sa me optimal gjatë vitit 2025, i cili do të botohet nën siglën e Institutit të Historisë në Prishtinë, me aparaturën e nevojshme shkencore dhe nën kujdesin e një ekipi profesional të historianëve (kryeredaktor e recensentë).


Andaj, Komunës së Vushtrrisë, i kërkojmë mbështetje financiare, për botimin në gjuhën shqipe, apo edhe qofte me përkthimin e saj në gjuhën angleze.

Shifra totale që kërkoj për mbështetje për përfundimin e projektit tonë në gjuhën shqipe nga ana e Komunës së Vushtrrisë është vlera 5000 euro. Mbështetja kërkohet pa përkthimin e monografisë në gjuhën angleze.

Urojme që kërkesa ime të miratohet nga ana e juaj dhe gjithsesi së në parathënien e librit do të potencohet vlerësim për ndihem e ofruar nga ana e juaj si kryetar i Komunës së Vushtrrisë.

Për kontakt: 044 500 609 apo shkodran.imeraj84@gmail.com

Me respekt dhe konsiderata të veçanta,

Dr.Shkodran IMERAJ

Bashkëpunëtor i Artë shkencore
Departamenti i Historisë Bashkëkohore
Institut i Historisë
Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës



Datë: 17.03.2025

Për: Kuvendin Komunal

Propozues: Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi

Hartues: Drejtoria për Shërbime Publike, Benjamin Shala

Për shqyrtim: Propozim Vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, si dhe nenin 13 të Statutit të Komunës dhe Vendimit 01 nr. 359/19 të datës 26.12.2019 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datën _____ merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIM TË PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT ME AUTOMERIMANGË BRENDIA TERRITORIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me automerimangë në territorin e komunës, në këtë përbërje:

- 1.1 _____, anëtar i Kuvendit;
- 1.2 _____, anëtar i Kuvendit;
- 1.3 Benjamin Shala, ekzekutivi i komunës;
- 1.4 Remzi Ahmeti, ekzekutivi i komunës;
- 1.5 Isak Hyseni, Shoqëria civile.

2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues në takimin e parë, me shumicë votash, zgjedhin kryesuesin i cili e kryeson komisionin.

3. Komisionit Vlerësues ka mandat për shqyrtim të ofertave për shërbimin e transportit me automerimangë në pronën e përfshirë në vendimin paraprak të kuvendit të komunës.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit:

4.1 Komisionit Vlerësues zbaton procedurat e ankandit publik për shërbimet e transportit me auto merimangë në pronën e paluajtshme të komunës e cila është dhënë në shfrytëzim që nënkupton:

4.1.1 Njoftimin publik i cili zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit,

4.1.2 Njoftimi publik publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të komunës dhe së paku në njërën nga mediat e shkruara dhe elektronike.

4.1.3 Njoftimi duhet të përmbaj të dhënat kadastrale të pronës, lokacionin, përshkrimin e shërbimit me auto-merimangë, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, formën e konkurrimit, arsyeshmërinë e interesit publik, çmimin fillestar, kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim, kohën dhe vendin ku mbahet ankandi dhe hapja e ofertave.

4.2 Pas pranimit të ofertave Komisioni Vlerësues bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik.

4.3 Komisioni Vlerësues përzgjedh përfituesin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e mbylljes së njoftimit publik në rastet e vlerësimit të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të shërbimeve të transportit me auto-merimangë.

4.4 Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës si dhe të njëjtin ju dërgon palëve të përfshira në proces.

4.5 Komisioni Vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të shërbimeve të transportit me auto-merimangë, ofertën e përzgjedhur e procedon te kryetari i komunës për nënshkrim të kontratës me përfituesin.

4.6 Vendimet në komisionin vlerësues merren me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit.

4.7 Komisioni, për punën e tij mbanë procesverbal të cilin e nënshkruan procesmbajtësi dhe kryesuesi i komisionit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e Komisionit Vlerësues.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli - Latifi

Kryesues i Kuvendit

Arsyetim

Komuna e Vushtrrisë bazuar në Vendimin 01 nr. 359/19 të datës 26.12.2019 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, Rregulloren 01 nr. 139/11 të datës 30.06.2011 për shërbimet e transportit me auto-merimangë, Udhëzimin Administrativ nr.02/2009 të Policisë së Kosovës për mënyrën e zhvendosjes së mjeteve motorike, ka nënshkruar Kontratë shërbimi (kontratë kornizë me një operator ekonomik) për shërbimet e transportit të mjeteve motorike me auto-merimangë, mirëpo kjo kontratë tashmë ka skaduar. Prandaj është e nevojshme që të zhvillohen procedurat e dhënies në shfrytëzim të këtij shërbimi për periudhën e ardhshme dy vjeçare.



Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë dhe Financa -- Kuvendin Komunal
NGA /OD/FROM	Z. Lorik Maxhuni, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
PËRMES:	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
TEMA/SUBKJEKAT/SUBJECT	Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrisë
DATË/DATUM/DATE	04.02.2025

Të nderuar,

Bashkangjitur gjeni "Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrisë"

Ju faleminderit në mirëkuptim!



Komuna e Vushtrrisë



Q.K.M.F.'Dr.Safet Idrizi''Vushtrri

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

**Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në
Komunën e Vushtrrisë**

Shkurt 2025

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
’’ DR.SAFET IDRIZI ’’ VUSHTRRI
(QKMF)-VUSHTRRI

I- HYRJE

Informata për Shëndetësi e QKMF-së në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) të Komunës së Vushtrrisë, paraqet informacionin gjithëpërfshirës të organizimit dhe funksionimit të KPSH, me të cilin ofrohen të dhënat e nevojshme për shërbimet e ofruara.

DSHPS dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Ligjin për Shëndetësi, U/A për K.P.Sh, Statutin e QKMF në Vushtri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Organizimi i KPSH bazohet në Ligjin për Shëndetësi, aktet nën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, Statutin e Komunës dhe Statutin e QKMF-së. Me ligjin për vetqeverisjen lokale përgjegjësia për organizimin dhe kompetencat në KPSH i takojn nivelit lokal të qeverisjes.

QKMF-ja është përgjegjës për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare, si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

II- BASHKËPUNIMI ME DONATOR

Gjatë vitit 2024 Komuna Vushtrrisë - DSHPS dhe QKMF kemi arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

- Bashkëpunimi me donatorin AQH e Zvicrës, është duke vazhduar në kuadër të zhvillimit të edukimit të vazhdueshëm profesional.
- DSHPS Komuna Vushtrri dhe Islamic Relief me seli në Prishtinë ka vazhduar projektin i cili ka pasur nismën dhe funksionalizimin në vitin 2017, në bazë të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në fushën e shëndetësisë për projektin e vizitave shëndetësore në shtëpi, ku kemi përmisuar dhe rritur kapacitetet për funksionalizim më të mirëfillt, për përkujdesjen ndaj qytetarëve të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në krahasim me vitet e kaluara, me numrin e stafit profesional mjekësor të angazhuar 7 ditë të javës /13 orë, me dy ekipe mjekësore të përbëra nga 1 mjek dhe dy infermier, me dy vetura.
Po ashtu bazuar në marrëveshjen stafi aktual profesional është 7 mjek, 14 infermier, 2 teknik laborant dhe 1 asistent stomatologu.
- Në bashkëpunim me AMC kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiak për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare dhe me të arriturat sipas planprogramit jemi shpërblyer inventar dhe pajisje të nevojshme për realizimin e projektit.

III- RRJETI I INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE


Aktualisht kujdesi parësor shëndetësor në komunën e Vushtrrisë është i organizuar përmes institucioneve shëndetësore si në vijim:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) - institucioni themelor i KPSH-së,

10 Qendrat të Mjekësisë Familjare (QMF) - si njësi përbërëse të QKMF-së

9 Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF) - si njësi përbërëse të QMF-së

Figura 1. Struktura organizative e KPSH-së në Vushtri



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr.Safet Idrizi" në Vushtri është institucioni shëndetësor kryesor që ofron dhe zbaton Kujdesin Parësor Shëndetësor publik në gjithë territorin e komunës, sipas U/A për KPSH. QKMF ka obligim ligjor që të kujdeset për qytetarët e komunës për sa i përket Kujdesit Parësor Shëndetësor, nën mbikqyrjen dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Shëndetësisë (DSHPS), të cilës njeherit i raporton për të arriturat apo sfidat, duke i zgjedhur bashkarisht shqetësimet që hasen gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore. DSHPS-së s'bashku me menaxhmentin e QKMF-së caktojnë dhe implementojnë politikat shëndetësore për Komunën e Vushtrrisë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës pa dallim etnije, gjinie, relegjioni, race etj.

Promovimin shëndetësor, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin,

Promovim: informim, komunikim dhe edukim në institucione, shkolla dhe komunitete,

Parandalim: imunizimin/vaksinimin, monitorim të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve përmes vizitave sistematike, mjekim: përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor, kujdesin akut përfshirë ofrimin e kujdesit urgjent, mbikqyrjen dhe transportin deri në institucionet përkatëse, rehabilitim: kujdesi paliativ/terminal.

QKMF është e organizuar në dy departamente si :

Departamentin e Mjekësisë Familjare

Departamentin e Administratës dhe Personelit

Barnatorja Qendrore

Në kuadër të QKMF-së funksionojn edhe njësitë funksionale të ndara në sektore:

Spektori i Mjekësisë Familjare

Spektori i Shëndetit publik

Njësia e SISH

Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit

Spektori i Shëndetit Oral Preventiv,

Spektori i Urgjencës

Spektori i Diagnostikës.

Raporti vjetor i shërbimeve shëndetësore janar - dhjetor në QKMF 2024

Tabela 2. Paraqet informatën për vizitat mjekësore në QKMF, QMF dhe AMF:

Nr.	IKP-Sektoret	Totali	Meshkuj	Femra	Participim	Shërbim	Referime	Malinje	Kronike	Te vizituar me karte
1	QKMF	67795	31565	36230	11408	193942	3477	201	4100	815
2	Urgjenca	35753	16001	19752	4087	167636	5346	295	4682	0
3	Laboratori	16960	6904	10056	4398	170785	0	0	0	0
4	Stomatologjia	8655	4043	4612	1116	39396	120	0	0	1073
5	RTG	6308	2913	3395	1237	18992	0	0	0	0
6	Rtg e dhembit	627	276	351	99	1579	0	0	0	0
7	Vaksinimi	4806	2588	2218	0	14056	0	0	0	3553
8	QMF-1	64672	30384	34288	13165	182715	4821	159	4465	450
9	QMF-2	6630	2983	3647	1008	35151	272	0	461	67
10	QMF-3	8378	4067	4311	1582	55277	157	0	1511	2103
11	QMF-AMF	23818	10661	13157	3459	115383	4468	75	2944	2521
12	V.SHTEPIAKE	2049	904	1145	0	10105	9	0	0	324
13	Kshillimore AQH	1188	604	584	0	4372	0	0	237	0
	Gjithsejt	247 639	113 893	133746	41 559	1 009 389	18 670	730	18 400	10 906

Tabela 3. QMF dhe AMF, 12 mujori për vizitat mjekësore dhe shërbime 2024.

IKP	Totali	M	F	Referimet	Participim	Shërbime tjera	Vizita me karte	S.Malinje	S.Kronike
-----	--------	---	---	-----------	------------	----------------	-----------------	-----------	-----------

QMF dhe AMF	QMF Lumadh	7530	3230	4300	268	1165	39368	1148	39	532
	QMF Smrekonicë	2932	1391	1541	773	420	11017	108	1	320
	QMF Pantinë	2773	1199	1574	732	698	13337	702	15	628
	QMF Druar	1239	587	652	479	119	4330	24	0	57
	QMF Novolan	834	397	437	150	0	2117	2	1	16
	QMF Maxhunaj	4262	1890	2372	1079	902	15508	0	2	476
	QMF Dumnice	405	177	228	139	17	2448	14	0	32
	AMF Samadrexhë	1142	502	640	282	36	9557	603	0	483
	AMF Strovç	858	398	460	203	30	2754	0	6	196
	AMF Pasome	682	341	341	8	13	3031	296	0	43
	AMF Oshlan	369	207	162	37	2	1031	0	0	15
	AMF Beqiq	354	147	207	88	4	1358	0	0	13
	Amf Dubovc	136	78	58	39	5	452	0	1	5
	AMF Ceceli	302	117	185	57	8	2626	0	0	47
Gjithsej:	23818	10661	13157	4334	3419	108934	2897	65	2863	

- SHËNDETI PUBLIK**


Është përgjegjës për shëndetin publik, imunizim dhe vaksinim dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor, ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyesë nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi. Sëmundjet ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë

Tabela 4. Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë për komunën e Vushtrrisë,

SËMUNDJA	Pneumonia/ARI	ILI	Diarrheac	Varricella	COVID-19	Sindroma meningococale			Pertusis	Hepatit ac. B	Helimët me ushqim	Salmonelozia	IST	TB	Sëm. tjera ngjitëse	Totali
						Meningitiseriosa	Meningitipurule	Meningoen								
MITROVICË	568	7610	7512	393	79	3	0	4	4	8	263	11	3	28	89	16575
SKËNDERAJ	20	1758	2095	105	1	0	1	0	0	2	5	1	0	9	2	3999
VUSHTRRI	482	1224	2554	254	15	6	1	2	0	1	7	0	0	21	60	4627
TOTALI	1070	10592	12161	752	95	9	2	6	4	11	275	12	3	58	151	25201

Grafikoni 1, Grafikoni nr.3 Ecuria e sëmundjeve infektive gjatë vitit 2024 sipas komunave (e raportuar nga IKSHPK-Mitrovicë)

Ecuria e sëmundjeve infektive gjatë vitit 2024



- Sektori i Vaksinit dhe imunizimit :**

Vaksini i rregullt tek fëmijët dhe të moshuarit:

Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vaksina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet si dhe në fshatra.

Tabela 5. Paraqet administrimin e vaksinave në 6 qendrat e KPSH si më poshtë:

Raporti i Shërbimit të Vaksinimit 2024											
	Totali	M	F	QKMF	QMF-1	QMF-2	Lumadh	Smrekonicë	Pantinë	Maxhunaj	Shërbimet
Janar	387	218	169	238	89	0	22	22	0	16	1121
Shkurt	358	217	141	165	110	25	32	0	11	15	1098
Mars	375	197	178	188	99	24	27	3	12	22	1739
Prill	365	198	167	159	105	31	20	20	12	18	1088
Maj	478	248	230	222	129	67	23	10	13	14	1282
Qershor	358	200	158	194	116	24	7	3	6	8	905
Korrik	434	225	209	228	124	36	21	0	13	12	7233
Gusht	388	196	192	189	138	22	10	0	13	16	1140
Shator	409	214	195	214	120	30	22	0	18	5	1172
Tetor	447	263	184	221	163	22	14	0	10	17	1208
Nentor	401	208	193	194	119	30	26	0	16	16	1095
Dhjetor	407	214	193	216	136	29	11	0	6	9	1120

Gjithsej	4807	2598	2209	2428	1448	340	235	58	130	168	20201
----------	------	------	------	------	------	-----	-----	----	-----	-----	-------

Tabela 6. Paraqet Vaksinat kundër gripit sezonal që janë administruar:

Nr.	Përshkrimi	Vaksina
1	Vaksina kundër gripit sezonal	1900

Menaxhimi i zingjirit të ftohtë është sipas standardeve, paisjet për standardizim dhe arritjen e kushteve maksimale të respektimit të zingjirit të ftohtë është në nivelin e duhur.

Tabela nr.7 Pasqyra e përfshirjes së nxënësve të vaksinuar 2024:

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vaksinim						
SHFMU	Nxënës të planifikuar		Kanë refuzuar		Vaksina të administruara	
	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	
Klasa I	1015	100%	60	6%	955	94 %
Klasa XII	983	100%	22	2 %	961	98 %
Gjithësej	1988	100%	82	4 %	1916	96 %

Per herë të parë është administruar vaksina HPV te vajzat e moshës 12 vjeçare.

Ka pasur hezitim për marrjen e vaksinës në fjalë, por fal angazhimit të ekipës rezultati ka qenë i kënaqshëm, por në këtë drejtim duhet të punohet ende.

Të planifikuar kanë qenë 490 nxenese, të vaksinuara janë 408 femra.

Vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta në SHFMU-të të Komunës së Vushtrrisë.

Qëllimet e vizitave sistematike

1. Vlerësimi i nivelit të rritjes dhe zhvillimit të grupmoshës së caktuar, përkatësisht nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta të shkollave fillore .
2. Njohja dhe identifikimi i veçorive specifike të problemeve shëndetësore të këtyre grupmosha, që do të mundëson zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe anomalive/çrregullimeve eventuale të fëmijët.
3. Dizajnimi dhe organizimi i intervenimeve me natyrë preventive, të bazuara në shkolla dhe komunitet.
4. Krijimi i një baze të të dhënave nga rezultatet e vizitave të realizuara e cila do të mbështesë modifikimin dhe përpilimin e politikave shëndetësore më favorizuese për fëmijët.

Parametrat e vlerësuar:


Është vlerësuar zhvillimi i përgjithshëm psikofizik dhe shëndeti oral Kronologjia e aktiviteve

Tabela 8. Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike						
SHFMU	Nxënës të planifikuar për vizita sistematike		Munguar		Vizita të realizuara	
	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%	Nr. I nxënësve	%
Klasat I	1392	100	40	3%	1352	97%
Klasat V	1720	100	64	4%	1656	96%
Klasat IX	874	100	96	11%	778	89%
Gjithsejtë	3986	100	200	5.0%	3786	95.0%

Nga gjithsejtë **3986** nxënës të planifikuar për vizita , vizita të realizuara janë 3786 apo **95.0%**, ndërsa numri i nxënësve të cilët kanë munguar është 200 apo **5.0%** .

Shkalla e realizimit të vizitave është paraqitur në tabelën dhe në grafikun nr.2.



Grafiku nr.2 - Shkalla e realizimit të vizitave sistematike të nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta.

VLERËSIMI I REZULTATEVE NGA VIZITAT SISTEMATIKE PËR NXËNËS

Nga vlerësimi i rezultateve të dala nga vizitat sistematike të nxënësve të klasave të nënta ,mund të konstatohet se në përgjithësi kemi të bëjmë me një kategori të popullatës(nxënës) të shëndoshë ,përfshirë problemet e shëndetit oral , patologjive refraktare të syve .

Përndryshe ,shkalla e përgjithshme e shprehur në përqindje e parametrave të vlerësuar me veçori patologjike në shumicën e parametrave është shumë e vogël(përfshirë dyshimet në çrregullimet refraktare të syve,mbipeshës, kariesit të dhëmbëve të qumështit dhe higjienës jo të mirë orale dhe rasteve të dyshuara me VCC..

Higjiena orale e nxënësve nuk është e mire, e shprehur në përqindje nga numri total i nxënësve të kontrolluar ,del se 53% e tyre janë me nivel të ulët të higjienës orale.Gjendja e mukozës dhe gingivave me veçori patologjike prezenton të jetë 12% nga numri total i nxënësve të vizituar.

Sa i përket zhvillimit të përgjithshëm psikofizik , veçori patologjike në shkallë më të madhe janë konstatuar të të pamurit e të cilat kanë të bëjnë kryesisht me anomali refraktare(ametropia).

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar (948 nxënës) , shkalla e përgjithshme e veçorive patologjike të të pamurit arrinë në **19%**(177 nxënës),ndërsa numri i nxënësve të cilët bartin syze për korrektim të refraksionit është 42, përkatësisht 4%.

Statusi psikik- Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, në aspektin psikik, nga numri total i nxënësve të ekzaminuar(948), si raste të dyshimta me veçori patologjike janë 14 nxënës(2%).Veçoritë patologjike të identifikuar adresohen kryesisht në drejtim të çrregullimit të mësuarit dhe mungesës së vëmendjes.

Gjatë ekzaminimit të të dëgjuarit nuk kemi gjetur raste patologjike të cilat do të konsideroheshin si shumë relevante dhe të besueshme ,për shkak se nuk kemi pasur hapësirat adekuate për të kryer ekzaminimet për degjim . Janë të dyshuar 26 nxënës (3%) .

Zemra- nga numri i përgjithshëm i nxënësve të kontrolluar, 13 nxënës (1%) janë të dyshuar për veçori patologjike të zemrës.

Gjatë evoluimit të projektit , të SWOT analiza u përmenden disa rreziqe të cilat do të reflektonin dukshëm në mundësinë e mos arritjes së rezultatit të pritur apo zëvendësimin e tij me ndonjë rezultat tjetër, atëherë shtrohet pyetja se cili do të duhej të ishte menaxhimi i supozimeve dhe rreziqeve në këtë rast:

1.Supozimet dhe rreziqet e rëndësishme veç janë identifikuar (sidomos pika 2,3,4 dhe 5);

2.Të minimizohen gjasat e rrezikut apo të eliminohet rreziku(në këtë rast rreziku për mos arritje të rezultatit të dëshiruar është nga faktori njeri, gjegjësisht nga të gjitha palët e interesit : drejtori i shkollës; mësuesi, prindi si dhe nga ekipi zbatues i projektit).

3. Meqenëse neve në këtë rast po na mungon informata kthyesë mbi numrin e nxënësve të cilët i kemi referuar si raste të dyshimta ,atëherë që të minimizohet apo të eliminohet rreziku ,hartuesi dhe zbatuesi i projektit duhet që më fillimin e vitit të ri shkollor serish të bëjë ri monitorim për secilin rast të dyshuar dhe në secilën shkollë në mënyrë që rastet eventuale të cilat kanë qenë të referuara për ekzaminim të mëtejshëm të identifikohen dhe të realizohen këto ekzaminime.

REKOMANDIMET NGA VIZITAT SISTEMATIKE PËR NXËNËS

- Promovimi i shëndetit oral dhe i kujdesit shëndetësor parandalues për ruajtjen e shëndetit të dhëmbëve nëpër shkolla, çerdhe dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare,duke demonstruar teknikën e pastrimit të dhëmbëve,me qellim të parandalimit të kariesit të dhëmbëve.;
- Vulosja e dhëmbëve të përhershëm dhe dhëmbëve të qumështit;

- Fluorizimi I dhëmbëve;
- Rritja e numrit të mjekëve Stomatolog në QKMF-re ku do të ofrohen shërbimet e stomatologjisë preventive dhe kurative më të avancuara të cilat janë më se të domosdoshme;
- Hapja e ordinancave stomatologjike nëpër disa QMF-re në zonat rurale;
- Organizimi I kampanjave për edukimin dhe këshillimin e prindërve, fëmijëve parashkollor , fëmijëve nëpër kopshte të tyre dhe nxënësve nëpër shkolla lidhur me mënyrën e drejtë dhe të shëndetshme të ruajtjes së dhëmbëve dhe të ushqyerit e shëndetshëm;
- Intensifikimi I bashkëpunimit ndërmjet infermiereve të QKMF- ve dhe infermiereve për edukim të komunitetit me Institutin e Shëndetit Publik ,si dhe shpërndarja e broshurave për ushqyeshmërinë dhe të ushqyerit e drejtë;
- Promovimi I stilit të shëndetshëm të jetës;
- Inicimi i një bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve dhe profesionistëve shëndetësor për hulumtimin ,paraqitjen dhe menaxhimin e rasteve me çrregullime shëndetësore;
- Vizitat sistematike të vazhdoen edhe në vitin e ardhshëm , për klasën e I, V, IX.
- Të shikohet mundësia e përmirësimit të higjienës në shkolla duke rregulluar infrastrukturën e njejeve sanitare, rrjetit të kanalizimit dhe furnizimin e rregullt me ujë.
- Edukimi i fëmijëve për bartje të çantës dhe të qëndrimit në bankë.
- Përqendrimi mbi shkaqet rrënjësore të problemeve të identifikuara dhe hartimi i strategjisë për adresim të sakët të problemeve duke maksimalizuar përpjekjet për parandalim të devijimeve të cilat janë të parandalueshme dhe për përmirësim të gjendjes.

• ***NJËSIA E SISTEMIT INFORMATIV SHËNDETËSOR***

Në Sistemin Informativ Shëndetësor në QKMF Vushtrri punohet vazhdimisht në Mjekësinë Familjare, Stomatologji, Tretman, Infuzione, Lidhetore dhe Vaksininim.

Ka pas ndërprerje të Sistemit BHIS gjatë muajve shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor ku ne janar të 2024 është aktivizuar prapë sistemi.

Gjatë këtij viti në SISH është punuar me vizita sistematike ku janë futu në data bazë 2940 fletëza ,dhe është përgatit raporti për klasat e I ,V dhe të IX. Raportohet çdo muaj për morbiditeti, sëmundjet malinje dhe kronike, vizitat mjekësor e Stomatologjike .

Referuar bazës së te dhënave për sëmundjet kronike, hipertension, diabet dhe astmës.

110	E10	J45
351	673	23

• **SEKTORI I SHËNDETIT ORAL**

Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsej 8694 pacient dhe ka dhënë 39608 shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllobimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora 07^h deri në ora 20^h në QKMF dhe në QMF-1, ndërsa në QMF-2 dhe QMF-3 nga ora 07^h deri në ora 14^h, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora 07^h deri ne ora 19^h.

Shërbimet për nxjerrjen e dhëmbit: Caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, eks. Dhëmbit, tamponade e alveolës, këshilla për pacientin.

Shërbimet për vizita: caktimi i diagnozës, aplikim local me udhëzim për rtg dhe terapia e përgjithshme.

Shërbimet për shërimin e karriesit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit, vendosja e shtresës (me ose pa kalcimol), vendosja e bllobës dhe polirimi dhe korigjimi I pikave kontaktuese.

Shërbimet te pulpitet e dhëmbëve: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit deri në hyrje të kanaleve, eksterpimi i pulpës, mbushja e kanalit dhe vendosja e bllobës.

Shërbimet te gjakëderdhja pas nxerrjes së dhëmbit: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, kiretazha e alveolës, vendosja e hemostatikut dhe tamponade e alveolës.

Trajtimi i gingiviteve: largimi i pigmenteve të buta dhe të forta me kavitron dhe past me brush.

Bazuar në statistikat sipas regjistrit të popullësise të vitit 2011 në ASK komuna e Vushtrrise ka gjithësej 69870 banor, KPSH në Vushtrri ka gjithësej 9 stomatolog, sipas U/A 6000 banor për një stomatolog, andaj nevoja është për rritjen e numrit të stomatologëve, duke ja shtuar dhe hapjen e shërbimit stomatologjikë ne Pantinë dhe Lumadh.

Tabela 9. Paraqet Shërbime në sektorin e shëndetit oral preventive duke përfshi të gjitha qendrat:

Raporti Vjetor i shërbimit të Stomatologjisë 2024										
Muji	Totali	M	F	Prej tyre te para	Vizita serike	Pa mjekim	Me mjekim	Dhëmbë të nxjerrë	Intervenime tjera	Sherbimet
Janar	828	348	480	834	0	1	302	216	210	4091
Shkurt	887	397	490	722	3	6	329	172	255	3820
Mars	684	323	361	688	0	0	255	148	186	3355
Prill	585	307	278	588	0	2	216	140	172	2668
Maj	790	352	438	729	0	1	292	160	207	3124
Qershor	550	263	287	544	0	0	217	122	155	2196
Korrik	775	349	426	773	0	0	302	174	199	3675
Gusht	620	291	329	628	0	0	258	139	170	2801

Shator	718	361	357	720	1	0	270	163	203	3297
Tetor	886	396	490	886	1	2	355	193	194	4252
Nentor	679	351	328	681	1	0	242	143	171	3168
Dhjetor	692	329	363	687	0	1	266	184	156	3161
Gjithsej	8694	4067	4627	8480	6	13	3304	1954	2278	39608

SEKTORI I KUJDESIT URGJENT

Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit 05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent, Veprimtaria e Shërbimit mjekësor emergjent paraspitalor përfshin:

1. reagimin e shpejtë në thirrje;
